




BASHKIA  
TIRANË

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TË  
QENDRUESHËM TË BASHKISË TIRANË  
2023 - 2027

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INTEGRIMIT, PLANIFIKIMIT  
STRATEGJIK DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK

## Të Dhënat e Dokumentit

<b>Titulli i Projektit</b>		Hartimi i Strategjisë së re të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Bashkisë Tiranë 2023-2027		<b>Nr. i Projektit</b> ARC-K15		
<b>Titulli i Dokumentit</b>		Strategjia e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Bashkisë Tiranë 2023-2027		<b>Nr. i Dokumentit</b> ARC-K15-03-23-09		
<b>Referenca e Dokumentit</b>						
<b>Rishikimi</b>	<b>Data</b>	<b>Dokumenti</b>	Strategjia e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Bashkisë Tiranë 2023-2027			
Draft 1	22 Nëntor 2023	<b>Përshkrimi</b>	Versioni i parë			
			Përgatitur nga	Kontrolluar nga	Miraturar nga	
		Emri	Dael Dervishi Erta Marku Adri Erebara	Aldion Baze Dritan Turabi	Enkelejd Musabelliu	
		Firma				
		<b>Dokumenti</b>				
		<b>Përshkrimi</b>				
			Përgatitur nga	Kontrolluar nga	Miraturar nga	
		Emri				
		Firma				
		<b>Dokumenti</b>				
		<b>Përshkrimi</b>				
			Përgatitur nga	Kontrolluar nga	Miraturar nga	
		Emri				
		Firma				
		<b>Dokumenti</b>				
		<b>Përshkrimi</b>				
			Përgatitur nga	Kontrolluar nga	Miraturar nga	
		Emri				
		Firma				

---

---

## Tabela e Përmbajtjes

1. Hyrje9
  - 1.1 Prezantim9
  - 1.2 Mbi Implementimin e Strategjisë së Zhvillimit të Qëndrueshëm 2018 – 202210
2. Konteksti12
  - 2.1 Demografia12
  - 2.2 Projeksioni i popullsisë 2019-203115
  - 2.3 Zhvillimi Ekonomik17
  - 2.4 Decentralizimi dhe Funkcionet Vendore20
    - 2.4.1 Funkcionet dhe përgjegjësitë e Bashkisë Tiranë21
    - 2.4.2 Funkcionet e veta21
    - 2.4.3 Funkcionet e deleguara22
  - 2.5 Treguesit Ekonomikë dhe Financiarë23
    - 2.5.1 Të ardhurat23
    - 2.5.2 Shpenzimet25
3. Analiza e Gjendjes Aktuale27
  - 3.1 Infrastruktura dhe Shërbimet Publike27
    - 3.1.1 Rrugët, Ndriçimi dhe Infrastruktura Publike27
    - 3.1.2 Ujësjellësi dhe Kanalizimet37
    - 3.1.3 Transporti Publik41
    - 3.1.4 Parkimi46
    - 3.1.5 Infrastruktura Arsimore54
  - 3.2 Zhvillimi Ekonomik59
    - 3.2.1 Biznesi në Tiranë59
    - 3.2.2 Zonat ekonomike, Klasterat dhe Tregjet Publike61
    - 3.2.3 Bujqësia dhe Zhvillimi Rural64
    - 3.2.4 Punësimi dhe Aftësitë65
    - 3.2.5 Sipërmarrja dhe Inovacioni72
  - 3.3 Zhvillimi i Qëndrueshëm dhe Jetueshmëria72
    - 3.3.1 Hapësirat Publike72
    - 3.3.2 Mjedisi, Ndryshimet Klimatike dhe Emergjencat Natyrore74

- 3.3.3 Siguria Publike**76**
- 3.3.4 Turizmi**78**
- 3.3.5 Kultura dhe Sportet**79**
- 3.3.6 Qeverisja e mirë dhe Transparenca**80**
- 3.4. Shërbimet Sociale**82**
  - 3.4.1 Strehimi**82**
  - 3.4.2 Punësimi dhe Papunësia**88**
  - 3.4.3 Ndihma ekonomike dhe PAK**94**
  - 3.4.4 Shërbimet e tjera Sociale**101**
- 3.5 Rinia**104**
  - 3.5.1 Start-upet**105**
  - 3.5.2 Aktivitetet Rinore**107**
  - 3.5.3 Përfshirja në qeverisje**108**
- 4. Vizioni dhe Objektivat**109**
  - 4.1. Deklarata e Vizionit**109**
  - 4.2. Qëllimet Strategjike**109**
  - 4.3. Objektivat Strategjike**109**
- 5. Masat dhe Projektet**113**

## Lista e Figurave

Figura 1 - Bilanci i Lëvizjes së Popullsisë 2010-2020	13
Figura 2 - Popullsia në NJA-të e Shtuara pas Reformës Territoriale të 2014	13
Figura 3 - Dëndësia e Popullsisë sipas Cens 2011	14
Figura 4 - Mosha Mestare e Popullsisë sipas NJA-ve në 2021	15
Figura 5 - Projeksionet e përditësuara të popullsisë sipas 3 skenarëve	15
Figura 6 - Piramidat e popullsisë sipas projeksioneve të përditësuara të popullsisë, 2019-2031	16
Figura 7 - Ndryshimi i popullsisë së qarqeve sipas Projeksionit të Popullsisë	17
Figura 8 - PBB në çmime korrente sipas Qarqeve	17
Figura 9 - Kontributi i qarqeve në Rritjen Ekonomike	18
Figura 10 - Struktura e Vlerës së Shtuar sipas Degëve të Ekonomisë në vitin 2022	19
Figura 11 - Ndërmarrjet Aktive sipas Aktivitetit Ekonomik në Bashkinë Tiranë	19
Figura 12 - Struktura e Ndërmarrjeve sipas Madhësisë	20
Figura 13 - Njësitë administrative të Bashkisë së Tiranës dhe distancat nga qendra e qytetit	28
Figura 14 - Lidhja kryesore drejt dhe nga Tirana	29
Figura 15 - Rrjeti rrugor urban	31
Figura 16 - Harta e Periferialitetit	32
Figura 17 - Aksidente, të plagosur dhe të vrarë në Bashkinë e Tiranës nga aksidentet rrugore	33
Figura 18 - Zona e shërbimit të UKT	37
Figura 19 - Harta e Zonave të Administrimit të Parkimit	47
Figura 20 - Harta e Zonave Tarifore	48
Figura 21 - Parkimi Ekzistues në Rrugë dhe në Sheshe	51
Figura 22 - Shpërndarja e Vend-Parkimeve për Rezidentë	53
Figura 23 - Numri i Bizneseve në Bashkinë Tiranë 2016 - 2022	59
Figura 24 - Bizneset sipas kategorive 2016 - 2022	60
Figura 25 - Bizneset sipas llojit të aktivitetit 2016 - 2022	60
Figura 26 - Harta e Zonës së TEDA	61
Figura 27 - Shpërndarja e Tregjeve Publike nën administrimin e BT	63
Figura 28 - Popullsia e Shqipërisë, 2001-2022	66
Figura 29 - Shkalla e papunësisë	67
Figura 30 - Shkalla e punësimit, papunësisë dhe e pjesëmarrjes në forcat e punës, në Tiranë	68
Figura 31 - Të punësuar kontribues dhe ndërmarrjet aktive në Shqipëri 2014-2021	70
Figura 32 - Numri i aksidenteve rrugore për qarkun e Tiranës	76
Figura 33 - Nr. i lejeve të dhëna për banesa të reja si % ndaj totalit	83
Figura 34 - Banesat Sociale me qira, Bashkia Tiranë, Shkozë	84
Figura 35 - Familjet përfituese të prekura nga tërmeti në Bashkinë Tiranë sipas NJA-ve	87
Figura 36 - Numri i punëkërkuarve sipas moshës .....	90
Figura 37 - Punëkërkuarët e papunë përfitues të NE sipas njësive administrative, 2021	91
Figura 38 - Të punësuar sipas grupmoshës .....	92
Figura 39 - Familjet në NE kundrejt familjeve në NJA (%)	94
Figura 40 - Numri i përfituesve të ndihmës ekonomike sipas njësive (3-mujori i katërt i 2021)	95
Figura 41 - Rritja e aplikimeve për ndihmë ekonomike, shprehur në % për vitin 2021	96
Figura 42 - Persona me aftësi të kufizuara mbi 18 vjeç, 2020	98
Figura 43 - Fëmijë me aftësi të kufizuara, 2020	98

## Lista e Tabelave

- Tabela 1 - Statusi i Implementimit të Strategjisë në fund të vitit 2022**11**
- Tabela 2 - Popullsia në Shqipëri dhe Tiranë (1989-2022)**12**
- Tabela 3 - Popullsia sipas Njësive Administrative**12**
- Tabela 4 - PBB për frymë sipas Qarqeve**18**
- Tabela 5 - Të ardhurat tatimore dhe jotatimore për BT për vitet 2018-2022**23**
- Tabela 6 - Shpenzimet e BT sipas klasifikimit 2018 – 2022 (në 000)**25**
- Tabela 7 - Klasifikimi i Shpenzimeve të BT sipas Programeve**25**
- Tabela 8 - Rrugë të rikonstruara**33**
- Tabela 9 - Bllloqe banimi të rehabilituara**34**
- Tabela 10 - Karakteristikat e burimeve të ujit**38**
- Tabela 11 - Rrjeti i autobusëve urban për linjë**44**
- Tabela 12 - Tarifat e Parkimit në Rrugë**48**
- Tabela 13 - Tarifat e Parkimit të Rezervuar në rrugë**48**
- Tabela 14 - Tarifat e Parkimit në Sheshe**49**
- Tabela 15 - Tarifat e Shërbimit të Parkimit të Rezervuar në Sheshe**49**
- Tabela 16 - Rrugë me parkim me pagesë**50**
- Tabela 17 - Nr. i Vend-Parkimeve në Rrugë të Operuara nga TP**50**
- Tabela 18 - Nr. i Vend-Parkimeve në Sheshe**51**
- Tabela 19 - Nr. i Vend-Parkimeve për Rezidentë sipas ZAP**52**
- Tabela 20 - Vend-Parkimet për Rezidentë që Planifikohet të Shtohen në 2022**52**
- Tabela 21 - Nr. i Vend-Parkimeve të Rezervuara**53**
- Tabela 22 - Nr. i Vend-Parkimeve Taksi**54**
- Tabela 23 - Institucionet Arsimore Parauniversitare**54**
- Tabela 24 - Regjistrimet në Institucionet Arsimore Parauniversitare**54**
- Tabela 25 - Shkolla të reja të ndërtuara në periudhën 2015-2022**55**
- Tabela 26 - Tregjet Publike nën administrimin e Bashkisë Tiranë**62**
- Tabela 27 - Mbjellja dhe Prodhimi në Bujqësi Qarku Tiranë (2021)**64**
- Tabela 28 - Përmbledhje e treguesve të punësimit dhe papunësisë**68**
- Tabela 29 - Pagesat mesatare sipas grup-profesioneve**71**
- Tabela 30 - Hapësira publike**73**
- Tabela 31 - Karakteristikat Kryesore të Programeve të Strehimit Social**83**
- Tabela 32 - Nr. aplikuesve dhe përfituesve të programit "Banesë Sociale me qira" (2015-2018)**85**
- Tabela 33 - Aplikuesit dhe Përfituesit për Programin e Banesave me Kosto të Ulët 2015-2020**85**
- Tabela 34 - Përfituesit e NE/PAK gjatë 2019 dhe 2020 (6MI)**87**
- Tabela 35 - Aplikuesit dhe përfituesit e dy programeve të strehimit 2015 - 2021**88**
- Tabela 36 - Shpërndarja e punëskërkuesve të papunë sipas karakteristikave 2021**89**
- Tabela 37 - Të regjistruarit për punë sipas nivelit të arsimit**92**
- Tabela 38 - Shpërndarja e të punësuarve sipas qendrave komunitare dhe njësive administrative**93**
- Tabela 39 - Dinamika e NE, 3-mujori i katërt i 2021**96**
- Tabela 40 - Llojet e shërbimeve dhe numrin e përfituesve tëPAK në qendrat komunitare**99**
- Tabela 41 - Rastet e dhunës në familje të trajtuara nga Bashkia Tiranë dhe MKR**102**
- Tabela 42 - Zbritjet e përfituara nga Karta e Studentit**104**

## Lista e Shkurtimev

<b>BT</b>	Bashkia e Tiranës
<b>SZHQBT</b>	Strategjia e Zhvillimit të Qëndrueshëm Bashkia Tiranë
<b>DPIPSZHE</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Integritimit, Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit Ekonomik
<b>PPV</b>	Plani i Përgjithshëm Vendor
<b>PLQU</b>	Plani i Lëvizshmërisë së Qëndrueshme Urbane
<b>NjA</b>	Njësi Administrative
<b>INSTAT</b>	Instituti Statistikave të Shqipërisë
<b>PBB</b>	Prodhimi i Brendshëm Bruto
<b>NjVV</b>	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
<b>NjQV</b>	Njësitë e Qeverisjes Vendore
<b>RAT</b>	Reformës Administrative Territoriale
<b>PAK</b>	Persona me Aftesi të Kufizuar
<b>PPVBT</b>	Plani Përgjithshëm Vendor Bashkisë Tiranë
<b>ARRSH</b>	Autoriteti Rrugor Shqiptar
<b>QKTUT</b>	Qendra e Kontrollit të Trafikut Urban të Tiranës
<b>UKT</b>	Shoqëria Ujësjellës-Kanalizimet e Tiranës
<b>ITU</b>	Impianti i Trajtimit të Ujit
<b>SCADA</b>	Supervisory control and data acquisition systems/Sistem i menaxhimit të ujit SCADA
<b>AMK</b>	Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit
<b>SUT</b>	Sustainable Urban Transport/ Transporti i Qëndrueshëm Urban
<b>BRT</b>	Bus Rapid Transport / Transporti i shpejtë me autobus
<b>VKM</b>	Vendim i Këshillit të Ministrave
<b>VKB</b>	Vendim të Këshillit Bashkiak
<b>TP</b>	Tirana Parking
<b>ZAP</b>	Zona të Administrimit të Parkimit
<b>NDP</b>	Nënzonat e Destinuara për Parkim
<b>DKSHM</b>	Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme
<b>RSU1</b>	Rezidenca Studentore Universitare Nr.1
<b>RSU2</b>	Rezidenca Studentore Universitare Nr. 2
<b>KfW</b>	Kreditanstalt Für Wiederaufbau / Banka Gjermane për Zhvillim
<b>TEDA</b>	Technical and Economic Development Area /Zona të Zhvillimit Teknik dhe Ekonomik
<b>AAT</b>	Agjencia e Administrimit të Tregjeve
<b>AFP</b>	Anketa së Forcave të Punës
<b>NEET</b>	Not in Education, Employment, or Training/ Të rinjtë që nuk janë as në edukim, punësim apo trajnim
<b>APR</b>	Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit
<b>BERZH</b>	Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
<b>PVQGJ</b>	Plani i Veprimit “Qyteti i Gjellbër”

<b>MZSH</b>	Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpëtimi
<b>CBRN</b>	Chemical, biological, radiological and nuclear materials/ Ekipi i shpëtimit nga materialet dhe agjentet kimik, biologjik dhe nuklear
<b>KVSP</b>	Këshillat Vendorë të Sigurisë Publike
<b>WTTC</b>	World Travel & Tourism Council/ Këshilli Botëror i Udhëtimit & Turizmit
<b>ZIT</b>	Zyra e Informacionit Turistik
<b>OSS</b>	One-Stop Shop
<b>BKU</b>	Banesë me kosto të ulët
<b>EKB</b>	Enti Kombëtar i Banesave
<b>PPP</b>	Partneritet Publik Privat
<b>PDV</b>	Plane të Detajuara Vendore
<b>BSQ</b>	Banesa Sociale me Qira
<b>MFE</b>	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
<b>NjEF</b>	Njësi Ekonomike Familjare
<b>NE</b>	Ndihmë Ekonomike
<b>AKPA</b>	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
<b>UNDP</b>	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
<b>DPSHS</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social
<b>QS</b>	Qendra Sociale
<b>NJVNR</b>	Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit
<b>MKR</b>	Mekanizmi i Koordinuar i Referimit
<b>NVM</b>	Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme
<b>AAFD</b>	Albanian American Development Foundation/ Fondi Shqiptaro-Amerikan i Zhvillimit
<b>AIK</b>	Agjencia e Industrisë Kreative



# 1. Hyrje

## 1.1 Prezantim

Bashkia e Tiranës në zbatim të ligjit nr. 68, datë 27.04.2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” Kreu VI, neni 15 ka hartuar Strategjinë e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Bashkisë Tiranë për vitet 2018 - 2022 si instrumenti më i lartë i planifikimit strategjik në nivel vendor. Prej disa vitesh tashmë, dinamikat e politikave qeverisëse janë përqëndruar tek fuqizimi i pushtetit vendor në detyrën e tij për përmbushjen e funksioneve të përcaktuara me ligj.

“Strategjia e Zhvillimit të Qëndrueshëm Bashkia Tiranë 2018-2022” u fokusua në prioritizimin e disa prej fushave kryesore, duke përfshirë konsolidimin dhe rigjenerimin urban, përmirësimin e aksesit në arsim dhe krijimin e një sistemi të balancuar të transportit publik. Duke u mbështetur në përvojën e mire të implementimit të kësaj strategjie Bashkia e Tiranës synon të çojë përpara zhvillimin e qëndrueshëm në Tiranë. Duke u mbështetur në sukseset dhe përvojat e strategjisë së mëparshme, SZHQBT 2023-2027 do të ketë për qëllim në vazhdimësi adresimin e sfidave dhe përmbushjen e shumë objektivave të reja.

Përgjatë kësaj periudhe Bashkia e Tiranës ka miratuar disa strategji apo plane veprimi sektoriale, si më poshtë:

- Plani i Përgjithshëm Vendor (PPV) Tirana 030;
- Masterplani i Bulevardit të Ri;
- Plani i Lëvizshmërisë së Qëndrueshme Urbane (PLQU) për Bashkinë Tiranë;
- Masterplani i Lëvizjes me Bicikleta;
- Masterplani i Parkimit për Bashkinë Tiranë;
- Strategjia e Digjitalizimit dhe Inovacionit 2023-2027;
- Plani i Veprimit „Qyteti i Gjellbër”;
- Plani i Veprimit për Kontrollin e Zhurmave në Bashkinë Tiranë 2022-2027;
- Plani Vendor i Veprimit për Intergjimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë Tiranë 2022-2024;
- Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore 2022-2024;
- Plani Lokal Social për Personat me Aftësi të Kufizuara 2022-2024;
- Plani Vendor i Veprimit për Migracionin dhe Diasporën 2022-2026;
- Plani Social i Bashkisë Tiranë 2022-2024;
- Programi 5-Vjeçar i Strehimit në Bashkinë Tiranë 2022-2027.

SZHQBT 2023-2027 priorizon objektiva specifike të caktuara nga këto strategji dhe plane veprimi si edhe prezanton objektiva të reja. Pavarësisht kësaj, këto strategji dhe plane veprimi sektoriale mbeten në fuqi dhe luajnë një rol të rëndësishëm në udhëheqjen e politikë-bërjes në Bashkinë e Tiranës.

## 1.2 Mbi Implementimin e Strategjisë së Zhvillimit të Qëndrueshëm 2018 – 2022

Bazuar në parashikimet e Nenit 32 të Ligjit Nr. 68, datë 27.04.2017 „Për Financat e Vetë-Qeverisjes Vendore“, Bashkia e Tiranës ka hartuar dhe miratuar Strategjinë e Zhvillimit të Qëndrueshëm 2018-2022. Duke u bazuar në vizionin për „*kthimin e Tiranës në një qendër të integruar më së miri në sistemin ekonomik dhe infrastrukturor Evropian, në një nyje intermodale më konkurruese në hapësirën Ballkanike që synon barazji në akses, infrastrukturë, ekonomi dhe dije*“ kjo strategji përmbante 5 qëllime strategjike dhe 22 objektiva strategjike, të cilat do të realizoheshin përmes implementimit të 135 projekteve dhe masave.

Pesë qëllimet e Strategjisë 2018-2022 ishin:

1. Tirana policentrike;
2. Arsimi për të gjithë;
3. Garantimi i zhvillimit të qëndrueshëm të ekonomisë;
4. Tirana për të gjithë; dhe
5. Qeverisja e mirë.

Ndërkohë, 22 objektivat specifike të kësaj strategjie listohen si më poshtë:

1. Rivitalizimi urban i Polit Kombinat si qendër urbane me karakter kreativ, artistik dhe mjeshteror (përfshin 6 masa apo projekte);
2. Rivitalizimi urban i Polit Kinostudio si qendër urbane me karakter artistic dhe kinematografik (përfshin 5 masa apo projekte);
3. Rivitalizimi urban i Polit të Bulevardit Verior si qendër e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik (përfshin 9 masa apo projekte);
4. Rivitalizimi urban i Polit Laprakë si qendër urbane me karakter sportive, edukativ dhe rekreativ (përfshin 6 masa apo projekte);
5. Rivitalizimi urban i Polit Farkë-Qyteti Studenti si qendër urbane me karakter rekreativ, natyror dhe turistik (përfshin 7 masa apo projekte);
6. Përmirësimi i kushteve dhe cilësisë së procesit mësimor (përfshin 6 masa apo projekte);
7. Rritja e aksesit dhe gjithëpërfshirjes në arsimin parauniversitar (përfshin 6 masa apo projekte);
8. Përmirësimi i kushteve të rezidencave studentore universitare (përfshin 7 masa apo projekte);
9. Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve dhe pajisja me infrastrukturën e nevojshme për bizneset (përfshin 12 masa apo projekte);
10. Mbështetje financiare dhe incentiva fiskale për bizneset (përfshin 4 masa apo projekte);
11. Rritja e konkurrueshmërisë dhe thithja e investimeve të huaja (përfshin 16 masa apo projekte);
12. Nxitja e mobilitetit alternativ dhe të qëndrueshëm për rritjen e aksesueshmërisë (përfshin 11 masa apo projekte);
13. Rritja e kapacitetit të parkimit në zonën qendrore të biznesit dhe përdorimi eficient i hapësirave ekzistuese (përfshin 5 masa apo projekte);
14. Shtimi i hapësirave të gjelbërta (përfshin 5 masa apo projekte);
15. Transport publik me efikasitet të lartë mbi 5 km (përfshin 6 masa apo projekte);
16. Përmirësimi i cilësisë së jetës së qytetarëve (përfshin 3 masa apo projekte);
17. Sistem i përmirësuar i menaxhimit të mbetjeve (përfshin 3 masa apo projekte);
18. Furnizimi i qëndrueshëm me ujë të pijshëm (përfshin 9 masa apo projekte);
19. Përmirësimi i shërbimit të varrezave publike (përfshin 2 masa apo projekte);

20. Rritja dhe forcimi i kapaciteteve institucionale dhe burimeve njerëzore në nivel vendor (përfshin 2 masa apo projekte);
21. Sigurimi i një qeverisjeje transparente dhe rritja e llogaridhënies (përfshin 2 masa apo projekte);
22. Forcimi i financave vendore (përfshin 3 masa apo projekte).

Bazuat në Raportin e Vlerësimit mbi Implementimin e Strategjisë 2018-2022, të hartuar nga FLAG, Strategjia 2018-2022 është implementuar suksesshëm nga ana e Bashkisë Tiranë. Në këtë mënyrë, deri në fund të vitit 2022, nga 22 objektivat që përfshin strategjia, 14 ishin implementuar plotësisht dhe 8 ishin në proces. Gjithashtu, deri në fund të vitit 2022, 89 projekte (66%) ishin implementuar plotësisht, 45 projekte (35%) ishin në proces dhe vetëm 1 projekt nuk kishte nisur akoma. Nga 5 qëllimet që përfshin Strategjia, numri më i lartë i projekteve të implementuara i përket qëllimit “Tirana për të gjithë” (31), pasuar nga “Garantimi i zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik” (23), “Tirana policentrike” (16), “Arsimi për të gjithë” (13) dhe “Qeverisja e mirë” (6).

Duke qenë se qëllimet e Strategjisë përfshijnë disa më shumë e disa më pak projekte, për të krijuar një ide më të qartë se cili nga qëllimet strategjike është implementuar më mirë, i referohemi përqindjes së projekteve të implementuara për secilin qëllim. Kështu, “Qeverisja e mirë” është implementuar në masën 86%, pasuar nga “Garantimi i zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik” (72%), “Tirana për të gjithë” (72%), “Arsimi për të gjithë” (68%) dhe “Tirana policentrike” (47%).

Tabela 1 - Statusi i Implementimit të Strategjisë në fund të vitit 2022

Statusi	Qëllimi 1	Qëllimi 2	Qëllimi 3	Qëllimi 4	Qëllimi 5
Nr. i projekteve	34	19	32	43	7
Implementuar	16	13	23	31	6
Në proces	18	6	9	11	1
Nuk ka nisur	0	0	0	1	0
Implementimi (%)	47%	68%	72%	72%	86%

Raporti i Vlerësimit të Implementimit të Strategjisë 2018-2022 ka lënë edhe një sërë rekomandimesh për t’u marrë në konsideratë edhe gjatë hartimit të Strategjisë së re, të cilat përmblihen si më poshtë:

1. Strategjia është hartuar mire, me vizionin dhe qëllimet të shprehura qartë. Megjithatë, jo të gjitha objektivat strategjikë janë përpiluar sipas metodologjisë SMART dhe për shumë prej tyre mungonte afati kohor apo mënyra se si do të matej implementimi i tyre. Rekomandohet që strategjia e re të jetë më e mirë-strukturuar, më më shumë programe, me përdorimin e objektivave SMART, me indikatorë të qartë e të matshëm dhe me një dallim të qartë mes projekteve dhe synimeve (targets).
2. Nga anketa e zhvilluar me qytetarët rezulton se ata shohin si prioritete për t’u përfshirë në strategjinë e re fushat e mëposhtme: infrastruktura urbane, infrastruktura arsimore, uji i pijshëm, transporti publik, zhvillimi ekonomik, shërbimet sociale, siguria publike, pastrami i qytetit, mbrojtja e mjedisit dhe promovimi i qytetit.

## 2. Konteksti

Me ndarjen administrative të vitit 2014, Bashkisë së Tiranës iu bashkuan edhe territoret e 13 ish-komunave, duke e shpënë popullsinë e kësaj bashkie në rreth 1 milion banorë dhe sipërfaqen e saj në 1,110 km<sup>2</sup>. Përveç popullsisë dhe sipërfaqes, reforma administrative-territoriale e vitit 2014 rriti edhe detyrat e përgjegjësitë e bashkive duke zgjeruar gamën e shërbimeve që ato ofrojnë për qytetarët. Në këto kushte, digjitalizimi dhe inovacioni parashikohet të luajnë një rol kyç në përmirësimin e aksesit në shërbimet publike dhe ofrimin e tyre në mënyrë eficiente.

### 2.1 Demografia

Në bazë të Censurit të fundit të popullsisë, atij të vitit 2011, popullsia e Shqipërisë ishte 2,800,138 banorë, ndërsa sipas INSTAT, në 2023, popullsia e Shqipërisë përlllogaritet në 2,761,785 banorë. Ndërkohë që popullsia në Shqipëri është duke u ulur si pasojë e migracionit dhe normave të ulëta të fertilitetit, Tirana është qyteti i vetëm në Shqipëri popullsia e të cilit vazhdon të rritet, edhe pse norma e rritjes është ngadalësuar krahasuar me vitet e para të tranzicionit. Në fillim të viteve '90, në Tiranë banonin 280 mijë persona, ndërsa rezultatet e Censurit të vitit 2001 treguan se popullsia e Tiranës u dyfishua dhe arriti në 596,704 banorë, dhe në Censurin e vitit 2011 popullsia arriti në 749,365 banorë, thuhet tre herë më shumë se në Censurin e vitit 1989. Krahas rritjes natyrore, faktori kryesor që ka ndikuar në rritjen e popullsisë së Tiranës është migrimi i brendshëm, ardhja e banorëve nga të gjitha zonat e vendit dhe vendosja e tyre në këtë qytet.

Tabela 2 - Popullsia në Shqipëri dhe Tiranë (1989-2022)

	Cens 1989	Cens 2001	Dif. në % (1989 – 2001)	Cens 2011	Dif. në % (2001 – 2011)	2021	Dif. në % (2011 – 2021)
<b>Shqipëria</b>	3,182,417	3,069,275	-3.55	2,800,138	-8.76	2,793,592	-0.23
<b>Tirana</b>	438,755	597,899	36.2	749,365	25.33	863,694	15.25

Megjithëse popullsia e Tiranës si e tërë është rritur me shpejtësi, kjo rritje nuk është e shpërndarë në mënyrë të barabartë midis Njësive Administrative të saj. Tabela dhe grafiku i mëposhtëm tregojnë rritjen e popullsisë sipas Njësive Administrative të Tiranës.


Tabela 3 - Popullsia sipas Njësive Administrative

NjA	2010	2015	2020	2021
NjA 1	50,044	51,731	51,816	51,885
NjA 2	74,674	80,247	83,371	83,827
NjA 3	42,734	44,139	45,391	45,681
NjA 4	61,077	63,171	65,511	65,749
NjA 5	77,792	84,108	87,312	87,495
NjA 6	62,550	70,921	74,135	71,771
NjA 7	64,385	70,894	75,793	77,124
NjA 8	39,611	41,411	41,524	41,309
NjA 9	56,695	60,435	63,713	65,320
NjA 10	27,534	28,783	27,608	27,637

NjA 11	62,502	65,438	65,279	64,853
Lagjia nr. 12			14,829	
Lagjia nr. 13			10,827	
Lagjia nr. 14			28,792	

Njësitë Administrative 1, 3, 8, 10, 12 dhe 13 kanë qëndruar në vlera të stabilizuara. Ndërsa Njësitë Administrative 2, 4, 5, 6, 7, 8 dhe sidomos 14 janë rritur në madhësi. Zonat më të populluara janë Njësia Administrative 2, 5, 6, 7 dhe kjo radhë nuk ka ndryshuar midis Censuseve. Një tregues në zhvillimin demografik të Tiranës, është ritmi i lartë i rritjes së popullsisë në Lagjet 13 dhe 14, ku këto Njësi Administrative shërbejnë si periferi e qytetit të Tiranës dhe janë kthyer në mënyrë të natyrshme në zona banimi më të pëlqyeshme nga qytetarët.

Figura 1 - Bilanci i Lëvizjes së Popullsisë 2010-2020



Sa u përket Njësive Administrative Rurale, të cilat i janë bashkuar Bashkisë së Tiranës vetëm pas reformës territoriale të vitit 2014, gjatë dekadës së fundit ato kanë pasur një numër të qëndrueshëm popullsie, me përjashtim të Kasharit, Farkës dhe Dajtit popullsia e të cilave është rritur në mënyrë eksponenciale.


Figura 2 - Popullsia në NjA-të e Shtuara pas Reformës Territoriale të 2014

Njësia Administrative	2010	2015	2020	2021
Nja. Baldushk	5,243	5,356	5,367	5,342
Nja. Berzhite	5,753	5,861	5,911	5,936
Nja. Dajt	11,94	15,195	26,178	28,315
Nja. Farke	11,622	13,259	23,595	26,019
Nja. Kashar	21,524	25,034	51,622	58,664
Nja. Krrabë	3,064	3,098	3,049	3,028
Nja. Ndroq	9,124	9,210	9,777	9,642
Nja. Petrelë	6,402	6,577	6,832	6,883

Nja. Pezë	5,649	5,823	6,053	6,301
Nja. Shëngjergj	2,770	2,728	2,541	2,502
Nja. Vaqarr	9,056	10,018	10,589	10,654
Nja. Zall Bastar	5,456	5,546	5,174	5,127
Nja. Zall Herr	10,647	11,548	12,389	12,63


Dendësia e popullsisë në Bashkinë e Tiranës për vitin 2021 është 777 banorë për km<sup>2</sup>. Kjo shifër është shumë më e lartë se dendësia në nivel kombëtar e cila është 97 banorë për km<sup>2</sup>. Sa i përket Tiranës urbane, dendësia mesatare e popullsisë është mbi 20 mijë banorë për km<sup>2</sup>. Dendësinë më të lartë e ka NJA 10 me mbi 35 mijë banorë për km<sup>2</sup> ndërsa dendësinë më të ulët e ka NJA 2 me rreth 9 mijë banorë për km<sup>2</sup>.

Figura 3 - Dëndësia e Popullsisë sipas Cens 2011



Mosha mesatare e popullsisë së Tiranës është rritur nga afërsisht 36.4 vjeç në vitin 2020 në afërsisht 36.6 vjeç në vitin 2021. Banorët me moshën mesatare më të re e ka Lagjia 13 me 31.5 vjeç, ndërsa me moshën mesatare më të vjetër i ka Njësia Administrative nr.4 me moshë mesatare 40 vjeç. Megjithatë, në Tiranë vihet re një tendencë në rritje e moshës mesatare të popullsisë. Mosha mediane sipas njësive administrative paraqitet në figurën më poshtë. NJA-ja me popullsinë më të moshuar është NJA 10, ndërsa NJA-të me popullsinë më të re janë NJA 11 dhe Lagjet nr. 13 dhe 14.

Figura 4 - Moshë Mestare e Popullsisë sipas NJA-ve në 2021



## 2.2 Projektioni i popullsisë 2019-2031

Bazuar në rekomandimet ndërkombëtare INSTAT përditëson çdo 5 vjet projektionet e popullsisë. Popullsia e Shqipërisë në vitin 2031, sipas projeksioneve të përditësuara, llogaritet të jetë 2.745.996 banorë. Ky numër është rreth 36 mijë banorë më pak krahasuar me numrin e popullsisë në Projektionet e Popullsisë 2011 – 2031. Ndryshimi i këtij numri është pasojë direkte e normave më të ulta të lindshmërisë dhe shpërndarja gjinore e emigrantëve e cila nuk përkon me hipotezën e Projektioneve të Popullsisë 2011 – 2031.




Figura 5 - Projektionet e përditësuara të popullsisë sipas 3 skenarëve

(Burimi: INSTAT Projektioni i Popullsisë)

Gjatë periudhës 2011 – 2018, normat e emigrimit të burrave rezultuan të ishin më të larta se ato që u supozuan në projektionet e mëparshme. Ndërsa për gratë rezultoi e kundërta, normat e emigrimit ishin disa herë më të ulta se ato të supozuara më parë. Këto ndryshime në sjelljet migratore, kanë sjellë edhe ndryshimin e strukturës gjinore të popullsisë.

Në vitin 2011, Shqipëria ishte një vend ku kishte më shumë burra se sa gra. Kjo tashmë ka ndryshuar në vitin 2019, pasi në Shqipëri raporti gjinor qëndron në 99,8 burra për çdo 100 gra. Sipas projeksioneve të përditësuara, raporti gjinor pritet të thellohet në favor të grave duke arritur deri në 89,1 burra për çdo 100 gra. Popullsia e Shqipërisë do të vazhdojë procesin e plakjes dhe pritet që mosha medianë e saj të arrijë në 42,1 vjeç, në vitin 2031. Ky proces i plakjes shoqërohet me rritjen e shpejtë të koeficientit të varësisë së të moshuarve nga rreth 20,5 të moshuar për 100 persona në moshë pune në vitin 2019, në rreth 35,0 të moshuar për çdo 100 persona në moshë pune. Gjatë kësaj periudhe koeficienti i varësisë së të rinjve do të qëndrojë në nivele konstante prej rreth 25 të rinj për çdo 100 persona në moshë pune.





Figura 6 - Piramidat e popullsisë sipas projeksioneve të përditësuara të popullsisë, 2019-2031.

(Burimi: INSTAT Projektioni i Popullsisë)

Ndryshimet demografike që pritet të kalojë popullsia e Shqipërisë deri në vitin 2031 do të kenë ndikimin e tyre edhe në shpërndarjen e saj ndërmjet qarqeve të vendit. Deri në vitin 2031, vetëm popullsia e qarkut të Tiranës pritet të jetë më e lartë se ajo e vitit 2019, duke arritur në rreth 954 mijë banorë. Në vitin 2031, në qarkun e Tiranës pritet të banojë rreth 35 % e popullsisë së Shqipërisë.



Figura 7 - Ndryshimi i popullsisë së qarqeve sipas Projektionit të Popullsisë.



(Burimi: INSTAT Projektioni i Popullsisë)

### 2.3 Zhvillimi Ekonomik

Në kontekstin e zhvillimit ekonomik Qarku i Tiranës si një nga qarqet më të mëdha të vendit luan një rol shumë të rëndësishëm në ecurinë e zhvillimit ekonomik të të gjithë vendit. Në vitin 2021, sipas rajoneve statistikore në nivel 1 (Republika e Shqipërisë), PBB me çmime korrente u vlerësua 1.856.172 milionë Lekë, duke shënuar një rritje në terma realë prej rreth 8,91 %, krahasuar me vitin 2020. Kontributin më të madh në rritjen ekonomike për vitin 2021, e ka dhënë Qarku Tiranë me +4,93 pikë përqindje.

Po ashtu PBB me çmime korrente në rajonin Qendër (Tiranë – Elbasan) për vitin 2021 ishte 936.4 miliardë Lekë ose 50.45% ndaj totalit të PBB. Krahasuar me vitin 2020 PBB, në terma reale shënoi një rritje prej 10.84%.

Figura 8 - PBB në çmime korrente sipas Qarqeve





Figura 9 - Kontributi i qarqeve në Rritjen Ekonomike




Sipas të dhënave të INSTAT, në vitin 2020 niveli më i lartë i PBB-së për frymë sipas rajoneve statistikore në nivel qarku, ishte në Qarkun Tiranë, me 777,144 Lekë, me një rënie prej -3,23% krahasuar me vitin 2019, si pasojë krizës së përgjithshme ekonomike të shkaktuar nga panedmia covid-19.

Tabela 4 - PBB për frymë sipas Qarqeve

Qarku	PBB 2019	PBB 2020	Rritja e PBB për frymë/ çmime korrente (%)
Shqipëria	592.717	579.339	-2,27
Dibër	434.068	420.554	-3,39
Durrës	593.219	563.170	-4,68
Kukës	359.447	364.558	1,27
Lezhë	427.164	412.546	-3,99
Shkodër	427.185	416.186	-2,53
Elbasan	412.375	418.570	2,00
<b>Tiranë</b>	802.447	<b>777.144</b>	<b>-3,23</b>
Berat	470.301	473.936	1,18
Fier	640.762	618.812	-4,01
Gjirokastër	617.526	614.013	-0,01
Korçë	441.635	433.916	-1,30
Vlorë	492.758	493.910	0,10

Një tjetër tregues kyç është vlera e shtuar sipas degëve të ekonomisë. Siç mund të vërehet edhe nga grafiku më sipër, me përjashtim të degëve “Bujqësia dhe Peshkimi”, “Industria Nxjerrëse e Përpunuese” dhe “Aktivitete financiare”, për të gjitha degët e tjera të ekonomisë, në Qarkun Tiranë është gjeneruar më shumë vlerë e shtuar se në të gjitha qarqet e tjera të marra së bashku.


Figura 10 - Struktura e Vlerës së Shtuar sipas Degëve të Ekonomisë në vitin 2022



Sipas të dhënave të Bashkisë Tiranë për vitin 2022, në Tiranë ushtrojnë aktivitetin e tyre **53,168** ndërmarrje, ose 29.2% e ndërmarrjeve aktive në shkallë vendi. Ndërkohë që numri i ndërmarrjeve aktive në shkallë vendi është rritur me 11.7% nga viti 2017 në vitin 2021, në Tiranë, për të njëjtën periudhë kohore, numri i ndërmarrjeve aktive është rritur me 11%.

Pjesa më e madhe e ndërmarrjeve, rreth 33% e ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushën e shërbimeve. Një numër i lartë ndërmarrjesh, rreth 29% e totalit, e ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushën e tregtisë. Numri i ndërmarrjeve që e ushtrojnë aktivitetin e tyre në Bujqësi apo Industri është realtivisht i ulët.


Figura 11 - Ndërmarrjet Aktive sipas Aktivitetit Ekonomik në Bashkinë Tiranë



Aktivitetet kryesore ekonomike në Tiranë janë shërbimet me 33% dhe tregtia me 29%, ndërkohë që aktivitetet ekonomike me peshën më të vogël janë transporti me 3% dhe bujqësia me 1%. Krahasuar me bashkitë e tjera, ku ndërmarrjet bujqësore zënë peshën kryesore, Tirana ka ekonominë më pak bujqësore në vend. Ndërkohë që vlen të përmendet se aktiviteti ekonomik me rritjen më të lartë të numrit të ndërmarrjeve është informacioni dhe telekomunikacioni me një rritje prej 9%.

Figura 12 - Struktura e Ndërmarrjeve sipas Madhësisë

● 1-4 te punesuar      ● 5-9 te punesuar  
 ● 10-49 te punesuar      ● 50+ te punesuar



Ekonomia e Tiranës, ashtu si e gjithë Shqipërisë mbështet mbi biznesin e vogël.

Nëse shohim strukturën e ndërmarrjeve aktive sipas madhësisë vërehet se 84% e ndërmarrjeve aktive në Tiranë kanë 1-4 punonjës dhe vetëm 2% e ndërmarrjeve kanë mbi 50 punonjës.

Megjithatë, krahasuar me vendin, në Tiranë vërehet një përqëndrim më i lartë i bizneseve të mëdha. Kështu, ndërkohë që në rang kombëtar bizneset me më shumë se 50 të punësuar përbëjnë vetëm 1% të totalit, në Tiranë ato përbëjnë 2% të totalit.

Në vitin 2021, sipas të dhënave të INSTAT, forcat e punës në Shqipëri numërojnë rreth 1,411,308 persona, të cilët përfaqësojnë popullsinë aktive të përbërë nga të punësuarit dhe të papunët në vend. Numri i të papunëve vlerësohet të jetë 162,560 persona. Në vitin 2021, në qarkun e Tiranës, punësimi në bujqësi zë një përqindje shumë të vogël të punësimit gjithsej (5%). Pjesa më e madhe e të punësuarve janë të angazhuar në sektorin e shërbimeve (69%) dhe një peshë të konsiderueshme zë edhe industria (27%). Përgjatë viteve, në Tiranë vihet re një rënie e të punësuarve në bujqësi dhe një rritje e të punësuarve në shërbime.

## 2.4 Decentralizimi dhe Funkzionet Vendore

Ligji nr. 115/2014 “Për Ndarjen Administrative-Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë” zyrtarizoi procesin e decentralizimit dhe reformës territoriale. Ky ligj pasoi me ndryshimet përkatëse të ligjit nr. 8654 “Për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë së Tiranës” si dhe ligji nr. 8652 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore” të cilët u shoqëruan me ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

Funksionet që ndryshuan si pasojë e kësaj reforme dhe struktura e re e qeverisjes vendore shpjegohet si më poshtë:

#### 2.4.1 Funkzionet dhe përgjegjësitë e Bashkisë Tiranë

Njësitë e vetëqeverisjes vendore (NJVV) ushtrojnë funksione dhe kompetenca. Ligji i ri nr. 139/2015, në të cilin rishikohet në themel baza e funksioneve dhe kompetencave të njësive vendore, kategorizon dy tipe funksionesh: funksione të veta dhe funksione të deleguara, duke suprimuar ndarjen në funksione të përbashkëta. Gjithashtu krijohet për herë të parë koncepti i “decentralizimit asimetrik” të funksioneve dhe kompetencave. Funksionet e deleguara u transferohen njësive të vetëqeverisjes vendore me ligj ose me marrëveshje. Në çdo rast delegimi i funksioneve shoqërohet nga transferata specifike e qeverisjes qendrore për të financuar koston e ushtrimit të këtyre funksioneve. NJVV bazohet në këto parime për ushtrimin e funksioneve të saj:

- Rregullojnë dhe administrojnë ushtrimin e funksioneve të veta në mënyrë të plotë dhe të pavarur, në përputhje me Kushtetutën, Kartën Evropiane të Autonomisë Vendore dhe ligjet në fuqi;
- Ushtrojnë funksionet duke respektuar politikat kombëtare dhe rajonale. Për këto funksione, qeverisja qendrore mund të vendosë standarde dhe norma specifike të përgjithshme, me qëllim ruajtjen e interesave kombëtare dhe ofrimin e shërbimeve cilësore;
- Në rastet kur NJVV nuk zotërojnë fondet ose mjetet e mjaftueshme për arritjen e standardeve dhe normave kombëtare, qeverisja qendrore u jep atyre mbështetjen e nevojshme financiare;
- Administrojnë ushtrimin e funksioneve të deleguara, sipas legjislacionit në fuqi;
- Kur NJVV ushtrojnë funksionet e deleguara, qeverisja qendrore siguron mjete dhe burime financiare të mjaftueshme për të ushtruar këto funksione në mënyrën dhe në atë nivel ose standard, i cili është përcaktuar me ligj.

#### 2.4.2 Funksionet e veta

Ligji nr. 139/2015 përcakton funksionet e veta të njësive të vetëqeverisjes vendore si funksione që janë përgjegjësi vetëm e njësive të pushtetit vendor si dhe financimi i tyre bëhet nga pushteti vendor. Funksionet ekskluzivë për të cilat njësitë e qeverisjes vendore kanë autoritet investimi, shërbimi, administrimi dhe rregullatorë në këtë ligj janë ndarë janë në varësi të fushës së shërbimit: (i) infrastrukturën dhe shërbimet publike; (ii) shërbimet sociale; (iii) kulturën, sportin dhe shërbimet argëtuese; (iv) mbrojtjen e mjedisit; (v) bujqësinë, zhvillimin rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit; (vi) zhvillimin ekonomik vendor; si dhe (vii) sigurinë publike.

Me anë të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, 61 bashkive u janë transferuar 6 funksione të reja ekskluzive. Decentralizimi i këtyre funksioneve është bërë me qëllim që shërbimi i këtyre funksioneve të jetë më afër qytetarëve.

Këto funksione janë si më poshtë:

- Personeli mbështetës i arsimit parashkollor dhe parauniversitar. Ligji i ri “Për vetëqeverisjen vendore” përcakton NJQV si administrator dhe manaxher të gjithë sistemit të arsimit

parashkollor, (kopshte dhe çerdhe), duke përfshirë edhe emërimin dhe shkarkimin e personelit mësimdhënës. Përsa i përket arsimit parauniversitar, funksioni kufizohet vetëm me emërimin e stafit mbështetës.

- Menaxhimi i pyjeve dhe kullotave. Ligji i ri nr.139/2015 gjithashtu përcakton transferimin e menaxhimit të pyjeve dhe kullotave në njësitë bazë të vetëqeverisjes vendore (bashkitë).
- Gjithashtu, transferohet në bashki edhe menaxhimi i institucioneve që shërbejnë për këtë funksion. Përgjegjësitë shtesë përfshijnë: (i) krijimin dhe administrimin e sistemit vendor të informacionit dhe këshillimit bujqësor e rural; (ii) administrimin dhe mbrojtjen e tokave bujqësore e të kategorive të tjera të burimeve; (iii) Krijimin dhe administrimin e skemave të granteve lokale për bujqësi dhe zhvillim rural, të financuara nga buxheti lokal dhe/ose bashkë financiar me palët e treta, duke garantuar akses të balancuar.
- Mirëmbajtja e rrugëve rurale. Me reformën territoriale dhe përfshirjen e NJA-ve rurale lindi nevoja për një kategorizim të ri të rrugëve të përcaktuara si rrugë rurale me ndarjen e vjetër administrative dhe që tani janë bërë pjesë e një bashkie të vetme.
- Administrimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit. Bazuar në ligjin e ri 139/2015 bashkitë tashmë janë kompetente edhe për, mirëmbajtjen dhe administrimin e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit. Kjo infrastrukturë do të transferohet në pronësi të tyre. Në sistemet e mëdha, Bashkitë/Organizata e përdoruesve të Ujit do të jenë përgjegjës për kanalet e ujitjes sekondare dhe terciare dhe për kanalet e kullimit terciarë.
- Mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi. Në bazë të ligjit të ri “Për Vetëqeverisjen Vendore”, shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe administrimi i strukturave përkatëse, do të jetë një funksion ekskluziv i 61 bashkive të krijuara pas Reformës Administrative Territoriale (RAT). Kjo do të thotë se bashkitë do të jenë përgjegjëse për të garantuar funksionimin e njësisë të Policisë të Mbrojtjes nga zjarri dhe të shpëtimit në të gjithë territorin e tyre.
- Administrimi i disa qendrave sociale nga Bashkitë. Ligji i ri "Për vetëqeverisjen vendore" përcakton një numër të konsiderueshëm kompetencash të reja për bashkitë në fushën e shërbimeve sociale. Sipas këtij ligji, bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e funksioneve të mëposhtme: (i) krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale për të varfërit, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, të moshuarit, etj; (ii) ndërtimin dhe manaxhimin e apartamenteve për banim social, në mënyrën e parashikuar me ligj; (iii) ndërtimin dhe manaxhimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale lokale; (iv) krijimin e një fondi për financimin e shërbimeve sociale në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mirëqenie sociale, siç përcaktohet me ligj.

#### 2.4.3 Funksionet e deleguara

Neni 30 i ligjit nr. 139/2015 trajton funksionet dhe kompetencat e deleguara. Kjo është një pjesë shumë delikate jo vetëm e ligjit por edhe e marrëdhënieve të pushtetit qendror dhe atij vendor, aq më tepër tani që funksionet e përbashkëta (funksionet që kryheshin edhe nga pushteti qendror edhe nga ai vendor) janë suprimuar. Nga ky nen del qartë fakti që këto funksione mund të jenë ose jo të detyrueshme. Në qoftë se ato janë të detyrueshme duhet të jenë të përcaktuara si të tilla shprehimisht me ligj. Ligji që i delegon një funksion bashkive duhet të përcaktojë edhe fondet e nevojshme për kryerjen e këtij funksioni dhe mënyrën se si do të disbursohen këto fonde në llogari të bashkisë.

Në rastin e funksioneve të deleguara jo të detyrueshme duhet të kemi një marrëveshje të dyanshme mes institucionit përkatës të pushtetit qendror dhe bashkisë. Gjithashtu institucionet qendrore mund të autorizojnë bashkinë dhe/ose qarkun të ushtrojnë një kompetencë të vetme për një funksion të caktuar. Në këtë nen nuk janë dhënë në mënyrë specifike se cilat janë funksionet e deleguara duke e bërë këtë nen të përgjithshëm. Funksionet e deleguara do të përcaktohen në ligje të veçanta (të detyrueshme) dhe në marrëveshje përkatëse (të padetyrueshme). Në çdo rast, qeverisja qendrore u garanton njësitëve të vetëqeverisjes vendore mbështetjen e nevojshme financiare për ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të deleguara. Bashkia ose qarku, me nismën e tyre, mund të përdori edhe burimet e veta financiare për ushtrimin e funksioneve e të kompetencave të deleguara, me synim për ngritjen në nivel më të lartë të shërbimit në interes të qytetarëve. Një nga funksionet që është konsideruar deri tani dhe që do vazhdojë të konsiderohet edhe me ligjin e ri nr. 139/2015 si funksion i deleguar është funksioni i gjendjes civile.

## 2.5 Treguesit Ekonomikë dhe Financiarë

### 2.5.1 Të ardhurat

Burimet e të ardhurave të BT mund të grupohen në tre kategori të gjëra:

1. Të ardhurat nga taksat vendore;
2. Të ardhurat nga tarifat; dhe
3. Transfertat nga buxheti i shtetit.

Përgjatë viteve të fundit, falë mire-administrimit dhe konsolidimit financiar, të ardhurat e BT janë rritur në mënyrë konstante. Kështu, nga viti 2018 në vitin 2022, të ardhurat e BT janë rritur me 24%, nga rreth 12.7 miliardë Lekë në vitin 2018 në mbi 15.7 miliardë Lekë në vitin 2022. Në raste specifike, të ardhurat faktike kanë rezultuar edhe më të larta sesa të ardhurat e planifikuara. Kështu, sipas Raportit të Monitorimit të Buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2022 rezulton se Plani i të Ardhurave për vitin 2022 është miratuar në masën 14,407,253,000 Lekë. Në mbyllje të vitit 2022 rezulton se të ardhurat janë realizuar në masën 15,738,670,689 Lekë ose në masën 109% të planit.

Tabela 5 - Të ardhurat tatimore dhe jotatimore për BT për vitet 2018-2022

Emërtimi	2018	2019	2020	2021	2022
<b>TË ARDHURA NGA TAKSAT</b>					
Taksa mbi ndërtesën	1,814,996,615	1,838,563,831	1,916,932,784	2,310,011,275	2,237,542,445
Tatmi i thjeshtuar mbi fttmin e BV	156,413,623	171,559,116	206,546,516	230,422,386	29,022,177
Taksa e fjetjes në hotel	98,004,072	113,966,275	35,815,582	67,226,382	111,515,607
Taksa e Ndikimit në Infr. nga ndërtimet e Reja	5,398,328,978	6,315,307,289	6,350,959,457	7,438,141,907	7,414,035,966
Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për Paluajatshme	326,192,912	326,363,132	365,273,593	445,977,729	538,304,919
Taksa vjetore e mjeteve të përdorura	406,962,488	433,146,135	442,712,995	466,305,347	490,556,445
Taksa e Tabelës	307,879,375	268,203,139	236,214,879	260,113,743	296,186,327

Taksa mbi tokën bujqësore	22,757,271	20,299,189	21,207,054	22,183,650	23,431,924
Taksa mbi truallin	55,345,234	56,079,090	50,714,059	65,136,671	85,213,072
Taksa e përkohshme e Infr. Arsimore	730,095,161	699,773,149	649,392,794	756,967,278	759,519,645
<b>Total (I)</b>	<b>9,316,975,729</b>	<b>10,243,260,345</b>	<b>10,275,769,713</b>	<b>12,062,486,368</b>	<b>11,985,328,527</b>
<b>TË ARDHURA NGA TARIFAT</b>					
Tarifa e Pastrimit	1,884,280,144	1,790,530,651	1,942,311,068	2,238,769,978	2,300,196,016
Tarifa e Parkimit	454,788,832	469,401,688	400,015,660	498,689,407	530,625,181
Tarifa për shqyrtimin e kërkesës për leje për punime	462,929,640	477,529,142	594,764,275	664,327,871	324,432,169
Tarifa për zënien e hapësirave publike	386,489,538	385,666,800	223,680,468	276,055,695	346,830,117
<b>Pagesa</b>					
TR nga Kopshtet	119,123,817	128,533,229	89,124,960	138,846,520	156,159,803
TR nga Cerdhet	69,329,019	74,912,390	50,759,970	78,146,033	85,353,791
TR nga Konviktet	6,744,125	6,103,881	4,572,310	4,777,298	9,745,085
<b>Total (II)</b>	<b>3,383,685,115</b>	<b>3,332,677,781</b>	<b>3,305,228,711</b>	<b>3,899,612,802</b>	<b>3,753,342,162</b>
<b>TE ARDHURA NGA BUXHETI I SHTETIT</b>					
<b>Transferta e pakushtëzuar (III)</b>	3,033,269	3,973,627	3,345,124	3,187,913	4,335,767
<b>TOTALI (I+II+III)</b>	<b>12,703,694,113</b>	<b>13,579,911,753</b>	<b>13,584,343,548</b>	<b>15,965,287,083</b>	<b>15,743,006,456</b>

*Burimi: Bashkia Tiranë*

Të ardhurat nga taksat vendore përbëjnë burimin kryesor të të ardhurave të BT, duke pasur një peshë specifike prej mbi 76% të totalit të të ardhurave në vitin 2022. Ndërsa të ardhurat nga tarifatat përbëjnë rreth 14% të totalit të të ardhurave të BT, të ardhurat nga buxheti i shtetit përmes transfertës së pakushtëzuar kanë një peshë specifike thuajse të papërfillshme.

Është me rëndësi të theksohet se buxheti i shtetit kontribuon në buxhetin e BT edhe përmes transfertave të kushtëzuara, të cilat përdoren për financimin e funksioneve të deleguara dhe nuk miratohen si pjesë përbërëse e buxhetit të NJVV-ve, por reflektohen në dokumentat e realizimit të buxheteve si fonde të administruara. Funksione të deleguara mund të përmenden shërbimi i gjendjes civile, pagesa e ndihmës ekonomike, pagesa e aftësisë së kufizuar, etj.

Sa i përket peshës specifike të taksave vendore, për vitin 2022 influencën më të madhe e kanë pasur “Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë nga Ndërtimet e reja” duke kontribuar me 61% në totalin e të ardhurave nga taksat vendore, ndjekur nga taksa mbi ndërtesën që për të njëjtin vit ka kontribuar me 18% dhe taksa e përkohshme për infrastrukturën arsimore që ka kontribuar me 6%.

Përgjithësisht, të ardhurat nga secila taksë janë rritur, me përjashtim të të ardhurave të mbledhura nga “Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e Biznesit të vogël” për vitin 2022 e cila është ndjeshëm më e ulët se vitet paraardhëse. Kjo ka ardhur si pasojë e ndryshimeve të legjislacionit të Tatimit mbi të Ardhurat, ku bizneset e vogla xhiroja e të cilëve nuk e kalon vlerën 14 milionë Lekë në vit, u përjashtuan nga tatimi mbi fitimin deri në vitin 2029.



Të ardhurat nga tarifat vendore përbëjnë rreth 24% të totalit të të ardhurave të BT. Tarifat me kontributin më të lartë në të ardhurat e BT janë ato të pastrimit dhe të parkimit. Të ardhurat nga tarifa e pastrimit zënë pjesën më të madhe të të ardhurave nga tarifat me një kontribut prej 61% për vitin 2022. Kontributin më të madh në këto të ardhura pas Tarifës së Pastrimit e japin Tarifat e Parkimit (14).

## 2.5.2 Shpenzimet

Trendi i kryerjes së Shpenzimeve të Buxhetit ndër vite paraqitet si më poshtë, në bazë të klasifikimit ekonomik dhe me të gjitha burimet e financimit në Bashkinë Tiranë:

Tabela 6 - Shpenzimet e BT sipas klasifikimit 2018 – 2022 (në 000)

Shpenzimet sipas klasifikimit	2018	2019	2020	2021	2022
<i>Shpenzime Personeli</i>	4,782,499	5,096,092	5,376,809	6,026,363	6,164,001
<i>Shpenzime të tjera Operative</i>	8,275,541	9,330,864	11,779,539	12,405,906	13,192,178
<i>Shpenzime Kapitale</i>	6,753,919	7,349,201	7,365,317	10,064,981	12,755,057
<b>Totali</b>	<b>19,811,958</b>	<b>21,776,156</b>	<b>24,521,665</b>	<b>28,497,249</b>	<b>32,111,236</b>

Burimi: Bashkia Tiranë, Raporti i Monitorimit të Bashkisë Tiranë 2022, 2019

Në bazë të Raportit të Monitorimit të Bashkisë Tiranë për vitin 2022 shpenzimet klasifikohen edhe sipas 35 programeve si më poshtë:

Tabela 7 - Klasifikimi i Shpenzimeve të BT sipas Programeve

	Shpenzimet sipas programeve	Vlera faktike	% ndaj totalit
1.	Planifikim, menaxhim dhe administrim	2,680,526,791	8.3%
2.	Çështje financiare dhe fiskale	313,624,829	1.0%
3.	Gjendja Civile	53,198,911	0.2%
4.	Shërbimet e Policisë Vendore	577,932,343	1.8%
5.	Mbrojtja nga zjarri dhe civile	860,864,098	2.7%
6.	Mbështetja për Zhvillimin ekonomik	29,611,615	0.1%
7.	Shërbimi i tregjeve dhe akreditimi dhe Inspektimi	62,902,889	0.2%
8.	Shërbimet bujqësore, Inspektimi, Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve	221,977,146	0.7%
9.	Menaxhimi i infr së ujitjes dhe kullimit	65,538,644	0.2%
10.	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	11,377,762	0.0%
11.	Rrjeti rrugor	1,548,889,631	4.8%
12.	Transporti Publik	316,773,641	1.0%
13.	Projekte Zhvillimi	163,695,304	0.5%
14.	Zhvillimi i Turizmit	20,152,950	0.1%
15.	Menaxhimi i Mbetjeve	2,392,484,863	7.5%
16.	Programet e mbrojtjes së mjedisit	3,782,296	0.0%
17.	Planifikimi Urban dhe Vendor	1,078,908,306	3.4%
18.	Strehimi	375,716,000	1.2%
19.	Programet e zhvillimit	6,662,275,942	20.7%
20.	Menaxhimi i mbetjeve urbane	179,722,265	0.6%
21.	Shërbimet Publike Vendore	2,753,121,391	8.6%
22.	Ndricim Rrugësh	304,363,752	0.9%

23.	Sport dhe Argëtim	828,162,085	2.6%
24.	Trashëgimia kulturore	678,488,571	2.1%
25.	Art dhe Kultura	1,147,137,183	3.6%
26.	Arsimi Bazë përfshirë arsimin parashkollor	3,676,340,254	11.4%
27.	Arsimi i mesëm I përgjithshëm	1,565,506,028	4.9%
28.	Arsimi professional	173,622,189	0.5%
29.	Arsimi Universitar		0.0%
30.	Kujdesi Social per personat e sëmurë dhe PAK	17,636,276	0.1%
31.	Kujdesi Social për familjet dhe fëmijët	2,950,868,078	9.2%
32.	Papunësia, Arsim dhe aftësim professional	23,500,000	0.1%
33.	Strehimi Social	313,285,081	1.0%
34.	Emergjencat Civile	59,249,162	0.2%
35.	Fondi Rezervë	-	-
36.	Fondi i Kontigjencës	-	-
	<b>Totali</b>	<b>32,111,236,276</b>	<b>100%</b>

*Burimi: Bashkia Tiranë, Raporti i Monitorimit të Bashkisë Tiranë 2022, 2019*

### 3. Analiza e Gjendjes Aktuale

#### 3.1 Infrastruktura dhe Shërbimet Publike

Rrugët dhe autostradat përbëjnë mënyrën mbizotëruese të transportit tokësor në Shqipëri dhe sigurojnë lidhjet thelbësore për transportin e mallrave dhe lëvizshmërinë personale në vend. Rrugët për këtë arsye janë pasuri të rëndësishme publike në një ekonomi në zhvillim si Shqipëria dhe përmirësimi e mirëmbajtja e tyre mund të sjellë përfitime të rëndësishme për komunitetet, duke siguruar qasje më të mirë në shërbimet sociale, objektet arsimore, tregjet dhe qendrat tregtare.


“Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim European 2030” vë theksin te zhvillimi dhe modernizimi i infrastrukturës së transportit si një nga prioritetet kryesore të Qeverisë Shqiptare që ka synuar: i) krijimin e parakushteve për zhvillimin e sektorëve të tjerë të ekonomisë, sidomos turizmit, ii) rritjen e aksesit të mallrave dhe pasagjerëve në tregtinë dhe ofrimin e shërbimeve, në tregun rajonal dhe europian; si dhe iii) kontributin e ndjeshëm në rritjen dhe zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit.

Transporti rrugor mbetet një prioritet i Qeverisë Shqiptare, e cila ka në fokus të programit afatmesëm të saj ndërtimin e një rrjeti efikas dhe eficient të transportit rrugor të disponueshëm dhe të aksesueshëm nga të gjithë qytetarët; të menaxhuar nga autoritete të besueshme, transparente, me performancën e duhur, dhe që siguron ndjeshëm mobilitetin, rritjen e cilësisë së jetës dhe rritjen ekonomike (*Programi i Qeverisë 2021-2025, fq 23*). Investimet në infrastrukturën e transportit rrugor janë përqendruar për ndërtimin e akseve rrugore të rëndësishme të Rrjetit Kryesor (Core Network), me një vlerë totale investimi prej 883,51 mln Euro (*Raporti i Monitorimit të Strategjisë Kombëtare të Transportit 2020, fq 46*).

##### 3.1.1 Rrugët, Ndriçimi dhe Infrastruktura Publike

Territori i Tiranës shtrihet në një rreze prej 25 km, por shumica e zonave të banuara janë brenda një rrezeje 10 km nga qendra e qytetit. Bashkia fqinje e Kamzës dhe zona e Bathores janë gjithashtu pjesë e "zonës funksionale urbane" të kryeqytetit.

Figura 13 - Njësitë administrative të Bashkisë së Tiranës dhe distancat nga qendra e qytetit



Burimi: Përpunim i mbështetur në <https://www.tirana.al/njesiteadministrative>

Pozicionimi i Tiranës është strategjik për sa i përket lidhjes, pasi ajo ndodhet në kryqëzimin e shtyllës kurrizore infrastrukturore veri/jug (e përbërë nga SH1, SH2 dhe SH4) dhe lidhjes kryesore lindje/perëndim (e përbërë nga SH2, SH3) që lidh Durrësin-Tiranën dhe Elbasanin, duke vazhduar drejt Maqedonisë së Veriut. Në fakt, zona e Tiranës, së bashku me segmentin verior të korridorit adriatiko-jonian, dhe në lidhjen juglindore me Greqinë jo vetëm që mban flukset më të larta të automjeteve të pasagjerëve, por shërben gjithashtu edhe si arterie kryesore për transportin e mallrave përmes Shqipërisë dhe drejt vendeve fqinje.


Qyteti i Tiranës, që në fillesat e tij, është zhvilluar sipas një modeli koncentrik, ku trafiku përqëndrohet në qendër të qytetit. Strukturat hapësinore metropolitane në qytet janë formuar përgjatë korridoreve kryesore, të ndara në rrugë radiale dhe unaza. Korridore radiale janë:

- Korridori i Durrësit;
- Korridori i Kamzës;
- Korridori i Kavajës;
- Korridori i Elbasanit;
- Korridori i ish-Uzinës Traktori;
- Korridori i Dajtit;

- Korridori i Dibrës; dhe
- Korridori i Paskuqanit.

Arterja kryesore e zhvillimit cilësohet Bulevardi Kryesor si boshti historik Veri – Jug, i cili përshkron qendrën e qytetit “Sheshi Skenderbej” si dhe sistemin radial unazor. Hapësirat ndërmjet unazave dhe radialeve përshkrohen nga rrugë dytësore. Rrjeti unazor i qytetit parashikohet të përbëhet nga pesë unaza (PPVBT). Aktualisht vetëm 3 cilësohen funksionale në mënyrë të pjesshme ose të plotë.

Figura 14 - Lidhja kryesore drejt dhe nga Tirana



*Burimi: Studimi për transportin strategjik të Tiranës, 2019*

Rrugët kryesore radiale të rrjetit rrugor të Tiranës shtrihen nga Unaza e Brendshme, në perëndim në Durrës dhe aeroportit përmes Autostradës së Durrësit, në jugperëndim deri në Kavajë/Durrës, në jug deri në Elbasan, në lindje deri në Dajt, mbi mal, dhe në verilindje deri në Peshkopi përmes Rrugës së Arbrit. Përveç këtyre pesë rrugëve kryesore, ka disa rrugë të tjera radiale, shumica e të cilave lidhen deri në kufijtë administrativë të njësisë bashkiake të Tiranës. Në veriperëndim të Tiranës ekziston edhe një rrugë kryesore që devijon nga autostrada e Durrësit dhe shtrihet deri në Kamëz/Fushë-Krujë.

Në anën tjetër, rrjeti rrugor urban përfshin 482 rrugë me një gjatësi të përgjithshme prej 1 101 km dhe është i përbërë nga tri unaza (siç njihen zakonisht):

- Unaza e brendshme, përreth Sheshit Skënderbej dhe zonës së biznesit;
- Unaza e mesme, me një pjesë që mungon në juglindje;
- Unaza e jashtme, nga e cila deri tani është funksionale në rreth 2/3 e gjatësisë së saj.

Bazuar në të dhënat e fundit të BT-së si dhe të PPVBT lidhur me elementët e infrastrukturës së rrjetit rrugor përmendin se janë rreth 132 rrugë urbane dhe 350 lokale me një shtrirje prej 1,100.6 km nga të cilat, 1000 km janë me 1 kors, 54 km janë me 2 kors dhe rreth 47 km janë me mbi 2 kors.

7 km është gjatësia e korsive të rezervuara BUS dhe 29 km korsive të rezervuara për biçikleta. Rrugët kryesore radiale të Tiranës janë zgjeruar si më poshtë:

- nga pjesa perëndimore në drejtim të Durrësit dhe Aeroportit;
- në jugperëndim në drejtim të Kavajës/Durrësit;
- në juglindje në drejtim të Elbasanit; dhe
- në verilindje në drejtim të Dibrës.

Unaza e Parë. Unaza e Vogël me gjatësi totale 2.5 km u përfundua në fund të vitit 2016 pas ndërtimit të segmentit të ri veri-lindor midis Rr. Urani Pano dhe Rr. së Barrikadave me gjatësi 200 m dhe rikonstruksionin e saj duke përfshirë infrastrukturën përkatëse dhe korsinë e biçikletave. Vlen për t'u theksuar plotësimi i infrastrukturës me sinjalistikë për korsitë biçikletash dhe ndalim parkimi në rrugë, në segmentet: Rr. Ibrahim Rugova dhe segmenti i Rr. së Barrikadave nga "Ushtari i pa Njohur" deri te Muzeu i Besimit dhe përgjatë Lumit Lana.

Unaza e Dytë. Aktualisht nuk është funksionale pasi mungojnë një pjesë e madhe e segmenteve që mbyllin këtë unazë. Zhvillim i saj përfshin zgjerimin dhe rindërtimin e disa rrugëve ekzistuese dhe gjithashtu ndërtimin e disa rrugëve të tjera që mungojnë.

Unaza e Tretë. Kategorizohet si rrugë urbane kryesore me 4 korsitë të ndara me breza të gjelbër dhe nga një korsi parkimi respektivisht në të dy sentset e lëvizjes. Aktualisht kjo unazë nuk përmban korsitë biçikletash. Unaza e tretë cilësohet mjaft e rëndësishme pasi mban pjesën më të madhe të trafikut rrugor dhe ka në përbërjen e saj nyje/kryqëzime të rëndësishme të lidhjeve me korridoret kryesore si: kryqëzimi i Zogut të Zi, 21 Dhjetori, kryqëzimi i Rrugës së Dibrës, dhe lidhjen me Lumin Lana si edhe ish Stacionin e Trenit që pritet të kthehet në një kryqëzim të rëndësishëm pasi zona e Bulevardit të Ri të jetë populluar. Përfundimi i Unazës së Tretë konsiston në mbylljen e seksionit jug-lindor, zonë e cila nuk është e pajisur me infrastrukturë të përshtatshme për të shërbyer si unazë. Hendeku që mungon në këtë segment është nga Ambasada e SHBA-së në Rr. Kont Leopold Bertold me gjatësi prej 0.96 km sipas Planit Tematik Urban të Tiranës (JICA). PPVBT parashikon devijimin e unazës në rrugët Stavro Vinjau dhe Qemal Guranjaku pasi nuk mundësohet shpronësimi i ambasadës dhe ndërtimi i rrugës në pronën e saj. Gjatësia në total në përfundim të Unazës pritet të jetë rreth 9.5 km.


Unaza e Katërtë është parashikuar për herë të parë gjatë Planit të Ri Rregullues për Zhvillimin Urban të Tiranës në vitin 1939. PPVBT rikthen ndërtimin e kësaj unaze e cila parashikohet të jetë mbi gjurmën e unazës së madhe të atëhershme dhe vendos si objektiv realizimin e një unaze tërësisht të dedikuar për transportin publik të qëndrueshëm. Me një diametër prej 3,5 km unaza do të kthehet në një kufi fizik brenda të cilës qyteti të mund të përkufizohet si "zonë për këmbësorë" dhe që në 2030 do të kthehet në zonë me trafik të kufizuar ku do të zbatohet taksa e trafikut. Korridori mjedisor do të jetë rreth 12 km i gjatë dhe lëvizshmëria do të variojë nga 20-50 metra gjerësi e cila do të vendosë në një sistem të vetëm hapësirat ekzistuese si dhe ato të parashikuara. Aktualisht nuk ka një studim të plotë për ndërhyrjet në këtë unazë por është parashikuar që zhvillimi i kësaj unaze të jetë pjesë e planeve sektoriale të ardhshëm.

Unaza e Pestë bën pjesë në rrjetin kombëtar të rrugëve dhe është një investim i ARRSH-së. Kjo unazë parashikohet të ketë një gjatësi totale rreth 21.5 km. Aktualisht ka përfunduar pjesa perëndimore, jugore, jugperëndimore dhe juglindore që ka rëndësi specifike për lidhjen me Elbasanin. Përfundimi i

kësaj unaze ka rëndësi të veçantë strategjike për rrjetin rrugor në Tiranë dhe për përmirësimin e trafikut pasi i shërben kryesisht trafikut tranzit. Gjithashtu, do të shërbejë si një korridor i rëndësishëm për transportin e mallrave. Rëndësia e Unazës së Pestë do të jetë veçanërisht e dukshme në zonat veriore dhe lindore të qytetit, ku përfundimi i segmenteve përkatëse unazore do të ndihmojë gjerësisht në integrimin ekonomik të këtyre zonave në rajonin qendror. Gjithashtu realizimi i segmentit verior merr një rëndësi të veçantë sepse do të shërbejë si një portë hyrëse (lidhja me Rrugën e Arbërit).

Korridori i Lumi Lana përbëhet në pjesën veriore nga Bulevardit Gjergj Fishta dhe Zhan D'Ark dhe në pjesën jugore nga Bulevardi Bajram Curri. Ky korridor përshkohet në të dy anët e tij nga rrugë urbane dytësore me dy korsi për automjetet, nga një korsi parkimi në të dy kahët e drejtimit dhe është i ndarë nga shtrati i lumit i cili është i sistemuar. Kjo arterie ka mjaft rëndësi pasi kryen lidhjen lindje-perëndim të rrjetit rrugor dhe iu shërben tre unazave të para duke mbajtur një pjesë mjaft të rëndësishme të trafikut.


Figura 15 - Rrjeti rrugor urban



*Burimi: Bashkia Tiranë, Drejtoria e planifikimit Strategjik dhe Jetësimit të Prioriteteve*

Në vitin 2015 pas reformës territoriale, BT-së i kaloi administrimi dhe mirëmbajtja e rrjetit rrugor të 13 NJA-ve Rurale.

Figura 16 - Harta e Periferialitetit



Burimi: Bashkia Tiranë, TR030

Flukset më të larta të trafikut të pasagjerëve regjistrohen në Tiranë. Nga matjet e kryera në 12 rrugë kryesore të Tiranës rezultojnë se Rr. “Dritan Hoxha” ka fluksin më të lartë të automjeteve, me rreth 33,490 mjete në 24 orë, me drejtim hyrje në qytet. Fluksin më të ulët e ka Rr. “Xhanfize Keko” me rreth 9,620 mjete në 24 orë me drejtim dalje nga qyteti.

Siguria rrugore dhe elementët që e përbejnë atë përfshijnë një kompleks problemesh të karakterit legjislativ, institucional dhe zbatues, niveli i arritjes së të cilave është në shërbim të përmirësimit të gjendjes aktuale. Në vitin 2022 në rang kombëtar, numërohen 1.165 aksidente rrugore nga 1.376 aksidente, të ndodhura në vitin 2021. Numri i aksidenteve rrugore është ulur me 15,3%. Shkaktarët kryesorë të aksidenteve listohen: mungesa e zgjerimit të rrjetit rrugor të asfaltuar, mungesa e kontrolleve periodike të automjeteve, veçanërisht e automjeteve tregtare si dhe numri i madh i drejtuesve të rinj të pakujdesshëm, që nuk zbatojnë rregullat e qarkullimit dhe pa përvojë. Aksidentet më të shumta kanë ndodhur në rrethet Tiranë dhe Durrës. Qyteti i Tiranës numëron 541 aksidente për vitin 2022 nga 627 që ishin në vitin 2021. Numri i aksidenteve automobilistike pavarësisht nga ulja është në një nivel shqetësues.






Figura 17 - Aksidente, të plagosur dhe të vvarë në Bashkinë e Tiranës nga aksidentet rrugore

Në përgjithësi, makinat mbizotërojnë në lidhje me përdorimin dhe shpërndarjen e hapësirës rrugore, me seksione të kufizuara për trotuare dhe prani të përhapur të parkimit në rrugë, duke detyruar shpesh njerëzit që të ecin përgjatë hapësirave të mbetura.

Përgjatë viteve të fundit, Bashkia e Tiranës ka prioritetizuar modernizimin e infrastrukturës urbane dhe rurale të qytetit, duke planifikuar dhe zbatuar investime të rëndësishme në rikonstruksionin e rrugëve dhe rehabilitimin e blloqeve të banimit. Në këtë mënyrë, nga viti 2015 deri në vitin 2022 janë rikonstruktuar në total 32 rrugë. Tabela e mëposhtme përmbledh një listë të rrugëve të rikonstruktuar si edhe vitin në të cilin kanë përfunduar punimet.

Tabela 8 - Rrugë të rikonstruktuar

Emërtimi i Projektit	Viti i përfundimit të punimeve
Rikonstruksioni i rrugës "Ali Shefqeti"	2016
Rikonstruksioni i Trotuarëve dhe Rrugës "Ali Demi"	2016
Rikonstruksion i rrugës "Kujtim Laro"	2016
Riveshje asfaltim disa rrugëve ne Nj Bashkiake nr. 4	2016
Rikonstruksioni i rrugës "Piro Goda"	2016
Rikonstruksion i rrugës Hamdi Cenoimeri" (Faza e III)	2016
"Rikonstruksion i rrugës "Isuf Balta".	2016
Rikonstruksioni i rrugëve "Shyqyri Berxolli" dhe "Reshit Çollaku"	2016
Rikonstruksioni i rrugës "Besnik Hidri"	2016
Rikonstruksioni i rrugës "Herman Gmeiner"	2017
Rikonstruksion i rrugës "Dalip Topi" (Pyjorja)	2017
Asfaltimi i rrugës "Shefqet Kuka"	2017
Ndërtimi dhe Rikonstruksioni i rrugës Selaudin Bekteshi	2017
Rikonstruksioni i rrugës "Imer Ndrejoni"	2017
Ndërtimi, Rikonstruksioni dhe Rinovimi i Unazës së Vogël Tiranë	2017
Rikonstruksioni i rrugës "Josif Pashko - Uzina Dinamo"	2017
Rikonstruksion i rrugës "Mihal Grameno" dhe degëzimit të rrugës "Budi" - Depo ujit (faza e dytë)	2018

Rikonstruksioni i rrugës "Fatmir Haxhiu"	2018
Rikonstruksioni i rrugës së Dibrës (Farmacia 10 - Oxhaku)	2018
Rikonstruksion "rruga e Zallit", Selitë.	2018
Rikonstruksion i rrugëve "Kël Kodheli" dhe "Skënder Shtylla"	2018
Rehabilitimi i Unazës së Mesme	2019
Rikonstruksioni i rrugës "Fatmir Haxhiu"	2019
Rikonstruksioni i rrugës "Kadri Kerçiku"	2019
Rikonstruksion "rruga tek Liqeni pranë Ambasadës Hollandeze"	2019
Rikonstruksion i Trotuareve dhe rrugës "Hoxha Tasim" dhe "Xhanfize Keko"	2019
Rikonstruksion i rrugës "Dhimitër Shuteriqi"	2019
Rehabilitimi i Aksit Mbikalimi - Kombin	2019
Rikonstruksioni i rrugës "Sotir Peçi"	2019
Rikonstruksioni i rrugës Hamdi Cullaj	2020
Rikonstruksioni i rrugëve "Sabaudin Gabrani" dhe "Leka i Madh"	2021
Ndërhyrje rehabilituese në rrugët "Kont Urani" dhe "Mihal Duri"	2022

Duke prioritetuar edhe infrastrukturën e brendshme të lagjeve, përgjatë të njëjtës periudhë janë rehabilituar në total 26 blloqe banimi, me investime që përfshijnë rrugët, trotuaret, ndriçimin publik si edhe krijimin e hapësirave rekreative apo të parkimit për rezidentët. Një listë e blloqeve të banimit të rehabilituara përmbledhet në tabelën e mëposhtme.

Tabela 9 - Blloqe banimi të rehabilituara

Emërtimi i Projektit	Viti i përfundimit të punimeve
Rikualifikimi urban i dy blloqeve dhe rehabilitimi i rruges Dhimiter Kamarda nj.b.1	2017
Rikualifikimi urban i bllokut 40, 41 dhe 42 (faza I) nj.b.2	2017
Rikonstruksion i Infrastrukturës Rrugore të bllokut të kufizuar nga rruga "Mentor Xhemali", rruga "Hjadar Tafa", rruga "Qemal Butka" dhe rruga "Frang Bardhi"	2017
Rikualifikimi urban i bllokut që kufizohet nga rrugët Sulejman Delvina, Medar Shtylla, Skënder Luarasi, Grigor Heba, Gjik Kuqali nj.b.5	2017
Rikualifikimi urban, blloku kufizuar nga rruga Muhamet Gjollësja-Myslym Shyri - rruga e Kavajës me kufirin e njësisë Bashkiake Nr.10	2017
Rikualifikim urban Blloku në rrugën "Vëllezërit Manastirli"	2017
"Rikonstruksioni i Infrastrukturës rrugore të bllokut të kufizuar nga rruga "Njazi Meka" – "Grigor Perlecev" – "Niko Avrami" – "Spiro Cipi" – "Fitnete Rexha" - "Myslym Keta" – "Skënder Vila" – Lumi i Tiranës".	2018
Rikualifikimi urban i rrugëve në bllokun e pallateve "Selitë" nga rr. "Hamdi Pepa" - rr. "Ilia Dilo Sheperi" - rr. "Visarion Xhuvani" - rr. "Leka i Madh"	2018
Rikualifikimi Urban i Bllokut të kufizuar nga Rr. "Llambi Bonata" – "Haki Stërmilli" – "Musine Kokalari" dhe Rikonstruksioni i Rrugës "Zyber Zeneli", vazhdim i rrugës "Ali Kelmendi"	2018
Rikualifikim Urban i Bllokut të Dogana, njësia bashkiake nr.7	2018
"Rikonstruksioni i infrastrukturës rrugore të bllokut që kufizohet nga rruga "Qemal Stafa" – "Rruga e Dibrës" dhe "Rruga Bardhyl".	2018
Rikonstruksioni i Rrugës që lidh Rrugën "Reshit Petrela" me Rrugën "Skënder Kosturi" paralel me Rrugën "Jordan Misja"	2018


Rehabilitimi i Rrugëve të bllokut që kufizohet nga rrugët "Leandro Zoto" - "Maria Kraja" - "Disha" - "Sadik Petrela"	2019
Rikualifikim urban i bllokut që kufizohet nga "Blv. Bajra Curri"- "Blv Petro N. Luarasi" - Rruga "Taulantia" - Rruga "Ali Demi" – Faza 1	2019
Rikualifikimi Urban i Bllokut që kufizohet nga Rruga Elbasanit – Stavri Vinjau – Pjetër Budi – Ali Visha	2019
Rikonstruksioni i infrastrukturës së bllokut që kufizohet nga rruga "Endri Keko", "Sadik Petrela" dhe Lana	2019
Rikonstruksioni i Infrastrukturës Rrugore të bllokut Kufizuar nga Rrugët "Konferenca e Pezës" "3 Dëshmorët" dhe Rruga "Ali Jegeni"	2019
"Rikonstruksion i infrastrukturës rrugore të bllokut që kufizohet nga rruga "Besa" – "Siri Kodra" – "Zenel Bastari" – "Haki Rexhep Kodra" (përfshin dhe rrugën tek Nish Kimike).	2019
Rikualifikimi Urban i Bllokut Kufizuar Nga Rruga "Ded Gjon Luli" – Blv "Zogu Parë" – "Mine Peza" dhe Rikonstruksioni I Rrugës "Prokop Myzeqari" Dhe Rrugës "Hamid Shijaku	2019
Rikualifikimi urban i bllokut nr.1 (Lapraka) kufizuar nga rrugët "Don Bosko"-Shinat e Trenit (Filanto) - rr. "Turhan Pashë Përmeti" - "Ibrahim Pashë Bushatlliu" - "Lord Bajron" - "Riza Cuka" - "Learton Vathi" - "Pandi Dardha" - "Dritan Hoxha"	2019
Rikonstruksioni i Infrastrukturës Rrugore të bllokut që kufizohet nga Rrugër "Demir Nazeri" - "Princ Vidi" - "Gjokë Doci"	2020
Rikualifikim urban blloku që kufizohet nga rrugët Kastriotet – Gramozi – E Balshajve - Ramadan Citaku	2020
Rehabilitimi i Rrugeve të bllokut që kufizohet nga rrugët "Leandro Zoto" - "Maria Kraja" - "Disha" - "Sadik Petrela"	2021
«Rehabilitimi i rrugëve të bllokut që kufizohet nga rrugët "Fabrika e Qelqit", "Konferenca e Pezës", "Besim Alla", dhe "Jorgo Panajoti"- Faza I»	2021
Rikualifikim urban i bllokut që kufizohet nga BLV. Bajra Curri- Blv Petro N. Luarasi - Rruga Taulantia - Rruga Ali Demi – Faza 1	2022
Rikualifikim urban i bllokut që kufizohet nga BLV. Bajra Curri- Blv Petro N. Luarasi - Rruga Taulantia - Rruga Ali Demi – Faza 2	2022
Rikualifikimi Urban i Bllokut që kufizohet nga rruga Sami Frashëri - Abdyl Frashëri - Dëshmorët e 4 Shkurtit dhe Dora D'Istria	2022

### *Menaxhimi Rrugor: Semaforët dhe sinjalistika*

Në vitin 2013, Tirana inauguroi Qendrën e Kontrollit të Trafikut Urban të Tiranës (QKTUT), një njësi trafiku e dedikuar për të menaxhuar dhe monitoruar trafikun brenda qytetit. QKTUT-ja është e ndërlidhur në kohë reale me çdo semafor. Sa i përket sistemeve të tjera të ngjashme, në VMS shfaqen mesazhet në lidhje me sigurinë rrugore, si dhe informacionet aktuale të trafikut në rrugët më të rëndësishme. *(Burimi: Plani i Levizshmërisë së Qëndrueshme Urbane për Bashkinë e Tiranës, fq. 34)*

Semaforët menaxhohen automatikisht bazuar në një kalendar të planifikuar të bazuar në të dhëna. Përveç kësaj, operatorët mund të veprojnë manualisht për t'i dhënë përparësi situatës në kohë reale në rrugët më të ngjeshura, sipas të dhënave të mbledhura përmes kamerave të trafikut dhe sensorëve. QKTUT-ja zbaton gjithashtu një skemë të quajtur "vala e gjelbër" për të lejuar rrjedhën e vazhdueshme të trafikut në disa kryqëzime të koordinuara dhe përgjatë 14 korridoreve rrugore.

Figura 1 - Korridoret e valëve të gjelbra



*Burimi: Qendra e Kontrollit të Trafikut Urban Tiranë*

Infrastruktura rrugore në Bashkinë e Tiranës, duke përfshirë aspekte të tilla si ndriçimi, instalimi i kabllave, shtyllat dhe tabelat, luan një rol jetik në sigurimin e një rrjeti transporti të sigurt dhe efikas për banorët dhe vizitorët. Ndërkohë që janë bërë përpjekje të konsiderueshme për adresimin e këtyre elementeve, monitorimi, mirëmbajtja dhe përmirësimet e vazhdueshme janë të nevojshme për të siguruar që infrastruktura rrugore të mbetet e besueshme, e aksesueshme dhe në përputhje me nevojat në zhvillim të komunitetit. Duke i dhënë përparësi përmirësimit dhe mirëmbajtjes së këtyre aspekteve, bashkia e Tiranës mund të rrisë sigurinë rrugore, të lehtësojë qarkullimin më të lehtë të trafikut dhe të kontribuojë në një përmirësim të përgjithshëm të cilësisë së jetës për banorët e saj.

### 3.1.2 Ujësjetllësi dhe Kanalizimet

Shoqëria Ujësjetllës-Kanalizime e Tiranës (UKT) u krijua në 1939 pas përfundimit të ndërtimit të sistemit të parë të ujësjetllësit. Uji merrej nga Lumi i Tiranës, kalonte përmes një impianti të trajtimit të ujit dhe furnizonte qendrën e re të asaj kohe, që përbëhej kryesisht nga ndërtesa qeveritare. Detyrat e UKT-së ishte të administronte impiantin e trajtimit dhe të furnizonte rrjetin e shpërndarjes së asaj kohe. Gjatë viteve që pasuan, popullsia e Tiranës u rrit në mënyrë të qëndrueshme dhe po kështu u rrit edhe kërkesa për burime të reja të ujit, duke përfshirë Selitën në vitin 1951, Shën Mërinë në vitin 1964 dhe Bovillën në vitin 1974. Në vitin 1989 u vendos të ndërtohej diga e Bovillës për të krijuar një liqen me ujë për të furnizuar impiantin e sapondërtuar të trajtimit të ujit me kapacitet depozitimi dhe furnizimi prej 100 milion m<sup>3</sup>.

Menaxhimi i kërkesës për ujë nga UK Tiranë ka qenë gjithmonë një çështje prioritare, duke qenë se sistemi i ujësjetllësit është më i madhi në vend dhe ka kompleksitetin më të madh teknik të çdo sistemi që përfshin të gjithë komponentët që mund të gjenden në një sistem ujësjetllës-kanalizime.

Sh.a.UK Tiranë shfrytëzon burime ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore. Nëpërmjet këtyre burimeve, shoqëria prodhon mesatarisht 93,3 milion m<sup>3</sup> ujë në vit nëpërmjet 22 sistemeve me ngritje mekanike dhe 14 sistemeve me rrjedhje të lirë. Volumi i ujit të prodhuar pjesërisht matet dhe pjesërisht vlerësohet. Sh.a.UK Tiranë administron një rrjet ujësjetllësi prej 1,909 km nga i cili 196 km rrjet kryesor dhe 1,713 km rrjet shpërndarës. Shoqëria zbaton një program të rregullt pune për dedektimin e humbjeve të ujit si dhe ka një sistem të formalizuar për regjistrimin e ankesave të konsumatorëve.

Figura 18 - Zona e shërbimit të UKT



Burimi: Bashkia Tiranë, UKT

Zona aktuale e shërbimit e UKT-së furnizohet nga tre lloje burime të ndryshme uji; burime natyrore që zakonisht vijnë nga malet, puse dhe stacione pompimi, ujëra sipërfaqësorë dhe impiante të trajtimit të ujit të pijshëm.

Në tabelën e mëposhtme jepet një paraqitje statistikore e emrave, llojeve dhe kapaciteteve të të gjitha burimeve ujore.

Tabela 10 - Karakteristikat e burimeve të ujit

Lloji	Emri	Sasia maks. (1/sek)	Sasia min. (1/sek)	Niveli (m. Mbi niv. Det)
	Selita	1000	230	1150
Burime	Shën Mëria	640	450	750
	Bovillë e Vjetër	420	140	282
	Pishinat	120	80	96
	Laknas	160	80	56
	Bërxull	200	150	48
Pus	Pema	40	35	91
	Buka	50	40	90
	Coca-Cola	25	20	71
	Çokollata	60	40	95
Impiani i trajtimit të ujit të pijshëm	Impianti i trajtimit të ujit të pijshëm Bovillë	1800	1800	206

*Burimi: Bashkia Tiranë, UKT*

UK Tiranë ka një varietet të gjerë tubacionesh të transmetimit me gjatësi dhe materiale të ndryshme. Këto tubacione transmetimi shërbejnë për të cuar ujin nga burimet, të cilat sic u përmendën më sipër, mund të jenë burime uji, puse, diga apo impiante të trajtimit të ujit tek rezervuarët e ujit që ndodhen kryesisht në pikat hyrëse të pjesës urbane të Bashkisë Tiranë. Gjithashtu gjenden tubacione transmetimi që përdoren për të shpërndarë ujin nga një rezervuar tek tjetri.

Rrjeti i furnizimit me ujë i UKT-së, që fillon nga rezervuarët e ndryshëm dhe përfundon me lidhjen tek konsumatorët, përbëhet nga dy lloje: rrjeti i hapur dhe rrjeti unazor. Në shumicën dërrmuese në Tiranë, sistemi është rrjet i hapur dhe vetëm në disa zona të vogla mund të gjendet një rrjet unazor. Rrjeti i përgjithshëm i shpërndarjes së ujit është i përbërë nga 1.8 milion metra tubacione. Ky rrjet ka tuba që datojnë që nga viti 1940 si dhe tuba të rinj të instaluar përgjatë viteve të fundit.

#### *Ujërat e ndotura*

Rrjeti i kanalizimeve në qytetin e Tiranës ka një gjatësi prej 602 km dhe është i sistemit Miks në 90% të tij. Ky rrjet punon me vetërrjedhje deri në pikat përfundimtare të shkarkimit. Për qytetin e Tiranës me rreth 1 000 000 banorë, dy janë pikat përfundimtare të shkarkimit, Përroi i Lanës dhe Lumi i Tiranës. Në këto zona, përrenjtë janë të mbyllur me tubacione betoni 2\*1000mm, 2\*1500mm ose 2\*2000 mm. Aktualisht shkarkimet e ujërave të ndotura në Përrenj ose Lumë bëhen drejtpërdrejt, pa bërë trajtimin e tyre. Rrjeti i kanalizimeve përbëhet nga tubacione me diametër nga 200 mm deri në 2000 mm. Materiali i tubacioneve është beton, beton armë dhe PE i brinjëzuar.

Shkarkimi i ujërave mix në përroin e Lanës ose në Lumin e Tiranës, në pjesë të ndryshme të gjatësisë së tij bëhet nëpërmjet kolektorëve pritës të qytetit ose nëpërmjet përrenjëve, të cilët kalojnë në zona të banuara të qytetit. Në përbërjen e tij rrjeti i kanalizimeve ka edhe pusetat e kontrollit si element bazë për kontrollin dhe mirëmbajtjen e tij. Një pjesë e mirë e kolektorëve kryesorë të qytetit janë ndërtuar sipas studimit dhe projekt-zbatimit të hartuar në vitin 1962, për një periudhë 20 vjeçare dhe për një numër popullsie prej 200-250 mijë banorë.

Aktualisht është duke u ndërtuar një Impiant për Trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane të cilat mbledhen në Lumin e Lanës, pasi deri më tani shkarkimet janë bërë drejtëpërdrejt pa bërë trajtimin e tyre. Vendndodhja e këtij Impianti ndodhet në Kashar, në jugperëndim të qytetit të Tiranës, nga i cili do të përfitojnë 350 000 banorë. Ky Impiant do të bëjë të mundur Trajtimin e Ujërave me metodën e Filtrit me Pikim (Trickling Filter) sipas standarteve të kërkuara.

#### *Impianti i Trajtimin të Ujit*

Impianti i Trajtimin të Ujit (ITU) të Bovillës ka një kapacitet prodhimi deri në 1,800 l/sek ujë të pijshëm për të furnizuar BT-në. Uji rrjedh me gravitet nga diga e Bovillës, në lartësinë 275 m mbi nivelin e detit, përmes një tubi çeliku me diametër 900 mm dhe gjatësi 10 km, drejt impiantit të trajtimit të ujit që ndodhet në Babrru, në lartësinë 217 m mbi nivelin e detit. Cilësia e ujit që shkon në ITU konsiderohet e kategorisë A1 sipas standardeve të BE-së, kështu që proceset që duhen për të shndërruar këtë ujë në të pijshëm janë koagulimi-flokulimi, filtrimi dhe dezinfektimi. Dezinfektimi arrihet duke futur kimikate të tilla si acidi klorhidrik, hipokloriti i natriumit, polikloridi i aluminit, etj, në doza të përcaktuara në momentin kur uji hyn në fazën e parë të procesit të trajtimit. Pas fazës përfundimtare të trajtimit, që është filtrimi, uji kalon në rezervuarin e ITU-së, me kapacitet 30,000 m<sup>3</sup>. Nga aty, uji shpërndahet me dy tubacione kryesore transmetimi, një që sjell ujë direkt në sistemin e furnizimit të Tiranës dhe tjetri në rezervuarin e Kinostudios.

#### *Të dhëna të përgjithshme për UKT 2022*

**Kostot e riparimeve:** UK Tiranë 8.98 milion lekë / Rritja e këtyre kostove vjen si rezultat i rritjes së numrit të defekteve në rrjetin shpërndarës, por dhe për shkak të rritjes së çmimeve të materialeve dhe shërbimeve të cilat gjatë këtij viti kanë kapërcyer në nivele të larta. Kjo thekson rëndësinë e monitorimit efektiv të defekteve dhe menaxhimit të riparimit, si dhe nevojën për masa të kontrollit të koston dhe eksplorimin e opsioneve alternative të burimit për materialet dhe shërbimet.

**Kostoja e Shërbimeve të Nënkontraktuara:** Ndryshe nga kategoritë e tjera të kostove, kostoja e shërbimeve të nënkontraktuara shënoi një ulje prej 8.4 milionë lekësh (-1%) në vitin 2022 krahasuar me një vit më parë. Kjo ulje u nxit kryesisht nga UK Tirana, e cila luajti një rol të rëndësishëm në uljen prej 53 milion lekë ose rreth 46% të kostove totale të shërbimeve të nënkontraktuara të sektorit.

**Kostoja e materialeve kimike:** Kostoja e materialeve kimike për UK u rrit me 4% në vitin 2022 krahasuar me vitin 2021, duke arritur në 11.17 milionë lekë. UK Tirana ishte nxitësi kryesor i kësaj rritjeje me 1.9 milionë lekë, duke zënë rreth 71% të kostove totale të materialeve kimike të sektorit. Identifikimi i kimikateve specifike që përjetuan rritje të çmimeve dhe vlerësimi i modeleve të përdorimit të tyre mund të ndihmojë në hartimin e strategjive të synuara të kontrollit të koston.

**Kostot Kapitale.** Kostot Kapitale përfshijnë kostot e Amortizimit dhe të Kredive. Këto kosto zënë një peshë të konsiderueshme me rreth 26% të totalit të kostove të sektorit. Kostot e amortizimit për vitin 2022 rezultojnë 149.1 milion lekë më të larta se viti 2021, e cila kryesisht ka ardhur nga investimet e kryera dhe të pasqyruara në aktivet e bilanceve të shoqërive UK, ku ndikim ka pasur UK Tiranë me 44.7 milion lekë.

**Numri i Lidhjeve për UK Tiranë:** Me një total prej 265,159 lidhjesh uji në vitin 2022, UK Tirana demonstroi një bazë të konsiderueshme konsumatore.

**Ecuria e mbulimit të kostos për Tiranën:** Progresi në mbulimin e kostos për Tiranën pa një përmirësim të dukshëm, duke u rritur nga 49.7% në 2021 në 116% në 2022. Megjithatë, ndryshimi negativ prej -5.1% midis dy viteve sugjeron disa sfida në ruajtjen e këtij niveli të mbulimit të kostos. Analizimi i faktorëve pas kësaj luhatjeje mund të ndihmojë në sigurimin e qëndrueshmërisë financiare për sektorin.

**Ecuria e normës aktuale të arkëtimit:** Progresi në normën aktuale të arkëtimit është i lavdërueshëm, duke u rritur nga 79.71% në 2021 në 92.64% në 2022, duke treguar një rritje të efikasitetit në mbledhjen e të ardhurave. Ky trend pozitiv tregon përmirësimin e praktikave të faturimit dhe arkëtimit, të cilat kontribuojnë në stabilitetin financiar të sektorit të UK.

**Ecuria e nivelit të matjes për Tiranën:** Rritja marginale e nivelit të matjes, nga 89.50% në 2021 në 90.30% në 2022, nxjerr në pah një angazhim për mbledhjen dhe monitorimin e saktë të të dhënave. Ruajtja e niveleve të larta të matjes siguron menaxhimin efektiv të burimeve ujore dhe planifikimin e infrastrukturës.

**Mbulimi me kanalizimeve:** Mbulimi me kanalizimeve në Tiranë shfaq rritje, duke u rritur nga 90.70% në 2021 në 92.60% në 2022. Kjo tregon përpjekjet e vazhdueshme për zgjerimin e rrjetit të kanalizimeve, përmirësimin e kushteve sanitare dhe mjedisore brenda bashkisë.

**Ecuria financiare e UK Tiranë në vitin 2022:** Ecuria financiare e UK Tirana në vitin 2022 tregon të ardhura të larta nga aktiviteti, në vlerën 4,060,248,000 lekë. Ndërsa kostot e operimit dhe mirëmbajtjes ishin të konsiderueshme në 2,608,025,000 lekë, kostoja totale ishte 3,489,790,000 lekë, duke rezultuar në një fitim prej 570,458,000 lekë. Vlerësimi i faktorëve që kontribuojnë si në gjenerimin e të ardhurave ashtu edhe në kostot e mirëmbajtjes mund të ofrojnë njohuri për optimizimin e rezultateve financiare.

**Mbulimi i Furnizimit me Ujë:** UK Tirana arriti një shkallë mbresëlënëse të mbulimit të furnizimit me ujë prej 99.7% në 2022.

**Lidhjet totale të kanalizimeve për UK Tiranë në 2022:** Numri i përgjithshëm i lidhjeve të ujërave të zeza arriti në 251,080 në 2022. Kjo tregon një rrjet të kanalizimeve në zgjerim dhe akses të përmirësuar për banorët.

**Vëllimi dhe faturimi i ujit për UK Tiranë në 2022:** Të dhënat tregojnë se vëllimi total i ujit të prodhuar nga të dy sistemet në UK Tiranë ishte 97,740,000 m<sup>3</sup>. Vëllimi total i ujit të faturuar ishte 39,301,000 m<sup>3</sup>, duke rezultuar në një shumë totale të faturuar prej 4,060,248,000 lekë. Të kuptuarit e arsyeve pas ndryshimit midis vëllimit të ujit të prodhuar dhe atij të faturuar mund të ndihmojë në identifikimin e zonave për përmirësim në matjen e ujit, saktësinë e faturimit dhe strategjitë e reduktimit të humbjeve.

Përgjatë viteve të fundit, UKT sha ka nisur implementimin e një sërë projekteve madhore që do të çojnë në realizimin e objektivit madhor që është furnizimi me ujë pa ndërprerje. Në vitin 2018, shoqëria ka miratuar Masterplanin Afatmesëm të Zhvillimit Teknik dhe Strategjik të Ujësjellësit dhe Kanalizimeve të Tiranës, i cili parashtron objektivat themelore strategjike të cilat kanë orientuar investimet e UKT sha përgjatë këtyre viteve. Në këtë kuadër, bazuar në parashikimet e Masterplanit, UKT sha ka implementuar ose është në proces implementimi, një sërë projektesh të një rëndësie strategjike, më kryesoret prej të cilave janë si më poshtë:



**Dyfishimi i kapacitetit prodhues të impiantit të Bovillës dhe linja e re e transmetimit**, një investim i rëndësishëm prej rreth 15 milionë Euro i cili ka mundësuar rritjen e ndjeshme të kohës së furnizimit me ujë, zgjerimin e hartës së mbulimit të impiantit të Bovillës dhe reduktimin e humbjeve në rrjet.

**Studimi i Fizibilitetit për Unazën e Presionit**, një ndër projektet më madhore që parashikon ndërtimin e një unaze të presionit të lartë e cila do të bëjë të mundur sigurimin e presionit të nevojshëm në furnizim, eliminimin e pompave elektrike tërheqëse, eliminimin e depozitave në tarracat e pallateve apo shtëpive, zgjerimin e hartës së shërbimit me abonentë të rinj dhe, mbi të gjitha, kontrollin dhe menaxhimin e përdorimit të ujit përmes zbatimit të sistemit të menaxhimit automatik SCADA.

Ndërkohë që projekti i unazës së presionit është në implementim, UKT sha ka nisur punën për ngritjen e sistemit **SCADA**, një teknologji e rëndësishme që mundëson monitorimin dhe kontrollin në distancë të të gjithë rrjetit, ose pjesëve të tij, dhe përpunon informacionin për të gjeneruar alarme, raporte, grafikë ose rezultate të tjera thelbësore për funksionimin dhe mirëmbajtjen në tërësi të procesit. Optimizimi i shpërndarjes së ujit përmes kësaj teknologjie do të rrisë kohën e furnizimi me ujë dhe do të reduktojë humbjet në rrjet.

Për të bërë të mundur implementimin e plotë si të unazës së presionit ashtu edhe të sistemit SCADA, sipas edhe propozimeve të Masterplanit, UKT sha duhet të investojë edhe në krijimin e zonave të reja të konsumit/furnizimit, të cilat janë zona të mbyllura me një pikë të vetme furnizimi të pajisur me matës të presionit e me staraçineskë, çka bën të mundur kontrollin e përhershëm të rrjedhës së ujit në secilën zonë duke optimizuar kështu shpërndarjen.

### 3.1.3 Transporti Publik

Që prej vitit 2013 shërbimi i transportit publik urban kryhet vetëm nga operatorë privat. Janë 11 operatorë privatë të cilët realizojnë shërbimin e transportit urban në 16 linja të ndryshme të autobusëve të cilat kalojnë nga periferia në qendrën e qytetit si edhe disa linja të tjera rrethqytetëse për ish-komunat e Tiranës si Linzë, Mjull-Bathore, Bërzhitë, Shëngjergj etj.

- Operatorët zotërojnë gjithsej një flotë prej 311 mjeteve nga të cilët 271 janë me platformë për persona me aftësi të kufizuar dhe 62 të pajisur me kamera sigurie.
- Mosha mesatare e mjeteve është 9 vjet.
- Numri i linjave që mbulojnë gjithë territorin është 15.
- Frekuenca mesatare e ardhjes në stacion është 9 minuta (orari i pikut është 16:00 dhe orari normal është ora 18:00).
- Në territorin e BT ka 434 stacione të transportit publik.
- Numri i pasagjerëve që përdorin këtë transport mesatarisht është 18.5 milion në vit ndër ta mesatarisht 9.4 milion janë me sistemin abone, 8.9 milion janë me bileta dhe 120.000 të tjera me libreza.
- Transporti publik për vitin 2021 ka një vëllim mesatar ditor prej 204.025 pasagjerësh. Në lidhje me infrastrukturën e transportit publik ka një mungesë të përgjithshme të korsive operative të autobuzëve dhe mungesa e një rrjeti të plotë levizje, që çon shpesh herë në një bllokim të

mjeteve të transportit publik gjatë kongestionit të trafikut duke sjellë shtimin e kohës së udhëtimit po ashtu edhe kostot.

- Biletat kushtojnë 40 lekë dhe orari i transportit publik është 06:00 – 23:00 çdo ditë (pavarësisht festave ose ditës së javës).
- Linja më e shpeshtë është Linja 15 Kombinat Kinostudio dhe linjat më pak frekvente janë ato që shkojnë në njësitë administrative rurale.
- Transporti publik urban përdoret mesatarisht nga rreth 200,000 persona në ditë ku pjesa më e madhe, rreth 64.7%, udhëton me biletë dhe një pjesë më e vogël përdorin abonetë, librezat etj.

Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit, (<http://mbrojtjakesumatorit.al>) është institucioni përgjegjës që kontrollon shërbimet e ofruara nga operatorët e transportit publik në zbatim të kontratës dhe të akteve të Këshillit Bashkiak. Konkretisht, në fushën e transportit AMK.

- Planifikon dhe organizon kontrollin e shërbimit urban qytetas, rrethqytetas dhe ndërqytetas;
- Monitoron, kontrollon dhe merr masa në lidhje me respektimin e detyrimeve kontraktuale në lidhje me ofrimin e shërbimit të transportit publik nga ana e operatorëve që veprojnë;
- Monitoron dhe kontrollon subjektet që ofrojnë shërbimin taksis;
- Monitoron dhe kontrollon shërbimin e ofruar ndaj qytetarëve nga agjencia.
- Janë 482 rrugë gjithsej me një gjatësi totale prej 1,101 km. 7 km është gjatësia e korsive të rezervuara BUS dhe 29 km korsive të rezervuara për biçikleta. Kapaciteti i këtyre rrugëve është 850 mjete në orë.

Organizimi aktual ka zëvendësuar plotësisht sistemin e mëparshëm të brendshëm të shërbimit, të ofruar nga kompania shtetërore e transportit publik dhe gjithashtu edhe furgonat e shumtë privatë, të cilët filluan të ofrojnë transport urban informal si pasojë e nivelit të ulët të shërbimit të linjave zyrtare të transportit publik dhe për të lidhur zonat e pambuluara me shërbim. Sot prania e furgonëve privatë informalë nuk lejohet në rrugët urbane.

#### *RRJETI I TRANSPORTIT PUBLIK URBAN*

Shërbimi i transportit publik urban përbëhet nga 16 linja autobusi, përkatësisht nga:

- 8 linja radiale (lagjet e qendër-periferisë);
- 5 linja diagonale (të cilat lidhin dy periferi të kundërta dhe që kalojnë në qendër);
- 3 linja rrethore ose gjysmërrethore (1 unazë, plus rrrathë të tjerë që kalojnë përmes qendrës).

Rrjeti nuk është projektuar në bazë hierarkike dhe/ose ortogonale për të favorizuar këmbimet dhe paraqet disa mbivendosje. Kjo shkaktohet gjithashtu edhe nga skema e kontraktimit të linjës që është aktualisht në fuqi. Të gjitha linjat, përveç njëres, mbivendosen me unazën e brendshme që rrethon sheshin “Skënderbej” (Myslym Shyri, Dëshmorët e Kombit, Sheshi Skënderbej, Abdi Toptani, George W. Bush, Rruga e Barrikadave, Urani Pano, Ded Gjo Luli, Ibrahim Rugova). Disa nga linjat mbivendosen në bulevardet kryesore radiale (Zogu I, Rruga e Durrësit, Dritan Hoxha, Rruga e Kavajës, Hoxha Tahsim, Rruga e Dibrës) dhe me unazën e mesme me linjën 14, unaza, duke mbyllur rrethin nëpër bulevardet përgjatë lumit Lana.

Vetëm tri linja (14: Unaza, 13:Tirana e Re dhe 15: Kombinat-Kinostudio) ofrojnë një shërbim relativisht të lartë duke kombinuar si shpeshtësi më të madhe, ashtu edhe kapacitet më të lartë duke përdorur autobusë fizarmonikë 18m.


I gjithë rrjeti ka 434 stacione. Distanca mesatare midis ndalesave është e ndryshueshme. Sipas rregullores së miratuar nga Bashkia e Tiranës, distanca midis ndalesave për linjat e autobusëve periferikë është nga 500 në 1000 m, ndërsa për linjat urbane kjo distancë është nga 250 në 400 m.

Linjat e mëparshme komerciale të autobusëve që lidhin Tiranën me disa qendra tregtare në periferi, përkatësisht me QTU-në, Casa Italia-n, Tirana East Gate dhe Citypark (kryesisht të ofruara falas për klientët dhe të operuara nga vetë qendrat tregtare) tani janë integruar në rrjetin zyrtar të autobusëve urbanë.

Shpeshtësia e planifikuar e shërbimit varion nga 3 deri në 15 minuta midis linjave. Për sa i përket performancës, i gjithë rrjeti ka regjistruar një shpeshtësi mesatare normale prej 9 minutash në baza ditore, në shpeshtësi mesatare në orare piku prej 6 minutash në vitin 2021.

Rrjeti shtrihet në mbi 170 km të rrjetit rrugor. Për sa i përket aksesit, pothuajse 257 000 banorë jetojnë brenda zonës prej 150 metrash në këmbë nga një stacion autobusi (Studimi Strategjik i Transportit të Tiranës, 2019). Kjo përfaqëson afërsisht 35% të popullsisë që jeton brenda njësisë bashkiake të Tiranës. Në përgjithësi, i gjithë rrjeti është në distancë 15-20 minuta në këmbë për pjesën më të madhe të popullsisë urbane.

Tabela 11 - Rrjeti i autobusëve urban për linjë



Pas miratimit në vitin 2020 të Planit të Lëvizshmërisë së Qëndrueshme Urbane, Bashkia e Tiranës ka nisur implementimin e projektit SUTi (Transporti i Qëndrueshëm Urban në Tiranë), në bashkëpunim me GIZ dhe KfW. Një ndër tre shtyllat e këtij projekti është edhe modernizimi i sistemit të transportit urban. Si një ndër projektet më ambiciozë të dekadave të fundit, ky projekt parashikon implementimin

e sistemit BRT (Bus Rapid Transport) në tre linjat kryesore të transportit urban të Tiranës: Unaza, Tirana e re dhe Kinostudio-Kombinat.

#### *Sistemi i tarifave dhe biletave*

Tarifat e transportit publik për linja deri në 9 km janë si më poshtë:

- Udhëtim i vetëm dhe biletë linje 40 lekë
- Abone mujore për linjë 1,200 lekë
- Abone të përgjithshme për të gjitha linjat 1,600 lekë

Bileta për një udhëtim dhe abonimet mujore i referohen vetëm një linje. Përdoruesit e transportit publik të cilët duan të përdorin më shumë linja duhet të blejnë bileta ose karta shtesë. Vetëm studentët mund të blejnë një abone mujore të integruar (d.m.th. të vlefshme për të gjitha linjat e autobusëve brenda 9 km) me një kosto prej 600 lekë. Personat me aftësi të kufizuara dhe veteranët ushtarakë mund të udhëtojnë falas.

Biletat me një udhëtim mund të blihen brenda autobusit, ndërsa abonimet mujore dhe gjashtëmujore mund të blihen në kioskat afër vendqëndrimeve ose stacioneve të autobusëve. Aktualisht, të gjitha biletat dhe kartat janë në formatin letër.

#### *RRJETI I TRANSPORTIT PUBLIK NËNURBAN*

Shërbimi nënurban i transportit publik përbëhet nga 25 linja autobusi, të cilat lidhin zonat dhe fshatrat rurale të Bathores/Zall-Herrit (L23), Kusit (L26), Tufinës, Dajtit/Tujanit/Lanabregasit (L5), Shëngjergjit (L15), Farkës (L03), Kërrabës (L10, L11), Petrelës (L01), Baldushkut (L13), Pezës (L19), Ndroqit (L21), Vaqarrit/ Arbanës (L17, L18) dhe fshatra të tjerë të vegjël.

Shërbimi periferik realizohet kryesisht me autobusë më të vegjël çdo ditë nga ora 5:00 deri në 23:00 në periudhën prill/tetor dhe nga ora 5:30 deri në 22:30 në periudhën nëntor/maj. Shpeshësia është e ndryshueshme me maksimumi 15-20 min diferencë nisjeje në orët e pikut. Një biletë në një drejtim kushton 50 lekë, ose pak më shumë, në varësi të distancës së udhëtimit. Pothuajse të gjitha linjat rurale/nënurbane janë të lidhura me rrjetin urban në 4 nyje kalimi të vendosura në qendër të qytetit). Aeroporti ndërkombëtar “Nënë Tereza” lidhet gjithashtu me qendrën e qytetit nga linja Rinas Express. Furgoni lëviz çdo ditë çdo 30 minuta nga ora 7:00 e mëngjesit deri në orën 24:00 dhe kushton 300 lekë për një drejtim/një udhëtim.

#### *Transporti Për Shkollat*

Transporti i nxënësve në Tiranë menaxhohet nga shkollat dhe kryhet nga kompani private të licencuara të autobusëve. Me VKM nr. 89, datë 14.02.2018, Qeveria Shqiptare ka vendosur rregullat që duhet të ndjekin kompanitë për të siguruar një transport të sigurt të fëmijëve në shkollë. Në të përcaktohen kushte në lidhje me automjetin dhe shoferin. Licencimi i kompanive është përgjegjësi e Bashkisë së Tiranës. Shoferët janë përgjegjës për fëmijët jo vetëm për kohën brenda automjetit, por edhe gjatë hipjes dhe zbritjes nga automjeti. Raportimi për personat përgjegjës në shkollë lidhur me sjelljen e fëmijëve gjatë udhëtimit të tyre nga/për në shkollë është gjithashtu detyrim i shoferit.

#### *Taksitë*

Në Tiranë aktualisht ka mbi 1 000 taksi të licencuara. Një udhëtim me taksi për të arritur në qendër të qytetit nga lagjet më periferike mund të kushtojë mesatarisht 600 lekë (4.92 €). Për çdo kërkesë të re për licencim, automjeti duhet të plotësojë njërin nga kushtet e mëposhtme:

- “Euro 6” ose një standard të ri (nëse përcaktohet);
- makinë “elektrike”;
- makinë “hibride”.

### 3.1.4 Parkimi

Bashkia Tiranë ka krijuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak **nr. 48, datë 11.11.2015**, Tirana Parking (TP) si një Institucion në varësi të BT për “Administrimin e Shërbimit të Parkimit Publik me Pagesë”. Sipas këtij vendimi, fushat e përgjegjësisë së Tirana Parking janë administrimi i shërbimit të parkimit publik në rrugë dhe në sheshe, mbi dhe nëntokësore, planifikimi dhe zbatimi i investimeve në infrastrukturë, instalimi dhe mirëmbajtja e sinjalistikës rrugore dhe makinerive të parkimit me pagesë, si edhe konstatimi dhe gjobitja e kundravajtjeve administrative për mospagesë tarife apo qëndrim përtej orarit të caktuar në vendparkim.

Me Vendimin e Këshillit Bashkiak **nr. 49, datë 11.11.2015** janë përcaktuar:

- Kriteret e Zonave të Administrimit të Parkimit (ZAP) duke e ndarë Tiranën në 4 ZAP-e *ZAP 1, ZAP 2, ZAP 3* dhe *ZAP 4* (Fig.1)
- Rrugët ku do të shtrihet parkimi me pagesë në çdo ZAP
- Numrin e vendparkimeve që do të jenë me pagesë apo të lirë për rezidentët dhe personat me aftësi të kufizuara.
- Sistemi tarifor për parkimin në rrugë dhe në sheshe duke e ndarë Tiranën në zonat A, B dhe C.




Figura 19 - Harta e Zonave të Administrimit të Parkimit

Në çdo ZAP janë përcaktuar nënzonat e destinuar për parkim (NDP) të cilat ndahen në NDP pa pagesë dhe NDP me pagesë. NDP-të pa pagesë përfshijnë:

- parkimin për rezidentët,
- parkimin e lirë pa kontrolle të kohëzgjatjes
- parkimin pa pagesë për Personat me Aftësi të Kufizuara (PAK).

Në këto NDP, jo më pak se 5% e vend-parkimeve duhet të rezervohen për PAK, ndërsa vendparkimet e disponueshme ndahen në raportin 70% ose 60% për rezidentët dhe 30% ose 40% parkim i lirë dhe PAK. Ndarja bëhet gjithmonë duke marrë në konsideratë kapacitetin e rrugës si dhe vendodhjen e saj.

Në NDP me pagesë parkimi është me pagesë nga e hëna në të premte në fashën orare 7:30 - 20:00. Ditët e fundjavës dhe në fashën orare 20:00 - 7:30 parkimi është pa pagesë. Ndonëse VKB nr. 59 parashikon se në zonat me aktivitet intensiv social dhe ekonomik, parkimi me pagesë do të aplikohet edhe gjatë ditëve të fundjavës, kjo gje ende nuk është aplikuar në asnjë zonë.

Tarifat, të cilat përcaktojnë edhe burimet e të ardhurave të TP janë miratuar në VKB nr. 49, datë 11.11.2015 si më poshtë:

- Tarifat e shërbimit të parkimit në rrugë;
- Tarifat e shërbimit të parkimit të rezervuar në rrugë;
- Tarifat e shërbimit të parkimit në sheshe;

- Tarifat e shërbimit të parkimit të rezervuar në sheshe;
- Tarifa e shërbimit të parkimit për taksi.




Figura 20 - Harta e Zonave Tarifore

Kështu, tarifat e parkimit në rrugë janë 100 Lekë/ora në Zonën A, 40 Lekë/ora në Zonën B dhe 20 Lekë/ora në Zonën C.

Tabela 12 - Tarifat e Parkimit në Rrugë

Zona	Lekë/Orë
Zona A	100
Zona B	40
Zona C	20

Në rrugë, përgjithësisht për bizneset ofrohet edhe shërbimi i parkimit të rezervuar, sipas tarifave të mëposhtme.

Tabela 13 - Tarifat e Parkimit të Rezervuar në rrugë

Paketa/Abonimi	Orë/Ditë	Ditë /Vit	Total Orë	Zona A (Tarifa/Lekë)	Zona B (Tarifa/Lekë)	Zona C (Tarifa/Lekë)
Kontrata 1 vit (nga e hëna -të premte)	12	264	3,168	221,760	88,704	44,352
Kontrata 1 vit (nga e hëna - të diel)	24	365	8,760	438,000	175,200	87,600
Kontrata 1 vit (nga e hëna - të diel)	12	365	4,380	306,600	122,640	61,320
Kontrata 1 vit (nga e hëna - të premte)	10	264	2,640	198,000	79,200	39,600
Kontrata 1 vit (nga e hëna - të diel)	10	365	3,650	255,500	102,200	51,100



Tarifat e parkimit në sheshe bazohen në intervale kohore, duke favorizuar parkimin afat-gjatë mbi 12 orë, sipas detajeve në tabelën më poshtë.

Tabela 14 - Tarifat e Parkimit në Sheshe

Intervali Kohor	Tarifa/Zona A	Tarifa/Zona B	Tarifa/Zona C
<b>Autoveturat</b>			
0-3 Orë	200 Lekë	100 Lekë	50 Lekë
3-8 Orë	500 Lekë	250 Lekë	120 Lekë
8-12 Orë	800 Lekë	300 Lekë	250 Lekë
12-24 Orë	500 Lekë	300 Lekë	250 Lekë
<b>Autobuzat</b>			
1 Orë	500 Lekë	250 Lekë	150 Lekë
1-3 Orë	1,000 Lekë	500 Lekë	300 Lekë
3-8 Orë	2,000 Lekë	800 Lekë	300 Lekë
12-24 Orë	3,500 Lekë	1,000 Lekë	500 Lekë

Shërbimi i parkimit të rezervuar ofrohet edhe në sheshe përmes abonimeve, ku aplikohen tarifat e mëposhtme.

Tabela 15 - Tarifat e Shërbimit të Parkimit të Rezervuar në Sheshe

Paketa	Orë/Ditë	Zona A	Zona B	Zona C
Abonim 1 mujor	8	12,300 Lekë	5,000 Lekë	2,500 Lekë
Abonim 3 mujor	8	35,000 Lekë	14,000 Lekë	6,600 Lekë
Abonim 6 mujor	8	67,600 Lekë	27,500 Lekë	13,000 Lekë
Abonim 12 mujor	8	132,000 Lekë	53,000 Lekë	25,000 Lekë

Përsa i përket Tarifës së Shërbimit të Parkimit për Taksi, ajo është një tarifë fikse e barabartë me 27,600 lekë që paguhet çdo vit nga taksitë e licensuara. Kjo tarifë paguhet pranë TP dhe dokumentet e nevojshme për kryerjen e procedurës janë Ekstrakti QKR dhe një fotokopje e licensës. Për makinat elektrike ofrohet parkim falas te parkimet te Sheshi Skënderbej dhe Bulevardi i Ri, për të nxitur përdorimin e tyre.

#### *Parkimi në Rrugë*

Në përputhje me VKB nr. 49, datë 11.11.2015, shërbimi i parkimit me pagesë do të shtrihej në total në 72 rrugë, nga të cilat 48 rrugë në Zonën A, 16 rrugë në Zonën B dhe 8 rrugë në Zonën C. Pas vendimeve të mëvonshme me urdhër të këshillit bashkiak, numri i rrugëve që TP administron ndryshoi për shkak të heqjes së admistrimit nga disa rrugë të cilat u kthyen në korsitë bicikletash. Shërbimi i parkimit me pagesë është zgjeruar gradualisht përgjatë viteve dhe ende nuk ka arritur të mbulojë të gjitha rrugët e përcaktuara. Kështu, gjatë vitit 2016 TP ka ofruar shërbimin e parkimit me pagesën në 11 rrugë në total të cilat janë të gjitha të lokalizuara në zonën A. Gjatë vitit 2017 ky shërbim u shtri edhe në 17 rrugë të reja, duke e çuar numrin total në 28, të cilat gjithashtu ndodheshin të gjitha në zonën A. Në vitin 2018, numri i rrugëve të zonës A u rrit në 39 dhe shërbimit të parkimit me pagesë iu shtuan edhe 8 rrugës të zonës B, duke e çuar numrin total në 47. Aktualisht, TP administron 64 rrugë nga të cilat 38 në zonën A, 19 në zonën B dhe 7 në zonën C.

Tabela 16 - Rrugë me parkim me pagesë

Viti	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Zona A	11	28	39	35	38	38
Zona B	0	10	9	9	19	19
Zona C	0	0	0	6	7	7
<b>Totali</b>	<b>11</b>	<b>38</b>	<b>48</b>	<b>50</b>	<b>64</b>	<b>64</b>

Në total, në këto rrugë TP administron 4273 vendparkime nga të cilat 2123 janë vendparkime me pagesë, 90 janë vendparkime për persona me aftësi të kufizuar, 1450 janë vendparkime të lira për rezidentët dhe 610 janë vendparkime me rezervim.

Tabela 17 - Nr. i Vend-Parkimeve në Rrugë të Operuara nga TP

Zona	Rruga	Nr total i vendparkimeve	Vendparkim me pagesë	Vendparkimi rezervuar	Vendparkim për Aftësi të Kufizuar	Vendparkim i lirë (rezident)
<b>Zona A</b>	38	2135	1126	335	51	623
<b>Zona B</b>	19	1483	738	163	28	554
<b>Zona C</b>	7	655	259	112	11	273

Gjatë vitit 2022, shërbimi i parkimit me pagesë do të shtrihej edhe në 12 rrugë të reja, nga të cilat 2 rrugë ndodhen në zonën A, 8 rrugë ndodhen në zonën B dhe 2 rrugë në zonën C. Në total këto rrugë do të kenë 906 vendparkime nga të cilat 675 do të jenë me pagesë, 246 do të jenë të lira dhe 15 do të jenë për personat me aftësi të kufizuara.




Figura 21 - Parkimi Ekzistues në Rrugë dhe në Sheshe

### Parkimi në Sheshe

Përveç shërbimit të parkimit në rrugë, TP aktualisht operon edhe 10 sheshparkime, nga të cilat katër janë parkime nëntokësore, ndërsa pjesa tjetër janë mbitokësore. Në total, vendet e parkimit në sheshe janë 1,352.

Përgjatë viteve të operimit të TP, numri i shesheve të parkimit është rritur gradualisht, kjo edhe falë investimeve të Bashkisë Tiranë. TP aktualisht operon edhe 10 sheshparkime, nga të cilat katër janë parkime nëntokësore, ndërsa pjesa tjetër janë mbitokësore. Në total, vendet e parkimit në sheshe janë 1,352.

Tabela 18 - Nr. i Vend-Parkimeve në Sheshe

Nr.		Emërtimi	Vend-Parkime
1	Zona A	Shesh parkimi "Selman Stermasi"	84
2		Shesh parkimi "Asllan Rusi"	76
3		Shesh parkimi Infosoft	37
4		Shesh parkimi "Avni Rustemi"	27
5		Shesh parkimi nëntokësor "Skenderbej"	303
6		Shesh parkimi nëntokësor "7 Xhuxhat"	140
7		Shesh parkimi nëntokësor Italia "Arena"	198
8	Zona B	Shesh parkimi nëntokësor "Bulevardi i Ri"	321
9		Diga e Liqenit	58
10	Zona C	Shesh parkimi "Qytet Studenti"	108
<b>11</b>		<b>TOTAL</b>	<b>1 352</b>

Parkimi nëntokësor në Sheshin Skënderbej me kapacitet 303 vend-parkime dhe parkimi nëntokësor pranë Bulervardit të ri me kapacitet 321 vend-parkime janë dy asetet më të rëndësishme të TP, të cilat janë financuar nga buxheti i Bashkisë Tiranë. Nga ana tjetër, TP ka investuar nga buxheti i vet 189,630,431 Lekë për ndërtimin e 5 sheshparkimeve, përkatësisht pranë Pallatit të Sportit Asllan Rusi, pranë Qytetit Studenti, pranë sheshit Avni Rustemi, pranë Digës së Liqenit Artificial dhe pranë ish-Doganës. Ndërkohë, po me financimin e Bashkisë së Tiranës, janë ndërtuar edhe parkimi nëntokësor tek parku i lojërave “Shtatë Xhuxhat” pranë Rr. së Elbasanit me kapacitet 139 vende dhe parkimi nëntokësor në Sheshin Italia me kapacitet 198 vende.

#### *Parkimi për Rezidentë*

Shërbimi i parkimit për rezidentë është shtrirë në të katërta ZAP-et, duke variuar sipas gjendjes së rrjetit rrugor dhe hapësirave të disponueshme. Në total numri i vend-parkimeve të rezervuara për rezidentët, aktualisht është 5,841, sipas detajeve të tabelën më poshtë.

Tabela 19 - Nr. i Vend-Parkimeve për Rezidentë sipas ZAP

Nr	Emërtimi	Vend-Parkime
1	ZAP 1	2,964
2	ZAP 2	606
3	ZAP 3	502
4	ZAP 4	1,769
5	<b>TOTAL</b>	<b>5,841</b>

ZAP me më shumë vend-parkime për rezidentë është ZAP 1 e cila përfshin zonën mes Bulevardit Zog I, Rr. Llazi Miho, Rr. Konferenca e Pezës, Bulevardi Gjergj Fishta dhe Bulevardi Dëshmorët e Kombit. Në këtë ZAP ndodhen rreth tre mijë vend-parkime për rezidentë. Edhe ZAP 4 ka një numër të kënaqshëm vend-parkimesh për rezidentë me rreth 1,800 vend-parkime. Dy zonat e tjera, ZAP 2 dhe ZAP 3 kanë një numër të kufizuar vend-parkimesh për rezidentë, e kjo për shkak të dendësisë së lartë dhe mungesave të hapësirave të parkimit.

Gjatë vitit 2022, Tirana Parking planifikonte të shtrinte shërbimin e parkimit për rezidentë edhe në disa zona të tjera, duke shtuar një numër total prej 4,161 vend-parkimesh, sipas tabelës më poshtë.

Tabela 20 - Vend-Parkimet për Rezidentë që Planifikohet të Shtohen në 2022

Nr	Emërtimi	Vend-Parkime
1	ZAP 1	763
2	ZAP 2	1,759
3	ZAP 3	730
4	ZAP 4	909
5	<b>TOTAL</b>	<b>4,161</b>

Në këtë mënyrë, numri i vend-parkimeve për rezidentë në fund të vitit 2022 parashikohej të shkonte në 10,002. Shpërndarja e këtyre vendparkimeve në territor paraqitet në hartën më poshtë.




Figura 22 - Shpërndarja e Vend-Parkimeve për Rezidentë

Siç mund të vërehet në hartë, shërbimi i parkimit për rezidentë kryesisht është shtrirë vetëm në pjesën qendrore të Tiranës, duke mbuluar më së shumti zonën në brendësi të Unazës së Mesme si edhe zonën e ish-blokut e përreth Stadiumit Selman Stërmasi.

### *Parkimi i Rezervuar*

Tirana Parking si i vetmi Institucion për “ Administrimin e Shërbimit të Parkimit Publik me Pagesë” për personat fizik, juridik që duhet të pajisen me “Leje vendparkimi të rezervuar me pagesë” kërkon që të dorëzojnë dokumentacionin si më poshtë pranë zyrave të Tirana Parking:

- Ekstraktin aktual mbi historikun e subjektit juridik ose personit fizik të lëshuar nga QKR;
- Plani i vendparkimit që kërkohet për miratim;
- Si dhe çdo dokument tjetër të kërkuar nga Tirana Parking

Sot Tirana Parking administron në total 610 vende parkimi të rezervuar të ndarë sipas zonave si në tabelën më poshtë;

Tabela 21 - Nr. i Vend-Parkimeve te Rezervuara

ZONA	Nr i Vendparkimeve të rezervuara
ZONA A	335
ZONA B	163

ZONA C	112
<b>TOTAL</b>	<b>610</b>

### *Parkimi për Taksi*

Numri vend-parkimeve të rezervuara për taksi gjatë vitit 2021 ishte 474, të shpërndara në teritor sipas tabelës më poshtë.

Tabela 22 - Nr. i Vend-Parkimeve Taksi

Zona	Vend-Parkime Taksi
ZAP 1	138
ZAP 2	87
ZAP 3	62
ZAP 4	187
<b>TOTAL</b>	<b>474</b>

### 3.1.5 Infrastruktura Arsimore

Në territorin e Bashkisë Tiranë gjendejn gjithësej 298 institucione arsimore jouniversitare publike, nga të cilat 34 janë çerdhe, 45 janë kopshte dhe 218 janë shkolla. Sa u përket shkollave 9-vjeçare, nga 167 që është numri total i tyre, 14 janë të bashkuara me shkolla të mesme dhe 45 janë shkolla vartëse. Nga ana tjetër, nga 41 shkollat e mesme, 4 janë gjimnaze të orientuara dhe 1 është me kohë të pjeshme. Gjithashtu, në Tiranë ndodhen edhe 11 shkolla profesionale të cilat nuk administrohen nga Bashkia e Tiranës.

Tabela 23 - Institucionet Arsimore Parauniversitare

Viti shkollor / akademik	2019-2020	2020-2021	2021-2022
Institucione arsimore publike	292	290	298
Çerdhe	34	34	34
Kopshte	45	45	45
Shkolla gjithsej	213	211	219
9 vjeçare	167	160	167
Shkolla të mesme të përgjithshme	37	40	41
Shkolla të mesme profesionale	9	11	11

Vlen të përmendet se në territorin e Tiranës ushtrojnë aktivitetin edhe 84 shkolla private, nga të cilat 57 janë shkolla 9-vjeçare dhe 37 janë shkolla të mesme.

Në institucionet arsimore parauniversitare publike janë të regjistruar gjithsej mbi 103 mijë fëmijë, nga të cilët 4,905 në çerdhe, 7,890 në kopshte, 68,954 në shkollat 9-vjeçare dhe 21,920 në shkollat e mesme.

Tabela 24 - Regjistrimet në Institucionet Arsimore Parauniversitare

Viti shkollor / akademik	2017-2018	2018-2019	2019-2020	2020-2021	2021-2022
Çerdhe	3,079	3,756	3,972	4,206	4,905

Kopshte	11,927	9,993	7,013	7,420	7,890
9 vjeçare	67,536	67,121	68,720	68,909	68,954
Shkolla të mesme të përgjithshme	10,850	20,300	21,685	21,886	21,920
<b>Totali</b>	<b>101,430</b>	<b>112,937</b>	<b>101,390</b>	<b>102,421</b>	<b>103,669</b>

Një nga sfidat kryesore që has sot arsimit parauniversitar në gjithë vendin është gjendja jo e mirë e infrastrukturës fizike të institucioneve arsimore. Kjo situatë është evidentuar edhe në SKZHI ku theksohet se gjendja përgjithësisht e dobët e infrastrukturës fizike shkollore pengon ofrimin e një arsimit cilësor në të gjitha nivelet.

Ndonëse Bashkia e Tiranës ka bërë investime të rëndësishme në infrastrukturën e arsimit parauniversitar, mbeten sërish një numër shkollash që e zhvillojnë mësimin me dy turne apo kanë klasa me një numër të lartë nxënësish. Kjo vjen kryesisht prej zhvillimit të vullshëm demografik përmes të cilit ka kaluar Tirana duke qenë se popullsia e qytetit është trefishuar në tre dekadat e fundit dhe vazhdon ende të rritet.

Përgjatë periudhës 2015 – 2022, Bashkia e Tiranës ka investuar në ndërtimin e 40 shkollave të reja, të cilat janë ose shkolla krejtësisht të reja ose shkolla ekzistuese që janë shembur e ndërtuar nga e para, me shumë më shumë hapësira e me mjedise shumë më moderne.

Tabela 25 - Shkolla të reja të ndërtuara në periudhën 2015-2022

Shkolla të ndërtuara nga Bashkia Tiranë			
1.Shkolla Lasgush Poradeci	11.Shkolla Sevasti Qirjazi	21.Shkolla Hasan Vogli	31.Shkolla Lalm
2.Shkolla 16 Shtatori	12.Shkolla Luan Hajdaraga	22.Shkolla Murat Topani	32.Shkolla Lekë Gjikhuri
3.Shkolla Mervete Peza	13.Shkolla Ardian Klosi	23.Shkolla Qazim Turdiu	33.Shkolla Xhezmi Delli
4.Shkolla Kristo Frashëri	14.Shkolla Betim Muço	24.Shkolla Dritas	34.Shkolla Bedri Llagami
5.Shkolla Vaçe Zela	15.Shkolla Hasan Tahsin	25.Shkolla Klodian Tanushi	35.Shkolla Musine Kokalari
6.Shkolla Andrea Stefani	16.Shkolla Kosova	26.Shkolla Dora D'Istria	36.Shkolla Asim Vokshi
7.Shkolla Nënë Tereza	17.Shkolla Servete Maçi	27.Shkolla Jeronim De Rada	37.Shkolla Partizani
8.Shkolla John Kennedy	18.Shkolla Feti Fanaç	28.Shkolla 9 vjeçare 1 Qershori	38.Shkolla Besnik Sykja
9.Shkolla Bashkim Fino	19.Shkolla Rufan Hakrama	29.Shkolla Qemal Stafa	39.Shkolla Emin Duraku
10.Shkolla 9 vjeçare Kico Blushi	20.Shkolla Agron Hysenlliu	30.Shkolla Andon Zako Çajupi	40.Shkolla Sami Frashëri

Përveç sa më sipër, gjatë kësaj periudhe Bashkia e Tiranës ka kryer investime të rëndësishme edhe në rikonstruksionin e shkollave publike. Kësisoj, janë rikonstruktuar plotësisht 23 shkolla 9-vjeçare dhe 6 shkolla të mesme, për një total prej 29 shkollash.

Emërtimi i projektit	Viti i përfundimit të punimeve
Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Ibrahim Brahja"	2015
Shkolla 9-vjeçare "Gjon Buzuku"	2015
Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare "1 Maji"	2016
Rikonstruksioni i shkolles 9-vjeçare "Fan Noli"	2016
Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Emin Duraku"	2016

Rikonstruksion i shkollës 9-vjecare "4 Dëshmorët"	2016
Rikonstruksion i shkollës së Mesme " Sinan Tafaj"	2016
Rikonstruksion i shkollës së Mesme "Qemal Stafa"	2016
Rikonstruksion i plote i shkollës speciale "Luigj Gurakuqi"	2017
Rehabilitimi dhe instalimi i sistemit të ngrohjes në shkollën 9-vjeçare "Vasil Shanto"	2017
Rikonstruksion i nyjeve sanitare , Shkolla 9-vjecare e Kuqe	2017
Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Siri Kodra"	2017
Rikonstruksion i shkollës Koreografike	2017
Rikonstruksion i shkollës 9-vjecare “Mihal Grameno”	2018
Rikonstruksion dhe instalim i sistemit të ngrohjes në shkollën e mesme "Ismail Qemali"	2018
Rikonstruksion i pjesshëm i shkollës së mesme "Andon Zako Çajupi"	2018
Rehabilitimi dhe instalimi i sistemit të ngrohjes në shkollën 9-vjeçare "Vasil Shanto"	2018
Rikonstruksion i shkollës 9-vjecare "Dëshmoret e Lirisë"	2018
Rehabilitimi i pjesshem dhe instalimi i sistemit të ngrohjes në shkollën 9-vjecare "Dhora Leka" dhe ndërtimi i palestrës	2018
Rikonstruksion + Shtesë Anësore i shkollës 9-vjecare "Dora D' Istria"	2018
Ndërtim shtesë në shkollën 9-vjecare “Isa Boletini"	2018
Rikonstruksioni i shkollës 9-vjecare "Ali Demi"	2019
Rehabilitimi dhe instalimi i sistemit te ngrohjes i shkollës 9-vjeçare " Mihal Grameno”	2019
Rikonstruksioni i shkollës 9-vjecare "1 qershori"	2019
Rikonstruksion i shkollës “Gustav Majer”	2019
Rikonstruksion i shkollës 9-vjecare Sabaudiin Gabrani 1	2019
Rikonstruksion i shkollës 9-vjecare Konferenca e Pezës	2019
Rikonstruksion i shkollës së Mesme " Besnik Sykja" dhe ndërtim palestere	2023
Rikonstruksion i Gjymnazit Partizani	2023

Në këtë mënyrë, nga 208 shkolla publike që ka Tiranë aktualisht, 69 prej tyre ose rreth 33% e tyre janë ndërtuar ose rikonstruktuar gjatë 8 viteve të fundit. Duke qenë se janë përqëndruar kryesisht në zonat urbane, këto investime kanë ndihmuar në reduktimin e ngarkesës së shkollave në Tiranë, duke ndihmuar në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.

Megjithatë, në Tiranë ka ende shkolla me një numër më të lartë nxënësish si edhe zona të zhvilluara e populluara rishtazi ku nuk janë ndërtuar shkolla publike – çka bën që problemi i mbingarkesës së shkollave të jetë ende i pranishëm.

Një situatë e ngjashme, madje në një farë mënyre edhe më problematike, paraqitet sa u përket kopshteve dhe çerdheve. Siç u përmend edhe më sipër në Tiranë ndodhen 79 kopshte dhe çerdhe të cilat aktualisht frekuentohen nga mbi 12,700 fëmijë. Megjithatë, numri i fëmijëve të grup-moshës 0-6 vjeç në Tiranë është shumë më i lartë, çka ka bërë që të ketë një kërkesë më të lartë për regjistrime sesa kapaciteti i këtyre institucioneve. Aktualisht, kapaciteti i ulët i kopshteve dhe çerdheve publike është plotësuar nga kopshtet dhe çerdhet private si edhe nga familjarët që nuk punojnë.

Megjithatë, ndryshimet e strukturave familjare si edhe kostot në rritje të edukimit privat janë faktorë që mund të ndikojnë në një rritje të kërkesës për regjistrime në kopshtet dhe çerdhet publike në të ardhmen.



Faktikisht, Bashkia e Tiranës është përpjekur ta adresojë këtë situatë duke përfshirë edhe kopshte të integruara në shkollat 9-vjeçare që ndërtohen të reja. Gjithashtu, Bashkia e Tiranës ka investuar edhe në rikonstruksionin apo ndërtimin e kopshteve dhe çerdheve. Kësisoj, Bashkia e Tiranës ka ndërtuar 6 kopshte të reja të integruara në shkolla 9-vjeçare përmes skemës PPP, si edhe ka rikonstruktuar apo ndërtuar 8 kopshte dhe çerdhe të tjera.

Emërtimi i projektit	Viti i përfundimit të punimeve
Rikonstruksion dhe shtesë kati Cerdhe nr.13	2016
Ndërtim kopësht dhe Cerdhe e integruar Kodër Kamëz	2019
Ndërtim kopësht dhe cerdhe e integruar Shkozë	2022
Rikonstruksion i kopshtit në Kodër Kamez, Njesia bashkiake nr. 11	2015
Rikonstruksion i Kopshtit Nr.18	2017
Rikonstruksion i kopshtit Nr. 55	2017
Rikonstruksion i kopshtit nr. 17 (e re)	2017
Shtesë kontrate Rikonstruksion i Kopshtit Nr.18	2018

Një tjetër nismë, e njohur si fushata "Adopto një çerdhe", ka rezultuar shumë e suksesshme. Në kuadër të këtij programi, 31 çerdhe dhe kopshte i janë nënshtruar rikonstruksionit, falë kontributeve të donatorëve që i janë bashkuar kauzës. Si rezultat, 3,079 fëmijë tani kanë akses në qendrat e përmirësuara të kujdesit ditor në Tiranë, duke theksuar më tej përkushtimin e bashkisë për investime në arsimin e hershëm.

Përveç ndërtesave të shkollave, kopshteve dhe çerdheve, Bashkia e Tiranës është përgjegjëse edhe për mirëmbajtjen dhe operimin e rezidencave studentore, si për shkollat e mesme ashtu edhe për universitetet.

### **Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të mesme**

Kjo strukturë është përgjegjëse për akomodimin e nxënësve në shkollat e mesme dhe administron jo vetëm procesin e akomodimit por edhe atë të mirëmbajtjes së objekteve që shërbejnë si konvikte.

Aktualisht kjo drejtori administron 4 godina në të cilat mund të akomodohen rreth 500 nxënës. Kërkesat për akomodim në konvikte rriten nga viti në vit dhe për vitin 2018 nga fluksi i madh i kërkesave DKSHM ka gjetur një zgjidhje alternative (marrja me qira e një godine tjetër). Godinat janë të pajisur me shërbimin e sigurisë (roje) gjatë natës dhe për çdo godina ka dy kujdestarë që punojnë me turne.

Përveç problemit të mungesës së ambienteve shtesë për akomodim, herë pas herë shfaqen probleme lidhur me kushtet higjieno-sanitare, si edhe dy prej godinave ekzistuese janë privatizuar. Për të ulur shpenzimet operative dhe për të rritur cilësinë e kushteve të akomodimit janë propozuar disa zgjidhje afatmesme (konsolidimi i 4 konvikteve në një godinë të vetme duke shtuar edhe shërbimin e transportit për nxënësit. Konsolidimi do të sjellë edhe zgjidhjen e problemeve të vazhdueshme infrastrukturore. Kjo gjë mund të realizohet në bashkëpunim me bizneset apo me financimet e huaja.

Probleme të tjera lidhen edhe me mungesën e një sistemi prioritizimi që të mund t'ju jepet mbështetje më e madhe shtresave në nevojë (PAK, jetimët, nxënësve me ndihmë ekonomike etj) si edhe unifikimi i formave të subvencionimit për këta nxënës.

### **Rezidenca Studentore Universitare Nr.1**

Qyteti Studenti është ndërtuar para më shumë se 50 viteve dhe në projekt ishin parashikuar 35 ndërtesa, me një sipërfaqe 255,000 m<sup>2</sup> dhe me një 155.000 m<sup>2</sup> sipërfaqe ndërtimit. Deri para pak kohësh sipërfaqja e tij ishte 234,300 m<sup>2</sup> dhe përbëhej nga 26 objekte (78.450 m<sup>2</sup> sipërfaqe ndërtimit) në shërbim të studentëve dhe 4 objekte shërbimi dhe administrimi (12.800 m<sup>2</sup>), si edhe ambiente të gjelbëruara, rrugë, sheshe, të cilat janë nën administrimin e shoqërisë aksionere “Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1”.

Nevojë për një konceptim të këtyre rezidencave si një kampus i mirëfilltë bëri që gjatë vitit 2016 të hartohej Masterplani i Qytetit Student, një dokument që përcakton riorganizimin e të gjithë hapësirës së qytetit Studenti me fokus ndërtimin dhe rikonstruktimin e rezidencave, objekteve të shërbimit, hapësirave të përbashkëta argëtuese dhe sportive.

Përgjatë viteve të fundit, në këtë rezidencë kanë ndodhur një sërë investimesh të rëndësishme dhe investime akoma më të mëdha janë planifikuar në të ardhmen e afërt, duke e shndërruar qytetin student në një kampus të mirëfilltë universitar. Kësisoj dy nga godinat që strehojnë studentët janë rikonstruktuar plotësisht falë një granti të qeverisë gjermane. Po përmes fondeve të qeverisë gjermane po punohet edhe për ndërtimin nga e para të 6 godinave të reja. Nga ana tjetër, përmes procesit të rindërtimit po ndërtohen nga e para dy godina dhe po rikonstruktohen totalisht 4 godina të tjera.

Gjithashtu, Bashkia e Tiranës aktualisht po harton projektet e detajuara për ndërtimin në territorin e Qytetit Studenti të kampusit universitar, i cili do të përfshijë ndërtimin e disa godinave të disa fakulteteve të Universitetit të Tiranës si edhe të Universitetit të Arteve.

RSU1 sha administron edhe rezidencat studentore të Universitetit Bujqësor të Tiranës. Më parë këto rezidenca administroheshin nga Ndërmarrja e Trajtimit të Studentëve Nr. 3 e cila në vitin 2020 u bashkua me RSU1. Të gjitha ndërtesat në këtë kampus u dëmtuan rëndë nga tërmeti i vitit 2019 dhe u shëmbën për t'u ndërtuar nga e para. Aktualisht punimet e ndërtimit janë përfunduar dhe ndërtesat janë funksionale. Nga procesi i rindërtimit u ndërtuar gjithsej 8 godina, 7 prej të cilave janë rezidenca studentore dhe 1 godinë shërbimesh. Në total, në godinat e saponërtuara mund të strehohen rreth 2000 studentë.

### **Rezidenca Studentore Universitare Nr. 2**

RSU2 ka në administrimin e saj 8 godina, të cilat mirëpresin studentë nga Fakulteti Inxhinierisë së Ndërtimit të Universitetit Politeknik të Tiranës dhe nga Universiteti i Mjeksisë.

Rezidencat e Fakultetit të Inxhinierisë përbëhen nga 4 objekte të ndërtuara në vitin 1990, të projektuara për të mirëpritur një kapacitet rreth 1500 studentësh. Këto 4 godina 6- katëshe lidhen përmes një strukture shërbimi 1 katëshe. Këto objekte që prej vitit 2018 janë në proces rikonstruktimi nëpërmjet projektit “Rehabilitimi me Eficiência Energjitime” një bashkëfinancim me Republikën Federale të Gjermanisë nëpërmjet KFW. Këto godina kanë një kapacitet akomodues prej 1100 studentësh.

Edhe godinat e Universitetit të Mjekësisë janë rikonstruktuar plotësisht falë ndërhyrjeve të financuara nga qeveria gjermane dhe program i rindërtimit.


## 3.2 Zhvillimi Ekonomik

### 3.2.1 Biznesi në Tiranë

Reforma territoriale ka rritur kufijtë e administruar nga BT me 25 herë, si rrjedhojë janë rritur mundësitë për biznesin për tu zgjeruar drejt bujqësisë, ndërtimit, turizmit dhe shërbimeve të tjera. Gjatë dekadës së fundit, ka pasur një rritje të shpejtë të numrit të ndërmarrjeve, rreth dy herë më shpejt se rritja e popullsisë së qytetit.

Në Tiranë janë rreth 65 ndërmarrje për 1,000 banorë. Rreth 32.8% e të gjitha ndërmarrjeve që janë aktive në Shqipëri janë të vendosura në Qarkun Tiranë dhe prodhimi ekonomik i këtyre ndërmarrjeve është gjerësisht i larmishëm. Tirana është edhe tërheqja kryesore për investitorët e huaj, pasi shumica e kompanive në pronësi të huajve në Shqipëri janë të vendosura në Tiranë.

Figura 23 - Numri i Bizneseve në Bashkinë Tiranë 2016 - 2022




Burimi: OpendataTirana, Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore

Kryeqyteti është zona më e lakmuar ndër qytetet e tjera për të zhvilluar biznes, kjo për shkak të numrit të lartë të popullsisë, të përqendrimit të shërbimeve dhe institucioneve shtetërore.

Në 24 NJA-të dhe lagjet e Tiranës zhvillojnë aktivitetin 56,289 subjekte kryesore dhe sekondare, ku 11 NJA-të urbane kanë edhe përqendrimin më të lartë. Por ajo që vihet re është shifra e lartë edhe e bizneseve sekondare, pra që janë në pronësi të individëve që kanë edhe një biznes kryesor. Numri i subjekteve sekondare tek 24 NJA-të e Tiranës që zhvillojnë aktivitetin ekonomik është 8,459.


Sipas të dhënave nga BT, 83.9% e subjekteve kryesore e përbejnë NJA-të urbane dhe 16.1% e përbejnë ato rurale.

Figura 24 - Bizneset sipas kategorive 2016 - 2022



Biznesi i vogël është rritur ndjeshëm, kjo lidhur edhe me përpjekjet e qeverisë qendrore dhe vendore për uljen e informalitetit. Kategoritë e tjera vazhdojnë të kenë një stabilitet ekonomik.

Figura 25 - Bizneset sipas llojit të aktivitetit 2016 - 2022




Vihet re qartë se Shitja me Pakicë dhe njësitë e Shërbimeve vazhdojnë të kenë rritje graduale dhe më të shumtat në numër krahasuar me llojet e tjera të bizneseve përgjatë 5 viteve të fundit. Bashkia Tiranë i ka kushtuar një vëmendje të veçantë edhe në 5 vjeçarin e fundit bashkëpunimit me bizneset dhe lehtësimin të një sërë procedurave administrative me të cilat bizneset përballen çdo ditë.

### 3.2.2 Zonat ekonomike, Klasterat dhe Tregjet Publike

**Zonat Ekonomike** në Tiranë janë TEDA Kashar, e cilësuar si një nga projektet e rëndësishme të Bashkisë së Tiranës dhe më herët ka marrë edhe statusin e investimit strategjik nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve sipas vendimit Nr. 1/8 datë 15.07.2021. Përmes këtij projekti TEDA, Bashkia e Tiranës synon të thithë investime të huaja direkte, duke zgjeruar gamën e industrive operuese në tregun shqiptar, me fokus te industritë prodhuese si sektor automotiv, teknologjia e informacionit, elektronikë, bioteknologji, tech-logistics etj.

Bashkia e Tiranës, në pjesën e parë të vitit aktual ka nisur punimet për ndërtimin e Infrastrukturës Publike brenda zonës “TEDA” Tiranë.

Figura 26 - Harta e Zonës së TEDA



**Klasterat** janë ndërveprim i bizneseve të tipologjive të ngjashme që plotësojnë njëra tjetrën në ciklin e zinxhirit të vlerës, që ndërliken në rrjet dhe bashkëpunojnë midis tyre.

Rajoni Durrës-Tiranë është nyja kryesore e ndërveprimit të burimeve njerëzore, mallrave, dhe hapësirave të jetueshme të veriut dhe jugut të Shqipërisë si dhe porta hyrëse e “Korridorit VIII”. Ndikim të drejtpërdrejtë në ekonominë e rajonit luajnë dhe portat logjistike të pozicionuara në të, Porti i Durrësit dhe Aeroporti “Nënë Tereza”. Rajoni Durrës - Tiranë është kontribuesi kryesor i zhvillimit ekonomik në rang kombëtar, si në numër biznesesh po njësoj dhe në shumëllojshmërinë e tyre, kjo falë prezencës së lartë në numër të institucioneve, numrit të lartë të dendësisë së banorëve në rajon si dhe pozicionimit të favorshëm gjeografik. Si rrjedhojë, ky rajon, do të vazhdojë të mbetet motorri ekonomik i vendit dhe të shndërrohet në rajonin më konkurrues në Ballkanin Perëndimor. Rajoni do të mbështesë krijimin e klasterave ekonomike dhe do të mbështesë bizneset dhe industritë kreative, të cilat do të sjellin një zhvillim teknologjik në të ardhmen.

**Tregjet Publike** Bashkia e Tiranës ka nën administrimin e saj disa tregje publike të përcaktuara si më poshtë:

Tabela 26 - Tregjet Publike nën administrimin e Bashkisë Tiranë

Njësia Administrative	Tregu	Viti i Ndërtimit
Njësia Administrative Nr.1	Tregu i Rrobave të përdorura Shkozë	2020
Njësia Administrative Nr. 2	Tregu Petro Nini	2016
Njësia Administrative Nr. 5	Tregu “ 1 Maji”	2000
Njësia Administrative Nr.6	Tregu Ushqimor	1995
	Tregu i Rrobave të përdorura Selitë	2021
Njësia Administrative Nr. 8	Tregu fruta-perime “4 Dëshmorët”	1999
	Pazari i Ri	Rikualifikimi
Njësia Administrative Nr. 11	Tregu fruta-perime, “Pandi Dardha, Laprakë	1996

*Tregu i Lëvizshëm* është një model i ri tregtie ambulatorë për komunitetin, me qëllim promovimin e produkteve lokale, fuqizimin ekonomik dhe rritjen e vizitueshmërisë dhe zhvillimit në zona të ndryshme të qytetit. Pjesmarrës në këtë treg janë prodhues/tregtarë ambulantë në ditë dhe zona të ndryshme të Tiranës. Ky treg ka nisur aktivitetin e tij në vitin 2019 dhe vijon akoma në mënyrë të sukseshme. Duke qënë se është një treg i lëvizshëm, asnjëherë nuk ka vendodhje të caktuar, por gjithmonë në disa zona të paracaktuara, të cilat në ditë të veçanta të javës kthehen në tregje. Deri tani janë shfrytëzuar 27 hapësira të ndryshme të qytetit. Që prej muajit Shtator 2021, ndahet në 2 zona të ndryshme në të njëjtën kohë me nga 15 tezga për secilin treg. Agjencia e Administrimit të Tregjeve (AAT) është përgjegjëse për pjesën llogjistike dhe operacionale të tregjeve.

*Tregu i shpendëve në Baldushkë* është organizuar për të gjashtin vit radhazi. Vendodhja e këtij tregu është në qendër të njësies Administrative . Sipërfaqja totale e tregut është rreth 7000 m<sup>2</sup> nga të cilat 4000 m<sup>2</sup> është dedikuar tregtimit të gjelave të detit, 1000 m<sup>2</sup> i janë dedikuar produkteve bujqësore dhe blektorale të zonës si dhe 2000 m<sup>2</sup> i janë dedikuar klientëve të tregut për parkimin e automjeteve pa pagesë. Ky treg e zhvillon aktivitetin 1 herë në vit për periudhën e festave të fundvitit.

*Tregu i “Rrobave të përdorura Shkozë”* ndodhet në rrugën “Ali Shefqeti” pranë banesave sociale. Në këtë treg tregtohen rroba të përdorura dhe kapaciteti i këtij tregu është 110 vende tregtimi.

*Tregu “Pazari i Ri”* është një treg publik me 2 funksione të cilat ndahen në:

- Markata e Gjelbër treg fruta – perime. Kapaciteti i tij është 170 vende tregtimi.
- Markata e Mbyllur ka 25 Njësi tregtare me tipologji të ndryshme duke përfshirë dhe shërbimet/Bar-restorant.

*Tregu “4 Dëshmorët”* ndodhet në Rrugën “4 Dëshmorët” dhe është një treg publik me pronësi private. Tregu ka një sipërfaqe rreth 280 m<sup>2</sup> dhe kapaciteti i tij është 60 vende tregtimi.

Tregu “Petro Nini” është një treg publik që ushtron aktivitet në truall privat. Kapaciteti i këtij tregu është 50 vende tregtimi. Tipologjia e këtij tregu është fruta-perime dhe artikuj industrial.

Tregu “Pandi Dardha” ndodhet në Rrugën “Pandi Dardha” dhe ka një sipërfaqje rreth 2000 m<sup>2</sup>. Kapaciteti i këtij tregu është 25 tezgja për tregtim fruta-perime dhe 50-55 vende për tregtim artikuj të tjerë.

Tregu “Rrobave të përdorura” Selitë Tregu i “Rrobave të përdorura” ndodhet në rrugën “Hamdi Pepa” dhe “Mustafa Haska” në zonën e Selitës. Ky është një treg i ri dhe ka një kapacitet prej 100 tezgash.

Tregu “1 Maji” ndodhet te “Ish Ekpozita” dhe ushtron aktivitet në truall privat. Eshtë një treg fruta-perime dhe ka një sipërfaqje rreth 447 m<sup>2</sup>. Kapaciteti i tij është 32 vende tregtimi.

Figura 27 - Shpërndarja e Tregjeve Publike nën administrimin e BT



### 3.2.3 Bujqësia dhe Zhvillimi Rural

Bujqësia vazhdon të mbetet një nga sektorët më të rëndësishëm për vendin tonë, favorizuar nga klima dhe po ashtu nga fakti se pothuajse gjysma e popullsisë jetojnë në zona rurale ku bujqësia është aktiviteti kryesor. Tirana si qark ka rreth 35,800 ha tokë bujqësore të mbjellë dhe zotëron 8.5 % të tokës bujqësore të të gjithë vendit. Tirana prodhon mesatarisht 46,580 ton drithëra në vit ose 6.6% të prodhimit të vendit, 20,447 ton grurë ose 7.3% të prodhimit të vendit, 24,229 ton misër në vit ose 6.3% të prodhimit të vendit, 104,460 ton perime në vit ose 11% të prodhimit të vendit.

Tirana është e njohur edhe për një varietet ulliri që njihet si “i Bardhi i Tiranës” nga i cili në Tiranë ndodhen rreth 600,000 rrënjë të cilat shquhen për autenticitetin e tyre dhe vlerat e pasura ushqimore dhe antikancerogjene që përmbajnë. Megjithatë, kjo kulturë shekullore gjendet e rrezikuar për shkak se Ulliri tradicional i Tiranës po zëvendësohet nga varietete të ndryshme.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna më të detajuara për vitin 2021 për mbjelljen dhe prodhimtarinë e produkteve kryesore bujqësore të Qarkut të Tiranës.

Tabela 27 - Mbjellja dhe Prodhimi në Bujqësi Qarku Tiranë (2021)

Lloji	Sipërfaqja e mbjellë (ha)	Prodhimi (Ton)	Rendimenti Kv/ha ose kg/rrënjë
Drithërat	8,500	46,400	202.5
Bimë të tjera të arave	27,400	697,600	175.4
Perimat e njoma	4,300	87,400	-
Druftrutorët	7,000	41,300	-
Ullinj*	4,219	-	8.8

(Burimi: Vjetari Statistikor 2022, INSTAT)

\*Ullinjët e kultivuar janë në dy varietete kryesore, ullinjët varietet për vaj që përfaqësojnë 87,6% të prodhimit ullirit dhe ullinjët varietet për tavolinë që zëjnë 12,4%.

Në lidhje me bujqësinë organike sektori bujqësor në Shqipëri përballet ende me disa sfida. Fillimisht ka ende mangësi në lidhje me legjislacionin e prodhimeve organike, i cili duhet të plotësohet dhe adaptohet sipas legjislacionit për prodhimin organik të BE-së. Në vitin 2011 numëroheshin mbi 120 prodhues organikë në gjithë Shqipërinë. Shumica e tyre janë të vendosur përgjatë rajonit Tiranë - Durrës ku edhe kërkesa e tregut për këto prodhime është më e lartë si dhe në zonat e tjera fushore të Fierit, Lushnjës, Kavajës dhe Vlorës. Mendohet që prej 2011-ës numri i këtyre prodhuesve të jetë shtuar, megjithatë mbetet mangësi dhe disponueshmëria e informacionit të plotë mbi numrin dhe vendodhjen e saktë të tyre.

Zhvillimi Rural është një nga pikat kyçe për integrimin në BE për shkak edhe të prioritetit të lartë që i ka dhënë Bashkimi European këtij sektori. Qeveria Shqipëtare ka hartuar “Strategjinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit 2021 – 2027”. Sipas kësaj strategjie instrumentat kryesorë të ndërhyrjes janë:

1- Mbështetje kalimtare për të ardhurat për sektorët e orientuar nga tregu nën Organizimin e Përbashkët të Tregut (perime, fruta dhe ullinj)



- 2- Mbështetje e të ardhurave për fermën sipas kriterit të sipërfaqjes bujqësore të shfrytëzuar (pagesa në buxhetin e fermës që janë të shkëputura nga lloji i prodhimit bimor apo blegtoral ose nga faktorët specifikë të prodhimit)
- 3- Mbështetja e të ardhurave për fermën për krerë të kafshëve
- 4- Kompensimi për naftën në bujqësi
- 5- Skema e cilësisë së qumshtit
- 6- Grantet për investime në asetet fizike të ekonomive bujqësore
- 7- Grantet për Investime në asete fizike që kanë të bëjnë me përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore
- 8- Grante për rehabilitimin e sistemit të ujitjes dhe kullimit
- 9- Grant për vendosjen e fermerëve të rinj.
- 10- Skemat agromjedisore dhe klimatike.

Tirana rurale ofron të gjitha kushtet për zhvillimin e këtyre sektorëve dhe me kalimin e NJA-ve rurale nën administrimin e BT-së i gjithë sektori i bujqësisë dhe blegtorisë do të gëzojë vëmendje më të lartë. Në kuadër të zbatimit të reformës territoriale BT me marrjen e funksioneve dhe përgjegjësi lidhur me zhvillimin urban, krijoi strukturat përkatëse përgjegjëse për këtë fushë të cilat do hartojnë dhe zbatojnë politika vendore rurale në fushën e bujqësisë, pyjeve dhe kullotave për të garantuar zhvillimin e zonave rurale të Tiranës, në funksion të mbrojtjes dhe shtimit të pyjeve dhe kullotave, mbështetjes ndaj fermerëve, adresimit të çështjeve teknike bujqësore të biznesit në fushën e agro-turizmit, agrobiznesit, etj

Disa nga panairët e zhvilluar nga Ministria e Bujqësisë:

*“Ditët e Bujqësisë”* është një aktivitet 3-ditor i zhvilluar në Lushnjë, si një nga zonat me prodhimin më të lartë bujqësor dhe të foragjerëve. Ditët e Bujqësisë është një platformë që synon të lidhë agrobizneset dhe sipërmarrjet me ekspertë të industrisë, fermerë dhe investitorë nga vendi dhe rajoni.


Panairi Kombëtar: *“Shqipëria punon token - Konsumo shqip”*. Ky panair kishte si qëllim promovimin e produkteve vendase autentike si dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik vendor. Ky panair mbledhi rreth 70 fermerë që reklamuan produktet e tyre bujqësore, blegtorale dhe një hapësirë iu dedikua artizanëve të Tiranës. Ky aktivitet u realizua në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë.

### 3.2.4 Punësimi dhe Aftësitë

**Popullsia e Shqipërisë ka përjetuar tkurrje dhe plakje gjatë viteve të fundit.** Sipas të dhënave demografike të publikuara nga INSTAT, popullsia e Shqipërisë vazhdon në rënie nga viti në vit për çdo vit gjatë dy dekadave të fundit, përjashtuar vitin 2017 dhe ndërkohë moshë mediane e popullsisë është rritur nga moshë 33.2 vite në vitin 2012, në moshën 38.2 vite në vitin 2022. Projektionet e popullsisë, sipas skenarit të mesëm të ndërtuar nga INSTAT-i, tregojnë se deri në vitin 2030 popullsia

totale e Shqipërisë do të pakësohet edhe me rreth 86 mijë vetë, në vijim të rënies prej mbi 104 mijë vetë gjatë dekadës së fundit 2012-2021.

Figura 28 - Popullsia e Shqipërisë, 2001-2022



Burimi: INSTAT

### **Plakja e popullsisë dhe lëvizjet migratore po zvogëlojnë rritjen e fuqisë punëtore në vend.**

Zvogëlimi i popullsisë shqiptare gjatë viteve të fundit lidhet me rënien në vazhdimësi në vite të lindjeve të reja shoqëruar me lëvizjet migratore sjell një bilanc negativ të shtesës natyrore të popullsisë. Ky proces është shoqëruar dhe me hapjen e plotë të Shqipërisë ndaj botës, lëvizjen e lirë të shqiptarëve kryesisht në vendet e Bashkimit European, shoqëruar me emigrimin e paligjshëm drejt vendeve ku ende ka pengesa hyrjeje apo qëndrimi.

Kategoritë e personave që zgjedhin të emigrojnë jashtë vendit kanë ndryshuar në vite duke krijuar mungesë në tregun e punës për aftësi specifike të cilat janë edhe më të kërkuara në tregjet e huaja. Ndryshe nga dy dekadat e para të tranzicionit, lëvizja e lirë gjatë dekadës së fundit si dhe kërkesa për fuqi punëtore të kualifikuar nga tregjet e punës në vendet e Bashkimit European, po ndryshon natyrën e tendencave migratore.


**Migrimi nga zonat rurale dhe qytetet më të vogla drejt zonave kryesore urbane,** krahas emigrimit të popullsisë, është një fenomen prezent aktualisht në Shqipëri, si pasojë e urbanizimit dhe mundësive më të mira për strehim dhe punësim që ofrohen në qytetet e mëdha të vendit. Sipas të dhënave të INSTAT-it, rreth 39 mijë persona në vit kanë lëvizur mesatarisht brenda vendit gjatë periudhës 2014-2020. Të dhënat tregojnë se shkalla e papunësisë nuk është uniforme në të gjithë vendin, por dëshmon për realitete të ndryshme nga qyteti në qytet. Qarqet me papunësi më të lartë në vend përfshijnë Lezhën (22.6 për qind në 2021) dhe Vlorën (19.5 për qind në 2021), ndërsa shkalla më e ulët e papunësisë rezultojnë në Kukës (4 për qind) dhe Gjirokastrë (4.7 për qind). Po kështu, niveli i papunësisë rezultojnë edhe më shqetësues për të papunët afatgjatë, të cilët në 2021 përbënin mbi 60 për qind të të papunëve në vend, duke dëshmuar problematikën që ekziston për daljen nga ngërçi i papunësisë dhe riaktivizimin apo riintegrimin në tregun e punës.

Me gjithë progresin e arritur në uljen e papunësisë, tregu i punës përballet me sfida të rëndësishme të cilat do të vijojnë të kërkojnë vëmendjen e politikave mbështetëse dhe orientuese në të ardhmen:

**Niveli i papunësisë tek të rinjtë është në nivel relativisht të lartë** (27.1 për qind në vitin 2021), duke treguar se të rinjtë në një masë të konsiderueshme e kanë të vështirë të gjejnë në treg punë që i përgjigjet pritshmërive të tyre, duke mbetur të papërfshirë në aktivitetin ekonomik të vendit dhe të varur ndaj mbështetjes sociale që iu jepet nga familja, shteti, të afërmit e tyre në emigracion apo të punësuar në vend. Po kështu e lartë mbetet dhe pjesa e të rinjve jo në punësim dhe as duke ndjekur shkollën, e cila përbënte 26.1 për qind të të rinjve 15-29 vjeç gjatë vitit 2021, me gjithë përmirësimin gradual të këtij treguesi, nga 34.5 për qind që ishte në vitin 2014. Përveç mospërputhjes së vendeve të punës, shumë faktorë të rëndësishëm ekonomikë e socialë ndikojnë në mospjesmarrjen e të rinjve në tregun e punës: kushtet e duhura për punë të denjë, formimi i duhur, mungesa e përvojës, aksesit në tregun e punës apo dhe faktorë të tjerë.

Në vitin 2021, ka rreth 1,25 milion njerëz të punësuar në Shqipëri, 0,56 milion gra dhe 0,69 milion burra. Ata janë persona të moshës 15 vjeç e lart, të cilët punojnë me pagesë ose fitim sipas rezultateve të Anketës së Forcave të Punës kryer nga INSTAT. Numri i njerëzve të punësuar është thelbësor për të vlerësuar aftësinë e ekonomisë për të krijuar vende pune.

Figura 29 - Shkalla e papunësisë




Burimi: Anketa e Forcave të Punës

Shkalla e papunësisë së të rinjve llogaritet duke raportuar numrin e personave të papunë të moshës 15-24 vjeç ndaj forcës së punës (shuma e personave të punësuar dhe të papunë) të së njëjtës grupmoshë. Ky tregues mund të tregojë një probabilitet të përgjithshëm të të rinjve që janë të papunë dhe shfrytëzimin e duhur të aftësive të tyre.

Tirana si qyteti me popullsinë më të madhe, përse i përket shkallës së punësimit ka pësuar një rritje të vogël krahasuar me 2020 ku shkalla shënonte 48.8% në 49.5% në 2021. Shkalla e punësimit është një tregues i rëndësishëm i shëndetit ekonomik të qytetit dhe disponueshmërisë së mundësive të punësimit për banorët e tij. Shkalla e pjesmarrjes në forcat e punës është një tjetër indikator ose tregues i rëndësishëm, i cili për qytetin e Tiranës shënon 56.1%.

Figura 30 - Shkalla e punësimit, papunësisë dhe pjesëmarrjes në forcat e punës, në Tiranë



Burimi: Instat

Niveli i papunësisë është më i theksuar tek personat me arsimim më të ulët, gratë, banorët në zonat rurale dhe qytete të vogla dhe ndër shtresat e tjera vulnerabël të popullsisë duke ndikuar në një masë edhe më të madhe në nivelin e varfërisë së tyre. Në mënyrë të dukshme, vajzat dhe gratë rezultojnë në një pozitë më të pafavorshme se meshkujt në të gjithë treguesit e punësimit në vend.

Tabela 28 - Përmbledhje e treguesve të punësimit dhe papunësisë

Treguesi		2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës	Burra	63.5	64.3	65.0	66.8	67.6	68.0	66.9	67.2
	Gra	44.4	47.2	49.9	49.8	51.4	53.0	52.3	52.6
Shkalla e punësimit	Burra	51.4	53.3	54.7	57.1	59.0	60.1	59.2	59.5
	Gra	37.6	39.2	42.8	43.5	45.3	46.9	46.1	46.4
Shkalla e papunësisë	Burra	19.2	17.1	15.9	14.6	12.7	11.6	11.5	11.3
	Gra	15.2	17.1	14.4	12.6	11.9	11.4	11.9	11.8
Përqindja e të papunëve afatgjatë	Burra	61.0	65.8	64.9	63.3	65.6	63.1	59.7	60.5
	Gra	70.1	66.2	68.2	67.1	69.8	63.7	59.1	65.5
Shkalla e papunësisë afatgjatë	Burra	11.7	11.2	10.3	9.2	8.3	7.3	6.9	6.9
	Gra	10.7	11.3	9.8	8.4	8.3	7.3	7.1	7.7
Shkalla e inaktivitetit	Burra	36.5	35.7	35.0	33.2	32.4	32.0	33.1	32.8
	Gra	55.6	52.8	50.1	50.2	48.6	47.0	47.7	47.4

NEET	Burra	31.8	29.4	27.5	25.6	24.7	24.3	25.8	23.2
	Gra	37.3	36.6	32.9	34.4	32.7	28.9	30.0	29.1


*Burimi: Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësi*

Pavarësisht përpjekjeve të viteve të fundit për aktivizimin e grave, ende mbetet shumë për t'u bërë drejt barazisë gjinore në punësim. Meqenëse punësimi është i lidhur ngushtë edhe me faktorë të tjerë të rëndësishëm si hendeuku gjinor, puna e papaguar, kontributi në familje etj., është e nevojshme që kjo problematikë të vazhdojë të adresohet në të ardhmen.

**Shkalla e punësimit në Shqipëri është në përmirësim, por duhen adresuar problematikat në grupet e cënueshme.** Gjatë vitit 2021, shkalla e punësimit në vend arriti në 60.9 për qind, paksa nën nivelin e periudhës para pandemisë (61.2 për qind). Por ky tregues është më i ulët se në vendet e Bashkimit Europian (69 për qind gjatë 2021). Ky tregues rezulton më i ulët për gratë në Shqipëri (53.8 për qind në 2021) dhe shumë më i ulët për të rinjtë (15-24 vjeç), tek të cilët shkalla e punësimit në 2021 ishte vetëm 26.4 për qind ose, e thënë ndryshe, vetëm 1 ndër 4 të rinj është i punësuar në vend. Për shkak të problematikës komplekse ekonomike dhe sociale në vend dhe përcaktimit të statusit të papunë, në mjaft raste, shkalla e punësimit pasqyron më mirë situatën në tregun e punës, krahasuar me treguesit e tjerë, si shkalla e papunësisë.

**Rritja ekonomike dhe e punësimit në vitet e fundit mbështetet gjerësisht në zhvillimin e sektorit privat.** Të dhënat tregojnë se gjatë dekadës së fundit 2012-2021 numri i ndërmarrjeve aktive në vend, përfshirë fermerët, është rritur me 74 për qind duke arritur në 181,549 në fund të vitit 2021 (INSTAT, Regjistrat e Biznesit, 2022). Për të njëjtën periudhë numri i ndërmarrjeve të mesme (10-49 punëtorë) është rritur me 76 për qind duke arritur në 6,862, ndërkohë që numri i ndërmarrjeve të mëdha, të cilat punësojnë mbi 50 persona, është mbidryfishuar duke arritur në 1,959 të tilla në fund të vitit 2021, krahasuar me 956 ndërmarrje të mëdha aktive në vitin 2012. Të dhënat administrative të tregut të punës tregojnë se zhvillimi i sektorit privat, shoqëruar me formalizimin e tregut, është pasqyruar edhe në tregun e punës, në të cilin numri i kontribuesve në pagesën e sigurimeve shoqërore, ku sektori privat përbën rreth 74 për qind të tij, është rritur mesatarisht me 5.6 për qind në vit gjatë viteve të fundit, duke arritur në mbi 703 mijë kontribues në vitin 2021, krahasuar me 482 mijë të tillë në vitin 2014.

Figura 31 - Të punësuar kontribues dhe ndërmarrjet aktive në Shqipëri 2014-2021



Burimi: INSTAT: Databaza Statistikore - Tregu i punës dhe Regjistrat e biznesit

Shqipëria po përballet me dy sfida lidhur me aftësitë. Së pari, është niveli i ulët i aftësive të popullsisë në moshë pune. Sipas Anketës së Forcave të Punës (AFP) të vitit 2021, 41,6% e forcave të punës dhe 48.3% e popullsisë në moshë pune në Shqipëri është me arsim bazë (8-/9-vjeçar) ose më të ulët.

Sfida e dytë lidhet me zotërimin nga fuqia punëtore të aftësive të kërkuara në tregun e punës, mungesa e të cilave mund të pengojë krijimin e më shumë vendeve të punës apo me cilësi më të mirë. Disa nga treguesit kryesorë të mospërputhjen së mundshme të aftësive mund të konsiderohen shkalla e lartë e papunësisë tek të rinjtë dhe shkalla e lartë e papunësisë së të diplomuarve nga arsimi i lartë. Shkalla e papunësisë së të rinjve është 27.1% që është më shumë se dyfishi i shkallës së përgjithshme të papunësisë (11.5% në 2021). Shkalla e papunësisë dhe shkalla e papunësisë afatgjatë e të diplomuarve nga arsimi i lartë (10.5% dhe 6.9%) është thajse e barabartë me shkallën e papunësisë së personave me arsim bazë (10.6% dhe 6.4%). Fakti që shkalla e papunësisë së të rinjve me arsim të lartë, është më e lartë se te të rinjtë me arsim të mesëm reflekton një mospërputhje të rezultateve të arsimit të lartë me kërkesat e tregut të punës.

Shkalla e lartë e të rinjve që nuk janë as në punësim, as në arsim apo trajnim (NEET) është një tjetër tregues që nxjerr në pah mospërputhjen e aftësive. Në vitin 2021, të rinjtë e moshës 15-29 vjeç të kategorisë NEET përbëjnë 26.1 % të të gjithë popullsisë rinore. Në këtë grup, 37.3 % janë të papunë. Pjesa tjetër është jashtë forcës së punës, ose sepse janë punëtorë të dekurajuar (15.4 %), ose ngaqë përmbushin përgjegjësitë shtëpiake dhe familjare (17.5 %), ose për arsye të tjera (29.8 %). Përqindja e bizneseve, që përballen me vështirësi në rekrutim mund të konsiderohet gjithashtu si tregues për mospërputhjen apo mungesën e aftësive.

### *Paga minimale*

Në vitin 2022, paga minimale në vend është në vlerën 34,000 lekë, në vijim të disa rritjeve të njëpasnjëshme gjatë viteve të fundit. Vlera e pagës minimale duhet të reflektojë ndryshimet ekonomike, standardet e jetesës dhe rritjen e produktivitetit.

Raporti i pagës minimale nominale ligjore ndaj pagës mesatare në ekonomi, indeksi Kaitz, është rritur në vitet e fundit, i vlerësuar me rreth 0.59 ne 2021, nga 0.42 në 2017, i cili është më i lartë se mesatarja e vendeve Europiane (nga 0.33 deri në 0.48) Ky raport është akoma më i lartë në disa sektorë, si bujqësia, industria nxjerrëse, ndërtimi, tregëtia, ku nënraportimi në paga mund të jetë më i lartë se në sektorët e tjerë. E njëjta reflekton edhe ne grup profesioneve. Në këtë analizë mund të vihen re edhe hendeku gjinor në paga. Pagat e sektorit privat janë gjithashtu më të ulta se pagat mesatare dhe pagat e sektorit publik.

Krahasuar me vitin 2020, paga mesatare mujore bruto për një të punësuar në Shqipëri u rrit me 6,6 %. Hendeku gjinor në paga është 4,5 %. Pra meshkujt kanë një pagë mesatare mujore bruto 4,5 % më të lartë sesa femrat. Krahasuar me vitin e mëparshëm, në vitin 2021 vihet re një ulje e hendekut gjinor në paga me 2,0 pikë përqindje.

Gjatë vitit 2021, 32,7% e kontribuesve në kategorinë e të punësuarve me pagë marrin një pagë mesatare mujore bruto deri në nivelin e pagës minimale zyrtare. Për vitin 2021, paga minimale zyrtare është 30.000 lekë.

Tabela 29 - Pagesat mesatare sipas grup-profesioneve

Grup-profesionet (sipas ISCO-08 në nivel 2 shifror) – Instat, 2021	Paga mesatare			Indeksi Kaitz		
	Gjithsej	Burra	Gra	Gjithsej	Burra	Gra
<b>Gjithsej</b>	<b>57 191</b>	<b>58 413</b>	<b>55 760</b>	0,59	0,58	0,61
Ligjvënës, nëpunës të lartë të administratës shtetërore dhe drejtorë ekzekutivë	98 505	97 568	100 061	0,35	0,35	0,34
Specialistë me arsim të lartë (profesionistë)	76 879	85 136	72 303	0,44	0,40	0,47
Teknikë dhe specialistë në zbatim	64 604	67 108	61 740	0,53	0,51	0,55
Nëpunësit	59 633	61 267	58 316	0,57	0,55	0,58
Punonjës të shitjeve dhe të shërbimeve	43 466	48 331	37 066	0,78	0,70	0,92
Punonjës të kualifikuar të bujqësisë pyjeve dhe peshkimit	35 826	36 450	33 659	0,95	0,93	1,01
Zejtare, artizanë dhe profesione të lidhura me to	39 918	42 662	34 327	0,85	0,80	0,99
Punonjës të montimit dhe përdorimit të makinerive dhe pajisjeve	40 363	43 716	35 515	0,84	0,78	0,96
Punëtorë (Profesione elementare)	35 115	35 778	34 028	0,97	0,95	1,00
Forcat e armatosura	66 698	67 095	63 673	0,51	0,51	0,53

Partnerët socialë dhe Këshilli Kombëtar i Punës duhet të qëndrojnë proaktivë në vlerësimin e dinamikës së tregut të punës dhe të drejtojnë dialog të vazhdueshëm për përmirësimin e politikës së pagës minimale në Shqipëri.

### 3.2.5 Sipërmarrja dhe Inovacioni

Lidhur me Sipërmarrjen dhe Inovacionin, Shqipëria renditet e 76-ta, para Serbisë (104), Bosnja dhe Hercegovina (119), Malit të Zi (92), Kroacisë (99) dhe pas Greqisë (71). Shqipëria ka një pozicionim më të mirë lidhur me sofistikimin e teknikave (vendi 74) dhe më pak lidhur me inovacionin (vendi 87).

Inovacioni merr në konsideratë aftësinë për të sjellë risi, performancën e institucioneve që bëjnë kërkime shkencore, fondet që kompanitë vendase shpenzojnë në Kërkim dhe Zhvillim (R&D), bashkëpunimet me universitetet dhe industrinë, numrin e shkencëtarëve dhe inxhinierëve si dhe numrin e aplikimeve për patenta, marka etj. Për të nxitur më tej inovacionit dhe sipërmarrjen, në vitin 2023, Bashkia e Tiranës ka miratuar Strategjinë e Inovacionit dhe Digjitalizimit e cila e vendos theksin tek digjitalizimi i shërbimeve për qytetarët, digjitalizimi i proceseve të brendshme të punës dhe nxitja e inovacionit dhe sipërmarrjes tek të rinjtë.

## 3.3. Zhvillimi i Qëndrueshëm dhe Jetueshmëria

### 3.3.1 Hapësirat Publike

Hapësirat publike në Bashkinë e Tiranës luajnë një rol jetik në nxitjen e angazhimit të komunitetit dhe ofrimin e mundësive rekreative. Hapësirat publike janë territore, të destinuara për përdorim publik, ku me përdorim publik kuptohen disa lloje aktivitete. Hapësirat publike mund të jenë si prona publike dhe prona private, të destinuara për përdorim publik. Bashkia i ka vënë theks të rëndësishëm zhvillimit dhe rivitalizimit të hapësirave publike për të krijuar mjedise urbane të gjalla, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme.

Përgjatë viteve të fundit Bashkia e Tiranës ka ndërhyre në rehabilitimin e shumë hapësirave publike duke i kthyer ato në atraksione për qytetarët dhe turistët, si sheshi Skënderbej, Piramida, Pazari i Ri, Kalaja e Tiranës, Bulevardi Zog I, Rruga Kont Urani, etj. Përpyekjet e rivitalizimit përfshinin heqjen e trafikut të automjeteve, shtimin e hapësirave të gjelbra, vendkalimeve për këmbësorë dhe instalimeve të artit publik. Gjithashtu, Bashkia Tiranë ka investuar në krijimin dhe zgjerimin e parqeve dhe zonave të gjelbra në të gjithë qytetin. Ato janë të pajisura me pajisje të tilla si stola, kënde lojërash, ambiente sportive dhe pedonale, duke u kujdesur për nevojat dhe interesat e ndryshme të komunitetit. Shembuj të dukshëm përfshijnë Parkun Rinia dhe Parkun e Madh të Tiranës “Kodrat e Liqenit”, të cilët janë bërë destinacione të njohura për familjet, vrapuesit dhe entuziastët e natyrës.

Hapësirat publike të Tiranës nuk kufizohen vetëm në parqe. Bashkia është fokusuar edhe në zhvillimin e shëtitoreve dhe zonave miqësore për këmbësorët. Bashkia e Tiranës njih rëndësinë e hapësirave publike në nxitjen e shprehjes kulturore dhe artistike. Sheshe të ndryshme shërbejnë si vende për



zhvillimin e eventeve kulturore, koncerteve, ekspozitave dhe festivaleve, duke bashkuar njerëz me prejardhje të ndryshme për të festuar artet dhe skenën kulturore të qytetit.

Brenda Bashkisë së Tiranës janë ngritur një numër i konsiderueshëm parqesh rekreative, ku në total numërohen 82 parqe. Këto parqe shërbejnë si oaze brenda qytetit, duke ofruar një sërë komoditetesh dhe aktivitete për banorët. Ndër këto parqe, 65 janë të pajisura me kënde lojërash, duke ofruar hapësira të sigurt dhe argëtuese për fëmijët për të eksploruar, luajtur dhe ndërvepruar me njëri-tjetrin.

Krahas këndeve të lojërave, bashkia ka dedikuar edhe 13 parqe të projektuara posaçërisht për aktivitete sportive. Këto terrene sportive i shërbejnë interesave të ndryshme sportive të komunitetit, duke ofruar lehtësira për aktivitete të tilla si futboll, basketboll, tenis dhe më shumë. Banorët kanë mundësinë të angazhohen në aktivitete të shëndetshme fizike, duke ushqyer talentet e tyre sportive dhe duke promovuar një mënyrë jetese aktive.

Duke ofruar një bollëk hapësirash publike të dizajnuara mirë, Bashkia e Tiranës kërkon të nxisë angazhimin e komunitetit, të promovojë stile jetese të shëndetshme dhe të ofrojë mundësi për relaksim dhe kohë të lirë. Këto parqe jo vetëm që kontribuojnë në mirëqenien fizike të banorëve, por gjithashtu shërbejnë si qendra jetike sociale, duke inkurajuar ndërveprimin, lidhjen dhe krijimin e lidhjeve të qëndrueshme brenda komunitetit.

Për të inkurajuar transportin aktiv dhe për të promovuar një qytet më të gjelbër, bashkia ka prioritet edhe zhvillimin e infrastrukturës së çiklizmit. Gjithsej, nën mbikqyrjen e Bashkisë së Tiranës, në periudhën kohore 2015-2022 janë ndërtuar 37,340 m korsi bicikletash. Investimi është parashikuar të vazhdojë pasi janë përcaktuar edhe 10 rrugë të tjera të cilat planifikohet të pajisen me korsi biçikletash përgjatë vitit 2023. Korsitë e dedikuara të biçikletave janë zbatuar për të lehtësuar opsionet e sigurt dhe të përshtatshme të çiklizmit për banorët, duke rritur më tej aksesin dhe përdorshmërinë e hapësirave publike.

Hapësirat publike territoriale janë:

Tabela 30 - Hapësira publike

Hapësirat e gjelbra	Hapësira të standartizuara
- parqet	- rrugët kryesore, dytësore
- lulishtet	- trotuaret
- hapësirat e gjelbra pranë blloqeve të banimit	- bulevardet
- fushat e futbollit	- sheshet
- fondi i bimësisë së lartë (pemët)	- korridoret
	- shëtitorët
	- varrezat
	- urat lidhëse - këmbesore

Hapësirat e hapura të institucioneve	Hapësirat publike ujore
- stacionet e autobusave, trenit	- Lumenjtë
- objektet fetare, kulturore	- Liqenet
- shkollat, universitetet	- Rezervuaret
- komplekset e argëtimit dhe ato sportive	
- stadiumet	
- tarracat e godinave	
- fasadat urbane	

### *Parqet dhe hapësirat e gjelbra në Tiranë*

Në strukturën përbërëse të qytetit dallohet qartë një ndarje midis pjesës veriore (e ndërtuar në mënyrë të dendur) dhe jugore të tij (ku janë vendosur përgjithësisht parqet dhe lulishtet). Të vendosura brenda qytetit ose në afërsi të tij, ato përbëjnë pikat më të vizituara nga qytetarët. Sipërfaqja kryesore e gjelbër dhe atraktive për banorët e kryeqytetit, është Parku i Tiranës i krijuar në vitet '60 me sipërfaqe 288 ha.

Sipërfaqe të tjera të gjelbëruara në Tiranë janë “Parku Rinia”, parku përballë Parlamentit, si edhe një sërë lulishtesh të shpërndara në brendësi të qytetit. Sot Tirana është zgjeruar shumë dhe në të përfshihen zona të gjelbra si: zona nën malin e Dajtit, zona e Selitës, e Saukut etj. Shumë sipërfaqe të gjelbra ndodhen brenda institucioneve të ndryshme që nga ministritë, spitalet, shkollat, kopshtet, çerdhet etj. Brenda tyre gjenden një numër shumë i madh drurësh, shkurresh e lulesh.

Në qytetin e Tiranës infrastruktura e gjelbër prej 7,089,686m<sup>2</sup> ndahet në:

- Parqe e lulishte të qytetit, 277,304 m<sup>2</sup> (
- Parqe periferike, 7,056,407m<sup>2</sup> (Parku i Madh i Tiranës, Varrezat e Dëshmorëve të Kombit, Kopshti Zoologjik)
- Sipërfaqe e gjelbëruar janë shtuar 48000 m<sup>2</sup> në vitin 2022.

Nga kjo sipërfaqe totale kanë kaluar me VKB në administrimin e Njësive Bashkiake 59,258 m<sup>2</sup>.

Për sa i përket sipërfaqeve të gjelbra të rehabilituara dhe që mirëmbahen nga APR sipërfaqet e gjelbra të rehabilituara gjithsej janë 292,816 m<sup>2</sup>, prej të cilave 171,043 m<sup>2</sup> janë rikonstruktuar plotësisht dhe pjesa tjetër është rikonstruktuar pjesërisht.

Sfida e BT-së mbetet evidentimi dhe kategorizimi i të gjithë hapësirave publike duke hartuar plane lokalizimi sipas destinacionit të përdorimit të kësaj hapësire për ti dhënë frymë qytetit.

### 3.3.2 Mjedisi, Ndryshimet Klimatike dhe Emergjencat Natyrore

Pozicioni gjeografik, klimaterik dhe pozicioni territorial e kanë vendosur Tiranën në listën e qyteteve të privilegjuar nga natyra. Vetë struktura edhe pozicionimi i qytetit është favorizues për përcëimin e gjelbërimit përreth tij në formën e parqeve dhe hapësirave të gjelbëruara masivisht.

Politikat mjedisore të BT-së parashikojnë përmirësimin e mjedisit dhe stimulimin e mundësive për të përmirësuar jetesën nëpërmjet shfrytëzimit më të mirë të burimeve natyrore, kulturore, shoqërore dhe historike për një zhvillim më të qëndrueshëm.

Në kuadër të mbrojtjes së mjedisit, Bashkia e Tiranës ka ndërmarrë një sërë masash duke filluar me hartimin e planeve të mbarështimit për të gjitha ekonomitë pyjore në territorin e saj, rehabilitimin e shtrateve të lumit të Tiranës dhe lumit të Lanës, etj.

Megjithatë, një ndër sfidat kryesore sa i përket mbrojtjes së mjedisit mbetet derdhja në lumin e Lanës e ujërave të ndotura.

### *Ndryshimet klimatike*

Tirana, 110 m mbi nivelin e detit, karakterizohet nga një klimë e ngrohtë dhe e butë. Stina e dimrit është më e lagësht sesa ajo e verës. Temperatura mesatare vjetore është 14.8°C dhe niveli i reshjeve mesatarisht 1,207 mm në vit. Muaji më i thatë është korriku, ku dhe niveli i reshjeve arrin në 35 mm. Sasia më e madhe e reshjeve bie në nëntor, me një mesatare prej 166 mm. Me një mesatare prej 23.8°C, korriku është muaji më i ngrohtë. Temperaturat mesatare më të ulëta në vit shfaqen në janar, rreth 6.3°C. Reshjet variojnë me 131 mm ndërmjet muajit më thatë dhe atij më të lagësht. Ndryshimi në temperaturë gjatë gjithë vitit është 17.5°C.

Edhe pse e shtrirë në zonën e Mesdheut e cila konsiderohet një ndër zonat me qëndrueshmëri klimatike më të lartë, Shqipëria mbetet një ndër vendet më të prekshme nga ndryshimet klimatike duke përfshirë dhe zonën e Tiranës stinët e së cilës bëhen çdo vit e më të paqëndrueshme. Me një relief fushor në pjesën urbane por e rrethuar nga malet e kodrat e zonave rurale, qyteti i Tiranës gjendet në një gropë ku nivelet e nxehtësisë rriten falë edhe përqendrimit të lartë të gazrave serë dhe mungesës së balancës mes urbanizimit dhe gjelbërimit. Zhvillimi jo i balancuar urban por edhe mungesa e investimeve në infrastrukturën dhe mjedisin rural sjellin një sërë problematikash mes të cilave:

- Reshje të dendura në periudhë të shkurtër të cilat dëmtojnë të mbjellat dhe shkaktojnë dëme ekonomike dhe sociale si në zonat urbane dhe në zonat rurale
- Thatësi të lartë gjatë sezonit veror duke duke rritur probabilitetin e zjarreve nëpër pyje e kullota
- Erozion dhe rrëshqitje dheu
- Dëmtime të infrastrukturave rrugore
- Ulje e biodiversitetit tokësor dhe ujqor për arsye të temperaturave të larta, niveleve më të ulëta të oksigjenit dhe rritjes së agjentëve ndotës
- Shtimi i sëmundjeve respiratore dhe psikike shkaktuar nga i nxehti dhe mungesa e oksigjenit në ajër
- Rritje e infeksioneve dhe virozave si pasojë e shtimit dhe jetëgjatësisë më të lartë të baktereve gjatë sezonit veror, etj.

Përmirësimet e Tiranës në infrastrukturën në nivel bashkiak demonstuan një progres të qëndrueshëm ndaj fenomeneve klimatike gjatë ngjarjeve të fundit të reshjeve të ashpra në fund të vitit 2017. Megjithatë, edhe pse qyteti mund të përballojë stuhitë e forta apo valët më ekstreme të nxehtësisë shoqëruar me periudhat e thatësirës, është e nevojshme të merren masat e duhura të cilat planifikohen për një periudhë më afatgjatë.

Përballë sfidave gjithmonë e më intensive të ndryshimeve klimatike, BT me mbështetjen financiare të BERZH hartoi gjatë vitit 2017 Planin e Veprimit “Qyteti i Gjelbër”(PVQGJ) për Tiranën miratuar me VKB në qershor 2018. Ky plan sektorial veprimi mbështetet dhe në planet e miratuara gjatë viteve të fundit nga BT për të qenë në të njëjtën linjë zhvillimi me to dhe ka evidentuar pesë fusha kryesore në drejtim të së cilave duhen kryer investime për përmirësimin e situatës mjedisore të cilat përfshijnë: (I) Lëvizshmërinë e qëndrueshme; (II) Eficiencën energjitime; (III) Hapësirat e gjelbra dhe biodiversitetin (IV) Menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve (V) Qëndrueshmëria dhe adaptimi ndaj ndryshimeve klimatike.

Bazuar në këto 5 fusha prioritare, PVQGJ ka përcaktuar një sërë masash konkrete prioritare dhe sekondare të bazuara në tregues realë dhe të përditësuar të cilët do i vijnë në ndihmë BT-së për përmbushjen e vizionit të saj për një kryeqytet të Gjelbër dhe me standarte mjedisore Evropiane.

Duke patur parasysh se Tirana është motori ekonomik i vendit, ajo është edhe një ndër kontribuuesit kryesorë të nivelit të gazrave serrë të Shqipërisë. Për këtë arsye ajo mbart një peshë të konsiderueshme për të ndihmuar Qeverinë Shqiptare në arritjen e objektivit të saj për reduktimin e nivelit të këtyre gazrave me 11.5% deri në vitin 2030 (Angazhim i marrë nga Qeveria Shqiptare në ‘Marrëveshjen e Parisit për Ndryshimet Klimaterike’, Viti 2016.). Ky plan veprimi do të ndihmojë BT në sigurimin e investimeve të nevojshme për projektet prioritare të infrastrukturës mjedisore dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit të qytetit dhe të qytetarëve. Megjithatë koordinimi i aksioneve të këtij plani me projektet e tjera të Bashkisë përpara fillimit të punimeve është shumë e rëndësishme për të siguruar përdorimin sa më eficient të fondeve të bashkisë dhe shmangien e investimeve të dyfishta duke siguruar një zhvillim të qëndrueshëm në të gjitha aspektet.


Së fund, në kuadër të parandalimit dhe reagimit ndaj fatkeqësive natyrore, Bashkia e Tiranës ka nisur punën për Vlerësimin e Riskut nga Fatkeqësitë Natyrore si edhe hartimin e Strategjisë për Zvogëlimin e Riskut nga këto fatkeqësi.

### 3.3.3 Siguria Publike

Përgjegjësitë e pushtetit lokal sa i përket sigurisë publike kufizohen në kontrollin e territorit, mbrojtjen e pronës publike, mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi si edhe, pjesërisht, në sigurinë rrugore.

Gjatë gjithë periudhës 2017-2022 nga analiza e treguesve të aksidenteve rrugore rezulton se çdo vit në krahasim më vitin paraardhës ka patur reduktim të numrit të aksidenteve rrugore. Reduktime të ndjeshme gjatë periudhës 2017-2022 ka patur edhe përsa i përket pasojave të ardhura nga aksidentet rrugore. Numri i aksidenteve rrugore të ndodhura gjatë periudhës 2017-2022 dhe pasojave të ardhura për qarkun e Tiranës, sipas viteve janë si më poshtë:

Figura 32 - Numri i aksidenteve rrugore për qarkun e Tiranës



Burimi: INSTAT

Përforcimi i zbatimit të ligjit në fushën e sigurisë rrugore ka luajtur rol të veçantë për të parandaluar sjelljet e shpeshta të rrezikshme të përdoruesve të rrugës. Përqëndrimi i përpjekjeve të strukturave të policisë rrugore për përforcimin e zbatimit të ligjit në veçanti në drejtim të parandalimit të shkeljeve të rregullave të qarkullimit rrugor në lidhje me shpejtësinë tej normave të lejuara, drejtimi i mjetit nën efektin e alkoolit dhe pa dëshmi aftësie, mos respektim i sinjalistikës rrugore dhe parakalimet e gabuara, ka ndikuar ndjeshëm në reduktimin e aksidenteve rrugore dhe të pasojave të ardhura.

**Policia Bashkiake** është organi ekzekutiv që ka për detyrë të kryejë funksione në shërbim të rendit, qetësisë dhe mbarëvajtjes së punëve publike brenda territorit të bashkisë, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe që nuk janë në kompetencë të autoriteteve të tjera shtetërore. Për vitin 2021 numri i gjobave gjithsej të vendosura është 347,703, ku 94.7% e përbëjnë gjobat për shkelje të qarkullimit rrugor dhe parkim të gabuar. Për vitin 2021 numri i gjobave të vendosura në total ka pësuar rritje me 23 % në krahasim me vitin 2020. Përgjatë vitit 2021, njësia me më shumë gjoba të marra në këtë periudhë është njësia administrative Nr.5 me rreth 9.6% ndaj totalit ndërsa Dajti/Njësia12 është njësia administrative në të cilën janë marrë më pak gjoba me 0.001% ndaj totalit. Për vitin 2022 në Bashkinë e Tiranës janë shënuar 293,340 gjoba, duke pësuar një ulje të konsiderueshme krahasuar me vitin 2021.

Një tjetër strukturë shumë e rëndësishme që lidhet me sigurinë publike të qytetit është edhe MZSH – Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpëtimi. Në 61 bashkitë në vend janë instaluar **70 stacione zjarrfikëse**, nga 38 që ishin në 2014, **me 1250 punonjës**. Ky numër u shtua gjatë periudhës së decentralizimit. Në vitin 2014 ky numër ishte 749 vetë. Në Shërbimin Zjarrfikës të bashkisë së Tiranës, me personel më tepër se çdo bashki, janë ngritur, trajnuar dhe kompletuar 3 ekiye specifike:

- 1 ekip për ndërhyrje në raste tërmetesh;
- 1 ekip për ndërhyrje në raste shpëtimi nga lartësitë apo thellësitë;
- 1 ekip për CBRN.

Për gjithë vitin 2020 janë evidentuar **9601 raste ndërhyrjesh**, ndër to 6696 janë ndërhyrje në raste zjarresh, pjesa tjetër janë ndërhyrje për shpëtim të jetës së njeriut, apo pronës.

Agjencia për Mbrojtjen e Konsumtorit është institucioni përgjegjës për mbrojtjen e hapësirës publike dhe pronës publike nga dëmtimet, zaptimet, ndërhyrjet apo ndotjet. Sipas të dhënave të publikuara, gjatë vitit 2021 janë gjobitur 168 individë apo subjekte për ndotje të hapësirës publike, 41 individë apo subjekte për dëmtim apo ndërhyrje në hapësirat publike si edhe 285 raste për vendosje posterash në hapësirat publike. Është e rëndësishme të theksohet se seritë kohore të të dhënave tregojnë që kemi një reduktim të gjobave apo akt-konstatimeve në këtë drejtim.

Inespktorati i Mbrojtjes së Territorit është institucioni përgjegjës për kontrollin e territorit, parandalimin e ndërtimeve pa leje dhe lirimimin e hapësirave publike.

Një prej risive më të mëdha në nivel vendor për fuqizimin e sigurisë publike janë Këshillat Vendorë të Sigurisë Publike (KVSP). Procesi i ngritjes së KVSP-ve në Shqipëri nuk është shoqëruar deri më tani me akte ligjore ose nënligjore akoma, por synohet që ky mekanizëm këshillues të bëhet funksional në vazhdimësi.

### 3.3.4 Turizmi

Shqipëria, për shkak të promovimit të vazhdueshëm në disa nga mediat më prestigjioze të Europës dhe më gjerë ka patur 2 vitet e fundit një rritje të ndjeshme të numrit të turistëve. Në vitin 2022 numri i shtetasve të huaj të cilët vizituan vendin tonë ishte 7,543,817, një shifër rekord kjo pasi rezultoi edhe më e lartë se viti 2019 i cili ka qenë viti më i mirë i turizmit për vendin tonë.

Të dhënat e fundit nga World Travel & Tourism Council (WTTC) për vitin 2021, vit në të cilin kjo industri ka gjeneruar në total 226,100 vende pune ose rreth 20% të punësimit total në Shqipëri. Nga ana tjetër, turizmi luan edhe një rol të rëndësishëm në stabilitetin makroekonomik të vendit. Duke qenë se Shqipëria është një vend me një bilanc tregtar negativ për arsye se importet janë shumë më të larta se sa eksportet, valuta e sjellë nga turistët e huaj përmirëson bilancin e pagesave duke zbutur kështu efektet e bilancit tregtar negativ.

#### *Turizmi në Tiranë*

Tirana është kthyer në një qendër atraksioni turistik nga shtetasit e huaj për shkak se në të mund ti gjesh lehtë dhe shpejtë pothuajse të gjitha format e turizmit, duke nisur nga ai kulturor, historik, duke vijuar te turizmi arkitekturor e kulinar, e më tej te turizmi malor dhe i aventurës.

Zyra e Informacionit Turistik (ZIT) pranë BT-së vizitohet çdo ditë nga turistë me prejardhje nga të 5 kontinentet për të marrë informacione të ndryshme mbi Tiranën (transportin, atraksionet e qytetit, restorantet, hotelet, hostelet, qendrat tregtare, mbi atraksionet rreth e qark qytetit por edhe për qytete të tjera karakteristike etj.). Duhet theksuar se numri i turistëve që paraqitet në tabelën e mëposhtme nuk është numri total i turistëve që vizitojnë Tiranën, por vetëm të atyre që vijnë në mënyrë individuale dhe të paorganizuar në Tiranë e që kërkojnë informacion nga ZIT.

Europa është burimi kryesor i turistëve që vizitojnë Shqipërinë, duke zënë një volum prej rreth 91 % të të gjithë turistëve, çka reflekton se aksesin nën 3 orë nga një destinacion në tjetrin është ende faktor i rëndësishëm për fluksin e udhëtarëve për qëllime turizmi. Megjithatë së fundmi turistë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kina apo vende të tjera të Azisë dhe Lindjes së Mesme, kanë shënuar një interes domethënës rritës, duke inkurajuar kështu indirekt zhvillimin e segmenteve të turizmit, sidomos turizmin historik dhe atë kulturor.

Tabela 1 - Numri i turistëve sipas vendeve të origjinës

Turistë sipas origjinës	Zyra e Informacionit Turistik	
	2021	2022*
Evropë	2652	1292
Azi	96	40
Amerikë	159	86
Afrikë	49	-
Australi	5	-

\*Të dhëna gjysmëfinale

### 3.3.5 Kultura dhe Sportet

*Kultura* ka marrë një vëmendje të veçantë nga BT përgjatë viteve të fundit duke e pasuruar në mënyrë të ndjeshme jetën kulturore çka e ka shndërruar Tiranën në një destinacion kulturor rajonal. Eventet e organizuara me disa nga artistët më të famshëm botërorë kanë bërë që Tirana të renditet në të njëjtin nivel me kryeqytetet më të mëdha europiane, çka sigurisht ka patur ndikimin e vet edhe në tërheqjen e turistëve të huaj.

Tirana ofron gjithmonë e më shumë një program të pasur me aktivitete artistike dhe kulturore me karakter lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar, të cilat po kthehen në traditë si p.sh: Bialja e Tiranës, Panairi i Librit, Artfest, Festivali Ndërkombëtar i Filmit, Nata e Bardhë, Peza n' Fest etj. Këto aktivitete kanë patur impakt të madh në jetën artistike e kulturore të Tiranës. Në vazhdim BT synon të nxisë më tej festivalet e reja të qytetit si ai Evropian i Filmit, Festivali Ndërkombëtar i Bandave Frymore Muzikore, Festivali Ndërkombëtar i Kulturës së Regjioneve, Festivali i Teatrit të Rrugës, Salloni i Librit Ballkanik etj të cilat panifikohen të zhvillohen si në zonat urbane dhe në ato rurale.

Objektet kryesore kulturore të Tiranës si **Muzeu Historik Kombëtar, Galeria Kombëtare të Arteve, Pallati i Koncerteve, Biblioteka Kombëtare, Mozaiku i Tiranës, Shtëpia me Gjethe**, etj si dhe shumë institucione të tjera të kulturës, historisë dhe artit kombëtar tërheqin çdo vit një numër të madh vizitorësh vendas dhe të huaj. Sot në Tiranë numërohen pesë teatre, ndër të cilët 1 teatër kukullash, cirku kombëtar (i vetmi në Shqipëri), 7 Kinema ku disa prej tyre kanë më shumë se 1 sallë, 9 muze dhe 2 galeri artesh. Gjithashtu kryeqyteti ka edhe disa qendra kulturore të rëndësishme si Qendra Kulturore “Tirana”, Qendra Kombëtare e Kulturës për fëmijë, Qendra Kulturore “Tulla”, Qendra e Realizimit të Veprave të Artit, Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore, Qendra Kombëtare e Veprimtarive Folklorike etj. Tirana ka gjithashtu rreth 30 Biblioteka publike dhe universitare. Ndër më kryesoret mund të përmendim Bibliotekën Kombëtare, Biblioteka e Akademisë

së Shkencave dhe ajo e Fakultetit të Shkencave të natyrës, Biblioteka e Universitetit Bujqësor të Tiranës etj.

Ndër atraksionet e reja turistike në qytet do të jetë edhe **“Shtëpia Agolli”**. E ndodhur në të njëjtin pallat me shtëpinë Kadare, së shpejti edhe “Shtëpia Agolli” do të jetë një pikë e rëndësishme për vizitorë vendas dhe të huaj. Përpyekje të tjera në ruajtjen dhe trashëgimin kulturore po bëhen edhe për **Shtëpinë e Libohovitëve**, që do të kthehet në muzeun “Besa” për të kujtuar mbrojtjen e hebrenjve dhe mikpritjen e tyre në shtëpitë e shqiptarëve.

**Instalacioni REJA** dhe Festivali i Resë janë pikat kryesore të përvitshme, me mbi 600 aktivitete dhe duke tërhequr 15,000 pjesëmarrës çdo vit. Dhe për të pasuruar më tej panoramën kulturore të qytetit, bashkia themeloi Galerinë e Arteve të Tiranës, e cila ka organizuar tashmë 50 ekspozita dhe aktivitete, duke tërhequr më shumë se 8,000 të pranishëm vetëm në vitin e saj të parë.

Tirana ka shumë vlera kulturore dhe mjaft burime akoma të pa shfrytëzuara me të cilat mund të krijohen projekte interesante apo vepra tërheqëse dhe të vizitueshme për të promovuar dhe zhvilluar kujtesën e qytetit. Duke konsideruar një hark kohor 5-10 vjeçar, Tirana ka potencial për të zhvilluar edhe institucione të tjera kulturore si: **Muzeu Etnografik** ku mund të pasqyrohen vlerat historike dhe kultura popullore e zonës së Tiranës; **Galeria e Arteve të qytetit** me karakter lokal nën vartësinë e BT-së, **Galeria e Artistëve të Vegjël** ku mund të ekspozohen vetëm punimet e fëmijëve dhe të rinjve nën 18 vjeç, etj.

### *Sportet*

Tirana është shpallur “Qyteti European i Sportit” për vitin 2023. Bashkia e Tiranës do të administrojë titullin, që synon të sjellë masivizim të sporteve, por edhe t’i shërbejë promovimit të qytetit. Si Qyteti European i Rinisë, ashtu si për ringritjen e infrastrukturës arsimore brenda dy viteve, Bashkia Tiranë është përkushtuar edhe ndaj investimeve në fushën e sportit. Krahas Pallatit të Sportit “Asllan Rusi”, qyteti i Tiranës ka edhe një pol të dytë elitare si ai i **Parkut Olimpik** për zhvillimin e lojërave profesionale, i cili pret 1350 spektatorë. Investime janë planifikuar të bëhen jo vetëm në sportin elitare por edhe në atë komunitar, për të promovuar një stil jetese më të shëndetshëm. Ndër projektet kryesore të mandatit të ri të kryetarit të bashkisë lidhur me fushën e sportit mund të përmendim “Asllan Rusin”, “Selman Stermasin” dhe kompleksin “Dajti” të cilat planifikohen të bëhen nga e para me ambiente dhe kapacitete të përmirësuara dhe të zgjeruara.

Ndër investimet kryesore dhe më të rëndësishme të Bashkisë Tiranë në kuadër të zhvillimeve në sport është **Parku Olimpik**. Parku Olimpik është një kompleks modern që mbledh bashkë të gjitha strukturat zinxhir të sportit, federatat, peshëngritjen, mundjen, atletikën si dhe lojërat me dorë. Bashkia është angazhuar gjithashtu edhe në ndërtimin e **45 këndeve të reja rekreative dhe sportive** dhe 9 kënde të forces tek parku i Liqenit. Janë organizuar gjithashtu edhe mbi **2000 aktivitete rekreative** dhe 6 kampionate periodike sportive çdo vit.

Një tjetër aktivitet i rëndësishëm i zhvilluar nga BT është edhe **Maratona e Tiranës**, e cila organizohet për të shtatin vit radhazi, me mbi 3000 pjesëmarrës dhe 350 të huaj nga 50 vende të ndryshme të botës.

### 3.3.6 Qeverisja e mirë dhe Transparenca



Udhërrëfytyesi për Mirëqeverisjen dhe Administrimin Publik 2030 përbën dokumentin strategjik kryesor që orienton thelbësisht menaxhimin cilësor të kornizës së përbashkët të vlerësimit, administratën publike dhe financat publike, shërbimet publike, dixhitalizimin, antikorrupsionin dhe decentralizimin. Me qëllim zbatimin efektiv të reformave të Mirëqeverisjes dhe përmbushjen e kërkesave lidhur me negociatat dhe procesin e integritimit evropian, Udhërrëfytyesi 2030 për Mirëqeverisjen dhe Administrimin publik, është bazë në orientimin e reformave për një qeverisje të mirë, si gur themeli për funksionimin e administratës shtetërore, për të ofruar menaxhim cilësor në përmbushje të performancës drejt një kornize të përbashkët vlerësimi, shërbime publike me standarde, me qëllim nxitjen e një rritje ekonomike solide, të qëndrueshme dhe të përshpejtuar, si dhe nxitjen e konvergencës sociale.

Transparenca dhe llogaridhënia janë të lidhura me njëra-tjetrën, ku transparenca e autoriteteve të qeverisjes vendore përfaqëson një hap të parë drejt llogaridhënies së të zgjedhurve vendorë dhe ndërtimit të besimit me komunitetin. Detyrimet ligjore që rrjedhin nga Ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, dhe Ligji Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” u garantojnë qytetarëve akses në qeverisje dhe kushtet e duhura për të ushtruar të drejtat e tyre qytetare. Nëpërmjet Modelit të Programit të Transparencës për Njësitë e Qeverisjes Vendore, Bashkia Tiranë vendos në dispozicion të qytetarëve një kategori të gjerë informacionesh, mënyrat dhe afatet e publikimit të tyre si dhe procedurat për të aksesuar e përdorur ato.

Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik, parashikohet nga dy ligje dhe një Vendim i Këshillit të Ministrave. Konkretisht, ligji 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe VKM Nr. 828, datë 7.10.2015, “Për Miratimin e Rregullave të Krijimit dhe Administrimit të Regjistrimit Elektronik për njoftimet dhe Konsultimet Publike.” Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik sipas ligjit ka një rol të rëndësishëm dhe detyra të përcaktuara qartë në procesin realizimit të njoftimeve dhe konsultimeve publike. Për njoftimin e qytetarëve në lidhje me çështje të ndryshme Bashkia Tiranë duket se përdor një tërësi formash në mënyrë që informacioni të shkojë tek çdo target grup. Vërehet se format më të përdorura janë lajmërimet e afishuara në ambjentet e bashkisë apo/dhe Njësive Administrative, si dhe në mediat sociale, web, takimet dhe dëgjuesat. <https://tirana.al/kategori/konsultimi-publik> është një prej vegëzave të faqes web të bashkisë Tiranë e cila ofron informacion sa i përket konsultimit publik dhe angazhimit të qytetarëve.

Ndërkohë që përvec sa më sipër, bashkia Tiranë operon edhe me Onestop shop "One-StopShop" (OSS) përfaqëson çdo zyrë ku qytetarët dhe/ose bizneset mund të aplikojnë për të përfituar një shërbim të caktuar. Modeli OSS është zgjeruar në mënyrë progresive në shumë sektorë të ndryshëm dhe mundëson portën e vetme për të gjithë ndërveprimin midis qytetarëve/ bizneseve dhe Administratës Publike. Një zyrë ndodhet pranë bashkisë dhe muajt e fundit janë shtuar edhe tre zyra të tilla në njësitë administrative nr. 3;8;10 si edhe pritet të finalizohet hapja e dy të tjerave në Farkë e Kashar, duke e lehtësuar edhe më shumë menaxhimin e informacionit dhe shërbimeve për qytetarët. Momentalisht ky aplikacion përdoret vetëm për punonjësit e bashkisë për të parë ecurinë e zgjidhjes së një kërkesë apo të ngjashme. Sipas zyrtarëve të bashkisë Tiranë, perspektiva e ardhshme është që qytetarët të kenë vetë akses në këtë portal dhe të gjurmojnë ecurinë dhe statusin e kërkesës së tyre.

Nga ndryshimet e fundit prej 1 majit të vitit 2022, mbi 95% e shërbimeve publike të ofruara nga shteti janë ofruar online në 'E-Albania', me qëllim mënjanimin e sporteleve në të gjithë Shqipërinë. Nga të

dhënat e mbledhura, rezulton se kjo bashki ka bërë një ndarje të sporteve fizike sipas njësive administrative, por në çdo rast, zyra e informacionit do të shërbejë për ofrimin e informacionit dhe udhëzimeve për qytetarët.

Sipas monitorimeve edhe aplikacioni <https://opendata.tirana.al/> është një filozofi që mbështet shpërndarjen dhe publikimin e lirë të të dhënave pa kufizime ligjore, patenta apo mekanizma të tjerë kontrolli që bashkia Tiranë përdor. Sipas të dhënave publike, Tiranë u bë qyteti i parë në Shqipëri, prej prillit 2017, me një bazë të dhënash për punët publike dhe shërbimet që ofron Bashkia e Tiranës, në funksion të rritjes së transparencës ndaj qytetarëve, por edhe menaxhimit më të mirë të kohës dhe parave të taksapaguesve. Bashkia e Tiranës, ka publikuar online portalin “opendata.tirana.al”, i cili rrit transparencën dhe u ofron qytetarëve të dhëna të ndryshme për punët, investimet dhe çdo shërbim që kryhet në qytet. Programi vlerësohet si një hap drejt përmirësimit të shërbimit ndaj qytetarëve me një kosto më të ulët dhe rritjes së transparencës për aktivitetin që kryen Bashkia e Tiranës.

### 3.4. Shërbimet Sociale

#### 3.4.1 Strehimi

Bashkia e Tiranës ka hartuar programin 5 - vjeçar të strehimit social 2022-2027 në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Hartimi i këtij programi është kusht kryesor për përfitimin e fondeve nga Qeveria Qendrore në lidhje me gjashtë programet aktualisht të përcaktuara në ligjin për strehimin social.

Situata e strehimit në Tiranë është e lidhur ngushtë me dinamikën e popullsisë dhe të ndërtimit. Kështu, popullsia është rritur gradualisht ndër vite, me rreth 32,000 familje nga 2016 në 2022. Ndërkohë që shtesa natyrore është në rënie të vazhdueshme, rritja e popullsisë i dedikohet shtesës mekanike, pra të ardhurave nga qytetet e tjera në Tiranë. Bilanci i lëvizjeve brenda territorit të bashkisë është pozitiv që prej vitit 2010, por sipas *opendata.tirana.al* ka një tendencë rënëse nga 2017 në 2022. Po ashtu, në rritje në Tiranë ka qenë edhe numri i lejeve të ndërtimit dhe sipërfaqja e ndërtuar, ku gjithmonë ka mbizotëruar banimi. Sipas INSTAT, për të dhënat nga viti 2017 deri në 2022, bashkia e Tiranës ka miratuar leje ndërtimi për **1,646** ndërtesa të reja me një sipërfaqe 6,344,000 m<sup>2</sup>, nga të cilat rreth 76% kanë qenë ndërtesa për banim. (Figura 1)




Figura 33 - Nr. i lejeve të dhëna për banesa të reja si % ndaj totalit

Paralelisht me rritjen e ndërtimeve në Tiranë është rritur edhe kërkesa për strehim social dhe kjo ka të bëjë sa me kompleksitetin e strukturës sociale të familjeve dhe grupeve në nevojë, po aq edhe me tregun jo të përbalueshëm nga popullsia në rritje. Edhe pse bashkia e Tiranës është në pozitat më të favorshme të mundshme krahasuar me bashkitë e tjera sa i përket buxhetit për strehimin social, ajo përballet me kërkesën më të lartë. Për të adresuar sfidën e strehimit social nevojitet bashkëpunimi mes aktorëve publikë e privatë dhe midis nivelit vendor e qendror të qeverisjes.

Bashkia Tiranë për çështje sociale dhe të strehimit në pesë vitet e fundit ka shpenzuar mesatarisht 2,750,945,213.50 Lekë në vit (nga të gjitha burimet), nga të cilat, deri në vitin 2019 vetëm ¼ e buxhetit është përdorur për strehim social dhe urbanistikë, pjesa më e madhe është përdorur për programin e kujdesit social (Bashkia Tiranë 2021). Ndërkohë buxheti i parashikuar për vitin 2023 për Programin e Strehimit Social është 1,686,847,184 ALL.

Aktualisht, në Shqipëri, sipas ligjit nr. 22/2018, 'Për strehimin social' dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, mund të aplikohen 6 programe strehimi, përkatësisht:

- programi i banesave sociale me qira;
- programi për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese, deri në një ndërtim të ri;
- programi i banesave me kosto të ulët;
- programi për zhvillimin e zonës me qëllim strehimi;
- programi për krijimin e banesave të përkohshme;
- programi i banesave të specializuara.

Tabela 31 - Karakteristikat Kryesore të Programeve të Strehimit Social

Programi	Karakteristika
Programi i banesave sociale me qira	Programi, me anë të të cilit jepen me qira banesat në pronësi publike nga fondi publik i banesave sociale, si dhe banesat që janë në pronësi të pronarit social.

	Programi mbështetet nga mekanizmi i subvencionit të qirasë.
Programi për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese, deri në një ndërtim të ri	Ndihma që u jepet njërive të vetëqeverisjes vendore nga buxheti i shtetit, për të përshtatur objekte për strehim ose për të përmirësuar kushtet e banesave ekzistuese publike ose private, deri në një ndërtim të ri.
Programi i banesave me kosto të ulët	Banesë me kosto të ulët (BKU) konsiderohet banesa që plotëson të gjitha kushtet teknike, standardet e ndërtimit dhe normat e strehimit në fuqi, që është e paracaktuar për t'u disponuar në pronësi nga përfituesi, nëpërmjet formave të ndryshme të lehtësimit nga institucionet shtetërore.
Programi për zhvillimin e zonës me qëllim strehimi	Zhvillimi i zonës me qëllim strehimit bëhet për ndërtimin e banesave sociale, në bazë të dokumenteve të planifikimit qendror e vendor, dhe përfshin hartimin dhe miratimin e projektit të ndërtimit, deri në përfundimin e tij.
Programi për krijimin e banesave të përkohshme;	Programi parashikon sigurimin e strehëve të përkohshme, që janë objekte ose pajisje që montohen dhe çmontohen lehtë dhe që shërbejnë për strehim të përkohshëm, me afat deri në dy vjet.
Programi i banesave të specializuara.	Banesat e specializuara janë banesat në të cilat njësitë e vetëqeverisjes vendore adresojnë një nevojë specifike strehimi për grupe të vecanta.

## 1. Programi i Banesave Sociale me qira

Ky program u aktivizua në vitin 2016. Për këtë program, për periudhën 2015-2017 kanë aplikuar 2,435 aplikues dhe kanë përfituar 418 familje. Gjatë vitit 2017 aplikuan 1,187 familje (*Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Territorit dhe Burimeve Njerëzore, 2018*). Aktualisht Bashkia Tiranë nuk ka fond banesash sociale me qira të mjaftueshëm për të përballuar numrin e lartë të aplikantëve (Bashkia Tiranë, 2017). Pavarësisht se nuk është zbatuar më, aplikimet për këtë program janë mbyllur në Qeshor të 2018.




Figura 34 - Banesat Sociale me qira, Bashkia Tiranë, Shkozë

Aplikuesit dhe Përfituesit e Banesave Sociale me qira sipas kategorive për vitet 2015-2018 janë të përmbledhura në tabelën më poshtë:

Tabela 32 - Nr. aplikuesve dhe përfituesve të programit "Banesë Sociale me qira" (2015-2018)

Programi		2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Banesë sociale me qira	Aplikues	337	500	1,187	411	-	-	-
	Përfitues	242	176	-	-	-	-	-

## 2. Programi i Banesave me Kosto të Ulët

Programi i BKU është mjaft i përshtatshëm për akomodimin e shtresave të mesme të popullsisë, të cilat kanë problematika sociale: gratë e divorcuara, familjet me mbi 4 fëmijë, disa kategori PAK, etj. Ky program mund të aplikohet duke ofruar truall të pajisur me infrastrukturë nga bashkia, ose duke përshtatur ndërtesa të qëllimeve të tjera, apo të degraduara. Për këtë program për periudhën 2005 – 2017 kanë aplikuar 9,993 qytetarë dhe në vitin 2018 pati vetëm 18 aplikues (Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Territorit dhe Burimeve Njerëzore, 2018). Në tabelën e mëposhte paraqiten aplikuesit dhe përfituesit për këtë program strehimi për periudhën 2015-2020. Siç dallohet qartë, pavarësisht se gjatë viteve ka pasur aplikime për BKU, nuk ka pasur përfitues.

Tabela 33 - Aplikuesit dhe Përfituesit për Programin e Banesave me Kosto të Ulët 2015-2020

Programi		2015	2016	2017	2018	2019	2020
Banesë me kosto të ulët	Aplikues	208	588	441	18	-	-
	Përfitues	-	-	-	-	-	-
Tokë e pajisur me infrastrukturë	Aplikues	-	-	120	-	-	-
	Përfitues	-	-	-	-	-	-

Burimi: [opendata.tirana.al](http://opendata.tirana.al)

Për të aplikur në mënyrë të qëndrueshme një program të tillë, si fillim, është e nevojshme identifikimi dhe analizimi i aseteve truall të bashkisë, si zonat ish-industriale, të cilat mund të konvertohen në fond banesash. Shitja e këtyre banesave do të bëhet gjithmonë duke u krahasuar me çmimin e shitjes së banesave në treg për të bërë një bilanc real të variantit më efektiv. Lidhur me këtë variant bashkëpunimi i Bashkisë me Ministrinë e linjës do të jetë efektiv për subvecionimin me interes të kredisë nga ana e qytetarëve me qëllim lehtësimin e blerjes. Këtu nga ana e Bashkisë do parashikohet ajo kategori personash të cilët mund ta përballojnë marrjen e kredisë edhe sipas kushteve të bankave të nivelit të dytë.

## 3. Programi për Përmirësimin e Kushteve të Banesave Ekzistuese, deri në ndërtim të ri.

Edhe në rastin e programit të përmirësimit të kushteve të banesave ekzistuese, deri në një ndërtim të ri, është i rëndësishëm identifikimi i aseteve të bashkisë dhe të banesave jofunksionale në pronësi për t'u përdorur për këtë qëllim. Projektimi i banesave të reja me funksion banimin duhet të kryhen në përputhje me parashikimet e zyrës së urbanistikës, planit të përgjithshëm vendor, vlerësimit të nevojave për strehim, etj.

Në varësi të rastit, bashkia mund të aplikojë 2 forma financimi të programit:

- Aplikim nëpërmjet një zhvilluesi, duke ofruar truallin dhe një kosto të dakordësuar për m<sup>2</sup>, të miratuar në Këshill Bashkiak.
- Aplikim nëpërmjet EKB-së

Nga ana tjetër, për ndërtesat në kushte të degraduara, bashkia mund të aplikojë në mënyrë periodike në Ministrinë e Linjës për grant të menjëhershëm. Aktualisht ky program nuk është zbatuar në territorin e Bashkisë Tiranë. Një program i tillë mund të jetë efikas në njësitë administrative rurale të bashkisë, sidomos në NjA Zall-Bastar, ku numri i banesave me probleme të theksuara strukturore dhe sanitare është mjaft i lartë në raport me totalin e ndërtesave. Vetëm nga të dhënat e Censurit 2011, 15,135 ndërtesa ose 23.8% e ndërtesave janë ndëtuara para vitit 1991 dhe 6,487 banesa kanë probleme sanitare.

#### **4. Programi për zhvillimin e zonës me qëllim strehimin**

Ky opsion është i mundshëm të kryhet në dy aspekte: duke shfrytëzuar asetet publike të bashkisë për të zhvilluar një ndërtim privat, me qëllim total ose të pjesëshëm strehimin social; ose duke zhvilluar PDV në mënyrë incentivuese për zhvilluesit, për të përfshirë banesa sociale në ndërtimet e reja.

Ky truall mund të shfrytëzohet nga bashkia në tre mënyra:

1 - Të aplikohet në thirrje nga EKB për ndërtim të BKU, duke akomoduar familje me të ardhura të ulëta, po jo në nevojë ekstreme.

2 - Të zbatohet skemë partneriteti me zhvilluesin për të përfituar një numër banesash sociale me qira. Programi i kredisë sociale në Partneritet Publik Privat (PPP) ka për qëllim që të shfrytëzojë kapacitetet e lira të apartamenteve të pa shitura të ndërtuesve privatë, të cilët mund ti ofrojnë ato për programin e banesave sociale me qira. Ndërtuesit privatë pritet të ofrojnë qira të arsyeshme për apartamente të pa shitura të vendosura kryesisht në zonat periferike të qytetit. Vlera e qirasë sociale do të përballohet pjesërisht nga familjet aplikuese dhe pjesërisht nga Bashkia. Nëpërmjet kësaj politike bashkia do të mbështesë shtresat në nevojë me aftësi paguese të kufizuara (Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Territorit dhe Burimeve Njerëzore, 2018).

3 - Të hartohet një projekt për BSQ dhe të përfitohet financim nga Qeveria Qendrore.

#### **5. Programi për krijimin e banesave të përkohshme**

Programi i strehave të përkohshme jep një zgjidhje të menjëhershme dhe afatshkurtër ndaj faktorëve të paparashikueshëm që kanë impakte të kosiderueshme hapësinore, si fatkeqësitë natyrore, por edhe lëvizjet migratore të popullatës. Tërmeti i 26 Nëntorit 2019 dhe i Shtatorit të po të njëjtit vit, janë shembuj konkretë të paparashikueshmërisë dhe magnitudës së këtyre fenomeneve. Tërmeti në fjalë preku 2,866 familje (Bashkia Tiranë), vetëm në Bashkinë e Tiranës. Këto familje u trajtuan me programin e subvencionit të qirasë në vitin 2020 nga fondet e qeverisë qendrore me një shumë prej 589,462,000 Lekë (Ministria e Financave dhe Ekonomisë).

Grafikisht më poshtë paraqitet numri i familjeve të prekura nga tërmeti që kanë përfituar strehim.




Figura 35 - Familjet përfituese të prekura nga tërmeti në Bashkinë Tiranë sipas NjA-ve

## 6. Programi i banesave të specializuara.

Banesat e specializuara japin zgjidhje problemit të strehimit për grupe vulnerabel specifike. Sipas Censurit 2011, rreth 9.7% e njësisve ekonomike familjare të bashkisë, ose 14,616 familje, përbëhen vetëm nga pensionistë dhe 8.2% e NJEF-ve, ose 12,439 familje, përbëhen vetëm nga një anëtar. Gjatë vitit 2019, kanë përfituar nga ndihma ekonomike 382 të moshuar në institucionet e përkujdesjes.

Një ndër problematikat më të theksuara të bashkisë janë fëmijët e rrugës, numri ekzakt i të cilëve është i panjohur. Gjatë gjashtëmujorit të parë të 2020, kanë përfituar nga ndihma ekonomike 894 fëmijë me problematika të ndryshme. Gratë dhe vajzat e dhunuara janë një kategori e grupeve vulnerabel që pritet të pësojë rritje si pasojë e periudhës së karantinimit nga COVID-19. Aktualisht kanë përfituar nga ndihma ekonomike 502 gra në vitin 2019 dhe 94 në vitin 2020.

Tabela 34 - Përfituesit e NE/PAK gjatë 2019 dhe 2020 (6MI)

Kategoritë	2019	2020 (6M-1)
Fëmijë në risk	862	343
Fëmijë jetimë biologjikë	556	289
Fëmijët e rrugës	203	52
Fëmijë në varfëri	183	210
Të rinj në risk	30	0
Të rinj të shërbimit të provës	12	2
Gra vajza të dhunuara	502	94
Gra vajza viktime të trafikimit	10	5
Të moshuar në institucionet e përkujdesjes	382	0
Persona me aftësi të kufizuar	45,423	24,337

Dy nga programet e tjera që aplikon Bashkia Tiranë janë:

- Bonusi i Strehimit
- BKU – subvencioni i interesave të kredisë.

Bonusi i strehimit është një program që mbështet familjet që jetojnë në apartamente me qira të cilat nuk mund të përballojnë financiarisht qiranë e tregut. Vetëm për vitin 2021 kanë përfituar 341 familje, ndërsa kreditë e buta janë pjesë e programit të banesave me kosto të ulët sipas ligjit.

Tabela 35 - Aplikuesit dhe përfituesit e dy programeve të strehimit 2015 - 2021

Programet		2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Bonusi i strehimit	Aplikues	17	410	-	808	1,477	663	538
	Përfitues	-	317	232	294	312	309	341
Subvencionimi i interesave të kredisë (Faza 1)	Aplikues	-	-	2,438	2,814	-	2,250	2,581
	Përfitues	-	-	999	2,557	-	848	2,419
Subvencionimi i interesave të kredisë (Faza 2)	Aplikues	-	-	-	1,910	-	-	Në proces
	Përfitues	-	-	-	1,104	-	-	Në proces

Për skemat e subvencionit të interesave të kredisë për strehim, më 20 shkurt 2017 u miratua nga Këshilli Bashkiak vendimi për të ndihmuar kryesisht çiftet e reja me kredi të buta për blerjen e një shtëpie. Bashkia Tiranë merr përsipër të subvencionojë interesat e tregut bankar për rreth njëmijë kredi. Financimi i programit në buxhetin e vitit 2017 ishte 95 milionë lekë. Në korrik, Komisioni i Strehimit deklaroi 999 fitues, nga 2,438 aplikues (Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Territorit dhe Burimeve Njerëzore, 2018). Në vitin 2020 për këtë program regjistrohen 2,250 aplikues, nga të cilët vetëm 848 përfitojnë subvencionin e interesave të kredisë.

### Sfidat

Aktualisht, disa nga sfidat kryesore me të cilat hasset Bashkia Tiranë për përmbushjen e objektivave me çështjen e strehimit janë:

- Mungesa e akteve nënligjore në përputhje me ligjin 22/2018
- Problemet me pronën dhe mungesa e truallit publik për të ndërtuar banesa sociale
- Mungesa e informacionit statistikor nga tregu imobiliar dhe institucionet përkatëse
- Mungesa e minimumit jetik

INSTAT-i nuk disponon të dhëna se cilat janë të ardhurat mesatare dhe mungesa e këtij elementi pengon zbatimin e plotë të programeve sociale të strehimit. Në lidhje me zbatimin e ligjit të ri 22/2018 për “Strehimin Social”, është i rëndësishëm angazhimi i bashkisë për t’u kërkuar subjekteve private dorëzimin e 3% të sipërfaqes së ndërtimit, për rastet kur është mbi 2000 m<sup>2</sup>, sipërfaqe që do të shkojë në favor të programeve sociale të strehimit. Duke marrë parasysh se ky detyrim është një nga shtyllat kryesore ku do të bazohet kultivimi i banesave sociale, ndjekja dhe monitorimi i këtij procesi duhet të realizohet nga Drejtoria e Strehimit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, me qëllim që të krijohet një regjistër i veçantë në nivel kombëtar mbi këto prurje që do u shtohen banesave sociale.

### 3.4.2 Punësimi dhe Papunësia



INSTAT ka publikuar raportin me të dhënat e Tregut të Punës per vitin 2021 në të cilin forca e punës vlerësohet të jetë 1.411.308 persona, ku meshkujt përbëjnë 55,4 % të forcës së punës, ndërsa femrat 44,6 %. Të punësuar vlerësohen të jenë 1.248.749 persona, ku meshkujt përbëjnë 55,5 % të të punësuarve dhe femrat 44,5 %. Të papunë gjithsej vlerësohen të jenë 162.560 persona, ndër të cilët 54,5 % janë meshkuj dhe 45,5 % janë femra.

Sipas të dhënave të Zyrës së Punës janë 13,237 individë, banorë të Bashkisë Tiranë, që në janar 2021 rezultojnë të rregjistruar në Zyrën e Punës. Karakteristikat kryesore të punëkërkuësve të papunë janë:

- 54% nuk kanë arsim ose kanë arsim fillor dhe 9 vjeçar. 26% ka arsim të mesëm të përgjithshëm. Një përqindje më e ulët janë personat që kanë arsim profesional apo që kanë kryer studimet e larta (respektivisht 9% dhe 11%).
- 58% e punëkërkuësve të rregjistruar janë femra, ndërkohë që 19% e tyre janë kryefamiljare;
- Aktualisht, figurojnë 1,228 punëkërkuës të papunë njëkohësisht përfitues të NE, nga të cilët 224 gra kryefamiljare në NE (Rajoni Tiranë)
- 8% e punëkërkuësve janë romë dhe egjiptianë.
- Ka një nivel të ulët të rregjistrimit si punëkërkuës të papunë të personave me aftësi të kufizuara. Vetëm 0.5% e personave me aftësi të kufizuara të grupmoshës 18-64 vjeç janë të rregjistruar si punëkërkuës.

Tabela 36 - Shpërndarja e punëkërkuësve të papunë sipas karakteristikave 2021

Grupmosha	Total	Sipas gjinisë		Sipas statusit			
		Femra	Meshkuj	PAK	Romë/ Egjiptjane	Emigrate te kthyer	Gra kryefamiljare
16-19 vjeç	355	152	203	3	34	7	
20-24 vjeç	1014	527	487	14	76	11	
25-29 vjeç	1015	579	436	10	126	21	
30-39 vjeç	2557	1721	836	20	268	51	
40+	8296	4678	3618	45	553	151	
<b>Total</b>	<b>13,237</b>	<b>7,657</b>	<b>5,580</b>	<b>92</b>	<b>1,057</b>	<b>241</b>	<b>1,419</b>

56% e grupmoshës aktive për punë që përfiton ndihmë ekonomike është në kërkim të një pune. 2,732 individë të familjeve përfituese të NE rezultojnë të rregjistruar si punëkërkuës të papunë në Zyrat e Punës nga 4,861 individë në moshë pune në këto familje.

Bashkia nuk e ka detyrimin të bëjë një profilizim profesional të përfituesve të NE në moshë pune. Kjo është detyrë funksionale e Zyrave të Punës.




Figura 36 - Numri i punëkërkuessve sipas moshës

Referuar numrit të përgjithshëm të punëkërkuessve të regjistruar në Zyrën e Punës, 21% e tyre i përketin familjeve përfituese të ndihmës ekonomike. Përpara vitit 2021, Zyra e Punës nuk ka regjistruar të dhëna të detajuara për shpërndarjen e punëkërkuessve të papunë sipas njësive administrative, gjë që ka penguar thellimin në analizën e nevojave.

Prej muajit Prill 2021, po zbatohet sistemi i përmirësuar i shërbimeve të punësimit, i cili bën të mundur nxjerrjen e më shumë informacioneve për punëkërkuessit e papunë. Ky sistem i ri i Zyrës së Punës, mundëson kryqëzimin dhe verifikimin e informacioneve nga institucione të ndryshme (DPT, Gjendje Civile, etj.), si dhe i jep një rëndësi të posaçme elementit “distancë” në ndërmjetësimin për punësim. Procesi i ndërmjetësimin bazohet në 3 kriterë kyç: atë të profesionit aktual, profesionit të dëshiruar dhe preferencës së distancës, për të lidhur kërkesën me ofertën për punë.

Aktualisht, në Tiranë ka 3 zyra vendore të punës që mbulojnë NJA më të afërta gjeografikisht dhe 2 zyra të tjera për të mbuluar zonat periferike/rurale. Mbulimi i plotë dhe cilësor i zonave rurale mbetet sfida.

Në territorin e Bashkisë Tiranë janë gjithsej 1,228 punëkërkuess të papunë përfitues të NE të regjistruar në Zyrën e Punës, kryesisht në njësiti administrative 5, 6 dhe në njësinë Zall-Herr (përkatësisht, 10%, 12% dhe 10% e totalit).




Figura 37 - Punëkërkuessit e papunë përfitues të NE sipas njësive administrative, 2021

## 2. Punësimi

Pjesë e Drejtorisë së Përgjithshme së Shërbimeve Sociale në Bashkinë Tiranë është edhe Drejtoria e Nxitjes së Punësimit. Që prej vitit 2015 kjo Drejtori ka trajtuar me prioritet kategoritë në nevojë të referuara nga Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale duke synuar fuqizimin ekonomik të tyre përmes punësimit dhe vetëpunësimit. Përveç ndërmjetësimit për punësim dhe referimit në Qendrat e Formimit Profesional publik dhe privat për të përfituar kurse profesionale pa pagesë, kjo Drejtori ka zhvilluar dhe konsoliduar disa programe të financimit të ideve të sipërmarrjes së grave dhe të rinjve, si dhe të komunitetit rom. Çdo vit janë financuar 20 ide biznesi nga gratë dhe 20 sipërmarrje të të rinjve. Një tjetër program që targetonte të rinjtë ishte ai i intership për të rinjtë që përfundonin shkollat e larta, të cilat financoheshin nga Bashkia për të punuar për një periudhë 6 mujore pranë një biznesi privat. Edhe pse plani fillestar ishte që në këtë program të përfshiheshin 500 të rinj në vit, niveli i ulët i kërkesave nga të rinjtë solli një numër përfituesish prej 40 të rinj në vit.

Në periudhën janar-gusht 2021 janë punësuar nga Zyra e punës gjithsej 3,778 punëkërkes të rregjistruar ose 29% e punëkërkesve të papunë të rregjistruar në janar 2021. Ndër grupmoshat, përqindjen më të ulët në sigurimin e një pune e gjejmë tek ajo mbi 40 vjeç. Vetëm 24% e punëkërkesve të kësaj grupmoshe janë punësuar në periudhën e analizuar.




Figura 38 - Të punësuar sipas grupmoshës

Arsimimi është një faktor thelbësor në punësimin e individëve të papunë. Përqindjen më të lartë në sigurimin e një pune nga punëkërkesit e papunë e kanë ata me arsim universitar (52% e këtij grupi janë punësuar) dhe ata me arsim profesional (47% e këtij grupi janë punësuar).

Tabela 37 - Të regjistruarit për punë sipas nivelit të arsimit

Nr.	Arsimi	Rregjistruar për punë	Punësuar	%
1.	Pa arsim/fillore/9 vjecare	7,158	1,561	22%
2.	E mesme pergjithshme	3,386	876	26%
3.	E mesme profesionale	1,181	551	47%
4.	Arsimi Universitar	1,512	790	52%

Nivele të ulëta punësimi viben re edhe në grupet e tjera në nevojë. Specifikisht kanë arritur të punësohen:

- Vetëm 4% e romëve dhe egjiptianëve të rregjistruar si punëkërkes;

- Vetëm 2% e personave me aftësi të kufizuara të regjistruar si punëkërkuar;
- Vetëm 7% e emigrantëve të kthyer.

40 individë të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike (1,5% e totalit të këtij grupi) janë punësuar përmes ndërmjetësimit të zyrës së Punës në periudhën janar-gusht 2021. Dukshëm niveli i punësimit të tyre është shumë i ulët. Vetëm 1% e personave të punësuar në periudhën e analizuar i përkasin përfituesve të ndihmës ekonomike edhe pse, ata përbëjnë 21% të totalit të punëkërkuarve të regjistruar në këtë Zyrë.

Së fundi, në zbatim të VKM 535 “Për Procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e Programit të Puneve Publike në Komunitet”, datë 08/07/2020, janë disa individë të punësuar përmes një programi mbështetës nga Zyra e Punës/AKPA, por që vazhdojnë të trajtohen me NE. Këta individë (gjithsej 80) punojnë pranë Qendrave Komunitare që ofrojnë shërbime ditore e rezidenciale (gjithsej 7) për një periudhë 1-vjeçare, bazuar në marrëveshjet e bashkëpunimit të Agjencisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësim (AKPA) me secilën prej qendrave.

Tabela 38 - Shpërndarja e të punësuarve sipas qendrave komunitare dhe njësive administrative

Nr.	Qendra komunitare	Nr. i individëve	NJA
1	Qendra Komunitare Multidisiplinare	12	NJA nr. 5; NJA nr.8; NJA nr.9; NJA nr.10
2	Qendra Kombëtare Tranzitore e Emergjencave	9	NJA nr. 4; Dajt; Vaqarr
3	Qendra Komunitare “Gonxhe Bojaxhi”	10	NJA nr. 4; NJA nr.8
4	Qendra Komunitare Shkozë	10	NJA Nr.1
5	Nisma për ndryshim shoqëror - ARSIS	11	n/a
6	Qendra Sociale “Strehëza Tiranë”	5	n/a
7	Qendra Komunitare e Terrenit	8	n/a
8	Qendra Komunitare “Të qëndrojmë së bashku”	9	n/a

AKPA me Zyrat e Punës po rivlerësojnë punëkërkuarët e papunë që janë në ndihmë ekonomike, për të kategorizuar në statusin “pezull” të gjithë ata individë punëkërkuar të papunë (PUPA) që kanë probleme shoqëruese, që nuk lidhen direkt me punësimin, por ndikojnë në punësimin e tyre si pengesa sociale, shëndetësore, infrastrukturore (si psh. transporti, mungesa e kopshteve e çerdheve, etj) dhe për t’i referuar tek institucionet përkatëse, sipas modelit të një pilotimi të kryer në zonën e Elbasanit nga UNDP. Nga një vlerësim paraprak, janë klasifikuar me këtë status 531 individë të regjistruar si punëkërkuar të papunë në Rajonin e Tiranës, prej të cilëve 78 janë nga Bashkia Tiranë.

Për sa i përket **sfidave** të punësimit të këtyre kategorive rezulton që, një nga arsyet kryesore për refuzimin e ofertave të punës dhe rezistencës për të qëndruar në skemën pasive, lidhet me përfitimet shtesë të atyre që kanë “statusin” e përfituesit të NE. Të tilla përfitime lidhen jo vetëm me përfitimet bazë (përfitimi bazë për secilin anëtar; kompensimi i energjisë; pagesa e shkollës së fëmijëve deri në klasën e IX), por edhe me të tjera përfitime sipas rastit (përjashtim nga pagesat për çerdhe dhe kopsht; përjashtim nga pagesat për vaksina; librat falas deri në klasë të XII; bursa për në universitet; përjashtim

nga taksa lokale e kombëtare; kushte lehësuese për aplikime në fonde të ndryshme shtetërore; zbritje të tarifave në proceset legalizuese, etj.), si një seri përfitimesh që vijnë nga skema të ndryshme.

Kostimi i plotë i mbështetjes shtetërore që vjen nga skema të ndryshme, për përfituesit e NE, do të ndihmonte për të kuptuar dhe interesin e cdo familjeje për të qendruar në skemë. Punësimi informal brenda vendit apo punësimi sezonal jashtë vendit, është gjithashtu një rrethanë që i mban në skemë familjet në NE. Gjithashtu, raportohet që statusi “i familjes së varfër me asistencë sociale” sjell një serë përfitimesh për anëtarët e familjes që studiojnë dhe jetojnë jashtë vendit, sipas legjislacionit në këto vende. Komunikimi dhe ndërveprimi i bashkisë me Inspektoratin e Punës apo me Policinë në rastet e punësimit sezonal të anëtarëve të familjeve me NE, për zonat ndërkufitare, është i munguar ndonëse Bashkia raporton që ka bërë përpjekje për të patur informacion prej tyre. Aktualisht, nuk ka një analizë mbi daljen nga skema në përfundim të afatit 5-vjeçar, për të konkretizuar masën e çlirimit të kësaj skeme.

### 3.4.3 Ndhimja ekonomike dhe PAK

Ndhimja ekonomike synon të lehtësojë sfidat financiare me të cilat përballen familjet, duke promovuar mirëqenien dhe gjithëpërfshirjen. Sipas statistikave të muajit qershor 2021, janë 2,708 familje në Bashkinë Tiranë që përfitojnë ndihmë ekonomike përmes skemës kombëtare dhe fondit 6%. 32% e familjeve përfituese jetojnë në zonën urbane (878 familje) dhe 68% e tyre jetojnë në zonën rurale të Bashkisë (1,830 familje).

Kundrejt numrit të përgjithshëm të familjeve në Bashkinë Tiranë (296,862 familje), 0.9% e tyre përfitojnë ndihmën ekonomike. Përqindja që zënë familjet përfituese të ndihmës ekonomike ndaj numrit total të familjeve është e ndryshme në njësi të ndryshme të Bashkisë Tiranë.




Figura 39 - Familjet në NE kundrejt familjeve në NjA (%)

Përgjithësisht njësitë në zonën rurale të Bashkisë kanë edhe përqindjen më të lartë të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike kundrejt totalit të familjeve në njësinë administrative (NjA), madje

në nivele mbi mesataren e Bashkisë (figura 7). Zall-Bastari, Shëngjergji, Baldushku, Bërzhita, Zall Herri, Krraba mund të konsiderohen me nivelin më të lartë të familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike në raport me numrin total të familjeve në territorin respektiv të tyre.




Figura 40 - Numri i përfituesve të ndihmës ekonomike sipas njësive (3-mujori i katërt i 2021)

Siç vihet re në zonën rurale të Bashkisë numrin më të lartë të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike e kanë Zall-Bastari, Shëngjergji, Bërzhita, Zall Herri, Baldushku, Kashari dhe Dajti, ndërkohë që në zonën urbane numrin më të lartë e gjejmë në njësitë administrative 1, 4, 5 dhe 6.

Krahasimi i statistikave të ndihmës ekonomike të mes-vitit 2021 me muajin dhjetor 2019 nxjerr në pah faktin që Pandemia Covid 19 ka rritur me 8% kërkesën/aplikimin për përfitim të ndihmës ekonomike<sup>1</sup>. Kështu, në dhjetor 2021 kanë aplikuar 2,439 për përfitimin e ndihmës ekonomike krahasuar me 2,465 familje aplikuese në dhjetor 2019. Rritja e kërkesës për përfitimin e ndihmës ekonomike nuk është e njëtrajtëshme në 24 njësitë administrative. Janë 16 njësi administrative ku vërehet rritje e kërkesës, 8 prej të cilave në zonën rurale (po ato njësi që kanë edhe nivelin më të lartë të familjeve në skemën e ndihmës ekonomike në të dy periudhat e krahasuara).

Ndërkohë, efekti më i madh duket se është ndjerë në zonën urbane të Bashkisë, pasi në 8 nga 11 njësitë administrative të kësaj zone ka kërkesë të shtuar për përfitimin e ndihmës ekonomike. Rritja më e madhe është shënuar në njësitë 1, 2 (kufitare) dhe 9, të cilat praktikisht përfshijnë zona historikisht informale, e po ashtu vulnerabël, me prezencë të lartë të kategorive të marxhinalizuara, përfshirë ato Rome dhe Egjiptiane. Këto zona urbane, karakterizohen nga një prezencë e lartë e banesave sociale apo trajtimeve me bonus qeraje, por edhe nga flukse të larta të lëvizjeve demografike dhe numër të lartë të banesave të prishura për shkak të informalitetit. Ndër njësitë rurale, Zall-Herr rezulton historikisht si zonë e varfër, ndërsa në Farkë aplikimet për NE rezultojnë të jenë rritur për shkak të një rrethane momentale lidhur me vendosjen e disa familjeve të ardhura rishtazi në kohën e pandemisë, të cilat janë trajtuar më pas me NE e me bonus qeraje.

<sup>1</sup> NE në vlerë është ndryshuar gjithsej 2 herë: gjatë pandemisë dhe me VKM datë 29/12/2021. Ndërkohë, për familjet me 7+anëtarë ka një indeksim të vazhduar.




Figura 41 - Rritja e aplikimeve për ndihmë ekonomike, shprehur në % për vitin 2021

Rritjes së kërkesës për përfitimin e ndihmës ekonomike duket se sistemi i është përgjigjur duke rritur përfshirjen në skemë të një numri më të madh familjesh, që manifestohet në rritjen e skemës me 5,5% në qershor 2021 krahasuar me dhjetor 2019.

Tabela 39 - Dinamika e NE, 3-mujori i katërt i 2021

	Familje/ individë aplikues	Familje/ individë përfitues	Raporti përfitues/ aplikues	Përfitues nga zona urbane	Përfitues nga zona rurale
<b>Tetor '21</b>	2,768	2,462	89%	846	1,616
<b>Nëntor '21</b>	2,729	2,459	90%	846	1,613
<b>Dhjetor '21</b>	2,628	2,439	93%	838	1,601

Raporti përfitues/aplikues në total në nivel bashkie rezulton i lartë (rreth 90%). Ndërkohë që, për të kryer analiza sipas NjA, do të duhen të dhëna të sakta dhe të detajuara nga NjA, proces që kërkon kohë nëse ndërveprimi dhe shkëmbimi i të dhënave nuk ndodh në mënyrë periodike e të vazhduar. Nga të dhënat më sipër, evidentohet se % e përfituesve nga zonat rurale (66% e totalit) është për çdo muaj sa 2-fishi i % së përfituesve nga zonat urbane (34% e totalit). Nga takimet në bashki, është evidentuar se nga zonat rurale numri individë/familje përfituese të NE mund të ishte edhe më i madh pasi mendohet që ka edhe të tjera familje që mund të aplikojnë, por që nuk e bëjnë aplikimin për arsye të ndryshme, ndër të cilat më tipike është distanca.

### Karakteristika të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike

- Janë 8,614 individë në familjet përfituese të ndihmës ekonomike: 3,461 fëmijë të grupmoshës 0-18 vjeç (40% e përfituesve), 4,861 individë të grupmoshës 19-64 vjeç (56% e përfituesve) dhe 292 individë të grupmoshës mbi 65 vjeç (4% e përfituesve). Numri mesatar i pjesëtarëve në familjet përfituese të ndihmës ekonomike është 3,2 anëtarë.
- 52% e individëve përfitues të grupmoshës 19-64 vjeç janë femra (2,514 individë). Nga 4,861 individë të grupmoshës 19-64 vjeç, 642 individë jetojnë në zonën urbane të Bashkisë (13% e totalit).
- Procesi i verifikimit të aplikimeve për NE, tashmë që realizohet gjithnjë dhe më shumë një kryqëzim të sistemeve të informacionit institucional, është më i lehtë për aplikuesit në zonën urbane të bashkisë. Kjo pasi, një pjesë e informacioneve për zonën rurale janë ende të paplota apo të parregjistruara, si psh ato lidhur me asetet dhe pronën. Në këto kushte, në këto zona,



roli i administratorit shoqëror në procesin e vlerësimit socio-ekonomik merr një rëndësi parësore duke e bërë procesin edhe më subjektiv.

- Janë 471 gra kryefamiljare (19% e totalit të grave përfituese) përfituese të skemës së ndihmës ekonomike.
- Kundrejt numrit të përgjithshëm të banorëve në Bashkinë Tiranë (848,973 banorë) rezulton se 1% e tyre përfitojnë ndihmën ekonomike. Nëse i referohemi numrit të përgjithshëm të fëmijëve në Bashkinë Tiranë (190,956 fëmijë) mund të themi se 1,8% e tyre janë pjesë e familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike. Ndërkohë 0.9% e popullsisë së grupmoshës 19-64 vjeç janë përfitues të skemës së ndihmës ekonomike dhe vetëm 0.3% e popullsisë së grupmoshës mbi 65 vjeç janë përfitues të kësaj skeme.
- 325 familje përfituese të ndihmës ekonomike (12% e tyre) kanë të paktën një pjesëtar me aftësi të kufizuara. 54% e tyre jetojnë në zonën rurale të Bashkisë.
- Janë 283 familje rome që përfitojnë ndihmën ekonomike, ose 10% e përfituesve të kësaj skeme. 91% e tyre jetojnë në zonën urbane të Bashkisë Tiranë.
- Që prej vitit 2018, është rritur konsiderueshëm numri i individëve viktimë të dhunës në familje që janë trajtuar me NE. Kanë qenë vetëm 41 individë në 2018, rreth 100 për vitet 2019 dhe 2020, ndërsa në vitin 2021 ky numër ka arritur në 164, prej të cilëve 136 (83%) gra.

### **Personat me aftësi të kufizuara (PAK)**

Deri më sot, Bashkia është fokusuar kryesisht në reagimin ndaj rasteve kur individët me aftësi të kufizuara (PAK) kanë kërkuar shërbime në mënyrë proaktive. Kjo qasje ka qenë e rëndësishme në adresimin e nevojave të atyre që kanë kërkuar ndihmë. Në përputhje me praktikën ekzistuese administrative, të dhënat në lidhje me PAK janë menaxhuar në nivel njësie administrative, një pjesë thelbësore e infrastrukturës së informacionit të bashkisë. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se aktualisht ekziston një mundësi për përmirësim në drejtim të zhvillimit të një sistemi referimi më të strukturuar dhe gjithëpërfshirës për këtë kategori. Gjithashtu, ka pasur një hap pozitiv drejt modernizimit me dixhitalizimin e dosjeve të mbajtura nga ministria. Ky transformim dixhital i mundëson bashkisë të ofrojë mbështetje më efektive, përfshirë pagesat e aftësisë së kufizuar dhe shërbimet thelbësore, për individët me aftësi të kufizuara, duke theksuar më tej angazhimin për të adresuar nevojat e tyre në mënyrë efektive.

Sipas ligjit të ri, administratori shoqëror do të duhet të bëjë vizita në familje çdo 3 muaj për individët PAK fizik dhe mendor. Aktualisht, administratori nuk bën ndonjë kryqëzim të informacionit midis skemave, siç do të ishte me interes lidhja familje me individ PAK – familje/individë përfitues të NE. Për më tepër, administratori nuk ka një instrument/formular të kontrollit në familje.

Për vitin 2020 në Bashkinë Tiranë janë 21,548 persona me aftësi të kufizuara ndër të cilët:

- 2,747 fëmijë; 1,498 janë djem (1,193 në zonë urbane dhe 305 në zonë rurale) dhe 1,249 vajza (952 në zonë urbane dhe 297 në zonë rurale).
- 18,801 të rritur

3% e popullsisë në territorin e Bashkisë Tiranë ka të paktën një tip të aftësisë së kufizuar.




Figura 42 - Persona me aftësi të kufizuara mbi 18 vjeç, 2020

Zona urbane (figura 10) ka numrin më të lartë të personave me aftësi të kufizuara mbi 18 vjeç. Njësia administrative me numrin më të lartë të personave me aftësi të kufizuara të kësaj grupmoshe është njësia administrative nr. 4 (2,130 persona me aftësi të kufizuara), vijuar nga njësia nr 2 (1,962 të rritur), njësia nr. 5 dhe njësia nr. 6. Ndërsa njësitë urbane me numrin më të vogël të personave me aftësi të kufizuara rezultojnë të jetë njësia administrative numër 8-të dhe 10-të.

Nga zonat rurale njësia me numrin më të lartë të personave me aftësi të kufizuara rezultojnë të jetë njësia administrative Kashar me 495 të rritur, vijuar nga njësia Dajt (487 të rritur) dhe njësia Farkë (351 të rritur).




Figura 43 - Fëmijë me aftësi të kufizuara, 2020

Fëmijët me aftësi të kufizuara janë grup prioritar në këndvështrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror. Njësitë me numrin më të lartë të fëmijëve me aftësi të kufizuara janë në zonën urbane të Bashkisë, veçanërisht njësitë 4, 6, 1, 2, 9 dhe 11 (figura 11). Në zonën rurale njësia me numrin më të lartë të fëmijëve me aftësi të kufizuar është Kashari (165 fëmijë me aftësi të kufizuara).

## Shërbimi i punësimit për PAK

Sipas statistikave zyrtare, numri i personave me aftësi të kufizuara të regjistruar në zyrat e punësimit, si punëkërkues të papunë, ka ardhur në rritje. Kështu në vitin 2019 në Tiranë ishin të regjistruar si punëkërkues të papunë 67 individë me aftësi të kufizuara, nga të cilët 23 ishin gra. Në të njëjtin vit kanë përfituar nga programet aktive të punësimit (nxitje dhe ndërmjetësim) 3 persona. Ndërkohë 19 persona me aftësi të kufizuara kanë marrë pjesë në kurset pa pagesë. Në shtator 2021 nga Zyra e Punës Tiranë u raportuan të regjistruar si punëkërkues 92 persona me aftësi të kufizuara. Ka një rritje të lehtë të personave të regjistruar, por ende punësimi i tyre mbetet sfidë: vetëm 2 persona me aftësi të kufizuara kanë arritur të punësohen në periudhën janar-shtator 2021.

Drejtorja e Nxitjes së Punësimit pranë Bashkisë Tiranë raporton se gjatë vitit 2020 është bërë i mundur referimi dhe punësimi i 7 personave me aftësi të kufizuara në kompani private. Gjithashtu, raportohet si eksperiencë pozitive punësimi i personave nga kjo kategori në qendrat komunitare (4 persona) dhe në DPSHS.

## Shërbimi i strehimit social për PAK

Gjatë vitit 2020 nga 241 përfitues të bonusit të qirasë, 52 janë persona me aftësi të kufizuara, ndërsa nga 806 përfitues kredie, 12 janë përfitues me aftësi të kufizuara. Grupi i personave me aftësi të kufizuara konsiderohet si grup prioritar për trajtimin me strehim në përputhje me ligjin për strehimin social.

## Shërbimet zhvilluese dhe rehabilituese sociale

Në bashkinë e Tiranës shërbimet ekzistuese për personat me aftësitë kufizuara ofrohen nga institucione publike dhe jopublike. Shërbimet publike ofrojnë shërbim nëpërmjet qendrave komunitare për fëmijë dhe të rritur. Në Tiranë janë gjithsej 5 qendra komunitare publike, të cilat ofrojnë shërbim për fëmijë me aftësi të kufizuara dhe dy prej tyre ofrojnë shërbim edhe për të rritur, numri i përfituesve të këtyre të fundit paraqitet i kufizuar, në raport me nevojat.

Tabela 15 tregon llojet e shërbimit të ofruara nga qendrat komunitare dhe numrin e përfituesve për secilin shërbim. Një person me aftësi të kufizuara mund të përfitojë më shumë se një shërbim në qendër. Vërehet se nga qendrat 87 fëmijë kanë përfituar terapi zhvillimi, 79 kanë frekuentuar qendrën ditore, 48 fëmijë janë informuar dhe këshilluar, 22 fëmijë kanë marrë shërbime të mbështetjes psikosociale, terapi intensive, aftësim dhe ndërhyrje të hershme në qendra të specializuara. Ndërkohë, numri i personave të rritur me aftësi të kufizuara që frekuentojnë dy qendrat komunitare është 67 persona ku këta dhe të tjerë që nuk frekuentojnë qendrën ditore marrin shërbime të tjera si informim dhe këshillim, terapi zhvillimi etj.

Tabela 40 - Llojet e shërbimeve dhe numrin e përfituesve tëPAK në qendrat komunitare

Përfituesit e shërbimit	Shërbimet e ofruara	Total	F	M
	Informim këshillim	48	9	39
	Mbështetje psiko-sociale	22	4	18
	Ndërhyrje e hershme në QS specializuar	22	4	18

<b>Fëmijë me aftësi të kufizuara</b>	Qendër ditore	<b>79</b>	23	56
	Terapi intensive psiko-sociale	<b>22</b>	4	18
	Terapi aftësimi për punë	<b>22</b>	4	18
	Terapi zhvillimi	<b>87</b>	22	65
<b>Të rritur me aftësi të kufizuara</b>	Informim këshillim	<b>33</b>	12	21
	Përmbushje e nevojave të tjera	<b>3</b>	1	2
	Mbështetje psiko-sociale	<b>21</b>	6	15
	Ndërhyrje e hershme në QS specializua	<b>18</b>	5	13
	Qender ditore	<b>67</b>	33	34
	Terapi intensive psiko-sociale	<b>18</b>	5	13
	Terapi aftësimi për punë	<b>21</b>	7	14
	Terapi zhvillimi	<b>45</b>	14	31

Në vitin 2021 Bashkia e Tiranës nëpërmjet fondit social, fondit të bashkisë dhe një fondi nga UNDP po zhvillon tre shërbime të dedikuara për aftësinë e kufizuar dhe një shërbim për grupet në nevojë ku personat me aftësi të kufizuara janë përfitues. Të gjitha këto projekte po realizohen në bashkëpunim me organizatat jo fitimprurëse<sup>2</sup>:

1. Projekt për nxitjen e integritit të personave me aftësi të kufizuar përmes fuqizimit të kapaciteteve për jetesë të pavarur.
2. Projekti për përkujdesjen për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara.
3. Projekti për ndërhyrjen e hershme të fëmijëve me nevoja të posaçme.
4. Projekti i shërbimit lëvizës shëndetësor dhe komunitar për familjet në zonat rurale për grupet në nevojë, përfshirë këtu edhe personat me aftësi të kufizuara.

Këto janë shërbime komunitare financuar nga Bashkia Tiranë, në koncept multidisiplinar, që pushteti lokal ka vite që aplikon, e kjo bën që qëndrueshmëria e tyre të jetë garantuar. Përfituesit janë të referuar nga NJA/NJVNR (Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit), si dhe nga organizata/Rrjeti i PAK. Në kushtet kur adresimi i të gjitha nevojave është i vështirë e deri diku i pamundur, ndiqen dy qasje kryesore: (a) prioritizimi i nevojave për shërbime dhe (b) referimi në organizata që ofrojnë shërbime në territor.

Në 2022 Bashkia ka përfunduar rikonstruksionin e një prej Qendrave të saj Sociale “Shtëpia e Përbashkët” (Laprakë), e cila do të mundësojë shërbime të specializuara për persona me aftësi të kufizuara.

<sup>2</sup> Numri i përfituesve është përfshirë në raportimin më lart.

#### 3.4.4 Shërbimet e tjera Sociale

Kategoritë sociale që përfitojnë nga shërbimet sociale ndahen në 9 nënkategori si:

##### ***Fëmijë në risk***

Në kategorinë e fëmijëve në risk bëjnë pjesë 6 nënkategori: fëmijët jetim biologjik, fëmijët e rrugës, fëmijët e rrugës, fëmijët në varfëri, fëmijët rom dhe fëmijët egjiptian. Për vitin 2021 numri i fëmijëve të trajtuar me shërbim është 1258. Rreth 24% e fëmijëve të trajtuar i përkasin kategorisë fëmijë në varfëri dhe 48% janë fëmijët e rrugës.

194 raste të fëmijëve të menaxhuar gjatë vitit 2020 lidheshin me problemet social ekonomike të familjeve të tyre (36% e totalit të rasteve). 125 fëmijë u identifikuan në situatë rruge (23% e rasteve);

Kanë përjetuar të paktën një formë të dhunës 86 fëmijë (17% e rasteve të menaxhuara), nga të cilët: 21 fëmijë përjetuan dhunë fizike, 13 dhunë seksuale dhe 52 fëmijëdhunë psikologjike. Në 53 raste fëmija u identifikua i/e neglizhuar nga prindi/prindërit.

Janë menaxhuar gjatë vitit të analizuar 15 raste fëmijë në konflikt me ligjin (3% e rasteve) dhe vetëm 9 raste të fëmijëve me aftësi të kufizuara (2% e rasteve).

U identifikuan si viktima/viktima të mundshme trafikimi 20 fëmijë. Nga Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës nënvizohet që ka raste të menaxhuara të fëmijëve që janë përdorues droge, por ato përgjithësisht përfshihen tek rastet e fëmijëve në konflikt me ligjin. Janë 79 fëmijë në Bashkinë Tiranë të vendosur në shërbim rezidencial për fëmijë pa kujdes prindëror të përkohshëm.

Fëmijë shtetas të huaj të pashoqëruar janë një tjetër grup, për të cilin Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës thekson se në vitet e fundit ka një numër të shtuar. Janë të paktën 20 raste të ndjekura nga kjo Njësi gjatë vitit 2020, ndërkohë që numri i atyre që lëvizin në territorin e Bashkisë mund të jetë më i lartë.

##### ***Të rinj në risk***

Të rinjtë janë një tjetër kategori në nevojë por që nuk kanë marrë vëmendjen e duhur dhe mbartin me vete shumë probleme duke filluar që nga mungesa e punësimit dhe deri në mungesën e strehimit. Në këtë kategori përfshihen të të rinjtë në risk dhe të rinj të shërbimit të provës. Për vitin 2021 numri i përfituesve ka qenë vetëm 10, kjo lidhur me hezitimin e kësaj kategorie për të qenë objekt diskriminimi, paragjykimi.

##### ***Gra në risk.***

Bashkia Tiranë, ka një strukturë të konsoliduar që u përgjigjet rasteve të dhunës ndaj grave e vajzave në territorin e Bashkisë Tiranë, që është Sektori i Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore pjesë e Drejtorisë së Shërbimit Social.

Me Mekanizëm të Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje nënkuptojmë mekanizmin e ngritur në nivel vendor në bazë të Ligjit nr. 9669 datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” i ndryshuar dhe VKM 334/2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës

për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij” (në proces rishikimi).

Që prej muajit Mars 2021, ka gjetur zbatim “Protokolli i Menaxhimit të Rasteve të dhunës seksuale tek të rriturat/riturit, në nivel vendor përmes qasjes shumë-sektoriale të koordinuar”<sup>3</sup>. Ky Protokoll u përgatit në vijim të Protokollit të Menaxhimit të Rasteve të dhunës në familje në nivel vendor përmes Mekanizmit të Koordinuar të Referimit (MKR), për t’iu ardhur në ndihmë anëtarëve të këtij Mekanizmi (por edhe institucioneve të tjera përgjegjëse), për të standardizuar veprimet e nevojshme për një reagim të menjëhershëm, gjithëpërfshirës e me përgjegjshmëri për mbrojtjen dhe trajtimin e rasteve të dhunës seksuale.

Spektori i Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore në bashkëpunim me Mekanizmin e Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje (MKR), gjatë viteve 2018, 2019, 2020 dhe 2021 ka trajtuar rreth 2,000 raste të dhunës në familje, paraqitur në tabelën më poshtë:

Tabela 41 - Rastet e dhunës në familje të trajtuara nga Bashkia Tiranë dhe MKR

	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
<b>Burra</b>	41	28	56	50
<b>Gra</b>	451	381	455	526
<b>Total</b>	492	409	511	576

*Burimi: Drejtoria e Shërbimit Social, Bashkia Tiranë, 2021*

Të gjitha rastet kanë qenë të pajisuara me Urdhër të Menjëhershëm Mbrojtje (UMM), dhe/ose Urdhër Mbrojtje (UM) që do të thotë që marrin NE prej 3,000 lekësh (dyfishuar prej muajit Janar 2022). 89% e viktimave të dhunës në familje të raportuara në këtë periudhë jetojnë në zonën urbane të Bashkisë dhe vetëm 11% e tyre jetojnë në zonën rurale (13 NJA). Raportimi i dhunës në familje dhe/ose ndaj grave e vajzave është mjaft i ulët në zonat rurale të bashkisë. Sipas të dhënave nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale në periudhën 2018-2021, nga NJA Baldushk nuk ka asnjë raportim për dhunë në familje. Në NJA Pezë vetëm 1 raportim, në NJA Shëngjergj 2, ndjekur nga NJA Ndroq, NJA Zall-Bastar dhe NJA Bërzhitë që kanë patur 4 raportime gjatë këtij 4-vjeçari.

### ***Të moshuar në risk***

Në Bashkinë Tiranë, të moshuar që akomodohen në institucionet e përkujdesjes për vitin 2021 janë 120. Në këtë kategori bejnë pjesë të moshuar të të identifikuar si të moshuar në risk dhe të moshuar në institucionet e përkujdesjes, për arsye se kanë mbetur vetëm, janë pa të ardhura dhe përkrahje. Në territorin e Bashkisë Tiranë ka 5 qendra sociale të cilat vetëm për vitin 2017 kanë ofruar përkujdesje për të moshuar.

Sipas regjistrimit të gjendjes civile në Bashkinë Tiranë janë të rregjistruar 107,992 persona mbi 65 vjeç. 292 persona të kësaj grupmoshe janë pjesë e familjeve përfutuese të ndihmës ekonomike. Pra të paktën 0,3% e popullsisë së kësaj grupmoshe kanë vështirësi ekonomike. Megjithatë, fokus grupet e zhvilluara me Njësitë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit nxorën në pah faktin se një numër aplikimesh nga

<sup>3</sup> Përgatitur në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me mbështetjen e UNDP Shqipëri, në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “T’i japim fund dhunës ndaj grave në Shqipëri” financuar nga Qeveria e Suedisë.

ky grup rezultojnë jopërfitues të ndihmës ekonomike edhe pse janë në kushtet e vështirësisë ekonomike.

Në vitin 2020, 54% e njësive administrative raportuan 567 kërkesa nga të moshuarit për të marrë një nga tre format e shërbimeve (në familje, ditore ose rezidenciale). Megjithatë, ky është raportimi i vetëm 54% të njësive të Bashkisë Tiranë, pra kërkesa për shërbime është potencialisht më e lartë.

Nëse i referohemi numrit të popullsisë së këtyre njësive administrative rezulton se njësitë që kanë nivelin më të lartë të kërkesave nga kjo grupmoshë janë NJA 1 (1,8% e grupmoshës), NJA 3 (1,1%), NJA 4 (2%) dhe NJA Bërzhitë (4%), NJA Krrabë (1,1%), NJA Vaqarr (1%) dhe NJA Ndroq (1,3%).

Raportohen 384 të moshuar që kanë shprehur nevojën për shërbime në shtëpi, megjithatë nevoja pritet të jetë më e lartë, pasi 8 njësi administrative (33% e njësive) nuk kanë raportuar nevoja për këtë shërbim. 71 të moshuar kanë kërkuar shërbim në qendër ditore për të moshuar. 112 të moshuar kanë kërkuar shërbim në qendër rezidenciale.

### ***Persona me Aftësi të Kufizuar (PAK)***

Prej disa vitesh tashmë Bashkia Tiranë u përfshi në pilotimin e modelit të ri të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, vlerësim bio-psiko-social, dhe tashmë ky model po zbatohet në të gjithë territorin e saj.

Vlerësimi bio-psiko-social bën të mundur përcaktimin e shkallës së prekjes së aftësisë për të realizuar, veprimtaritë bazë e ato të jetës së përditshme (që përfshin edhe aftësinë për punë) të grupuar në nivelet e lehtë (5-24%), e moderuar (25-49%), e rëndë (50-95%) dhe e thellë apo e plotë (96-100%). Kjo lejon përcaktimin objektiv të nivelit të aftësisë së kufizuar, si edhe nevojat për shërbime të tjera si ndihmësi personal, paketa higjieno-sanitare, përkthyesi i gjuhës së shenjave, mjetet ndihmëse për lëvizje, etj. Pjesë e vlerësimit janë intervistat nëpërmjet të cilave komisioni bën vlerësimin për të krijuar profili bio-psiko-social i përfituesit të aftësisë së kufizuar e më pas bën rekomandimet përkatëse në lidhje me përfitimet në pagesa dhe shërbimet shëndetësore, psiko-sociale, të arsimit, të formimit profesional dhe punësimit, strukturën familjare të personave me aftësi të kufizuara etj. Tashmë, vendimi i komisionit për personin me aftësi të kufizuar kombinohet me vendimin për përfitimin e pagesës së përmuajshme për aftësinë e kufizuar me cilësimin e shërbimeve që duhet të marrë individi në përputhje me nevojat e vlerësuara.

Për 2021 në total kanë përfitur nga shërbimet sociale 20,658 persona të ndarë në kategoritë:

- PAK të verbër (1,758)
- PAK fizikë-mendorë (5,807)
- Paraplegjikë dhe tetraplegjikë (869) dhe
- Invalidë pune (12,224)

Ndërsa të paaftë më përfitim kujdestari për të njëtin vit kanë përfituruar 2,918 persona.

### ***Komuniteti Rom - Egjiptianë***

Bashkia Tiranë ka hartuar Planin e Veprimit për përfshirjen e pakicave rome dhe egjiptiane, i cili përcakton qëllimet dhe prioritetet trevjeçare, për të përmirësuar mirëqenien dhe përfshirjen sociale të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror. Ky Plan Veprimi do të shërbejë si një mekanizëm për vlerësimin e nevojave, planifikimin e aktiviteteve, realizimin e monitorimit e vazhdueshëm të shërbimeve sociale që ofrohen për këto dy minoritete nga institucionet vendore. Në

programet e përfshirjes sociale futen edhe këto kategori që për vitin 2021 sipas të njëjtit burim kanë përfituar 444 familje rome dhe 225 familje egjiptiane.

Janë të paktën 1,206 familje rome dhe egjiptiane të identifikuar në territorin e Bashkisë Tiranë. Në përputhje me analizën e kryer në funksion të hartimit të Planit të Veprimit për Përfshirjen e pakicave rome dhe egjiptiane nga 27 Njësitë Administrative dhe lagjet e Bashkisë raportohet se në 17 prej tyre ka të paktën një familje Rome ose Egjiptiane të regjistruar si përfituese e shërbimeve sociale. 24% e familjeve jetojnë në territorin e njësisë administrative 4, në njësinë administrative 5 jetojnë 20% e tyre dhe 19% në njësinë 1 (grafiku 18). Familje Rome dhe Egjiptiane janë identifikuar gjithashtu edhe në: Njësinë Administrative nr, 2, 7, 10, Vaqarr dhe Zall Herr, por ato janë të pakta në numër dhe nuk jetojnë në komunitete të identifikuar si zona të pakicave.

### 3.5 Rinia

Rinia është një nga pasuritë më të mëdha që ka Tirana. Në territorin e BT-së përqëndrohet më shumë se gjysma e gjithë të rinjve të Shqipërisë, për shkak edhe të numrit më të lartë të universiteteve. Përveç atyre që janë banues të përhershëm të Tiranës, apo studentë të ardhur nga rrethet e tjera të vendit, vitet e fundit janë shtuar shumë edhe numri i të rinjve me prejardhje ndërkombëtare. Investimi në kulturë, ndihmon në përmirësimin e bashkëjetesës në komunitet por edhe në nxitjen e zhvillimit ekonomik si pasojë e pashmangshme që vjen prej zhvillimit njerëzor. Në vitin 2022, Tirana u shpall “Kryeqyteti European i Rinisë”, një vlerësim që i solli qytetit mijëra të rinj nga e gjithë Europa, për të marrë pjesë në aktivitetet rinore të organizuara nga Bashkia Tiranë.

“**Ligji për Rininë**” Nr. 75/2019 i miratuar në vitin 2019, parashikonte edhe zhvillimin e një institucioni i cili do të ishte përgjegjës për zbatimin e politikave rinore. Ky institucion është **Agjencia Kombëtare Rinore**, aktiviteti i së cilës rregullohet si me ligjin për rininë ashtu edhe me një grup vendimesh qeveritare (VKM). Aktualisht ky institucion bën zbatimin e politikave rinore dhe menaxhon proceset e dhënies së granteve për organizatat rinore.

Ndër të tjera përpjekje shumë të rëndësishme të Bashkisë Tiranës dhe Qeverisë kundrejt të rinjve është edhe **Karta e Studentit**. Karta e Studentit është mjeti nëpërmjet të cilit studentët përfitojnë mjaft avantazhe, tarifa të reduktuara dhe oferta të dedikuara, si nga institucionet publike ashtu edhe nga subjektet private. Qeveria dhe Bashkia e Tiranës kanë mundur për të gjithë studentët e Universitetit të Tiranës pajisjen me kartën studentore, falë së cilës do të përfitojnë një numër të konsiderueshëm shërbimesh falas ose me kosto të reduktuar në institucionet shtetërore dhe ato private. Karta lëshohet pa pagesë dhe duhet rinovuar pas një viti.

Përmes kësaj karte, studentët në Tiranë kanë lehtësira në shërbime të ndryshme publike dhe private si më poshtë:

**Transporti** – Biletë pajtimi mujor, e përgjithshme, për studentët, për të gjitha linjat është falas.

**Zbritje nga tarifa standarte** për disa institucione kulturore sipas listës në tabelën më poshtë:

Tabela 42 - Zbritjet e përfituara nga Karta e Studentit

Institucionet	Cmimi Standard	Cmimi për Studentët	Zbritja
Muzeu Historik Kombëtar	200 ALL	60 ALL	70%



Shtëpia me Gjethë	700 ALL	210 ALL	70%
Bunk'Art 1	500 ALL	300 ALL	40%
Kulla e Sahatit:	200 ALL	100 ALL	50%
Muzeu Arkeologjik	300 ALL	100 ALL	66.5%

Po ashtu, me Vendim të Këshillit Bashkiak **Nr. 102 dt 19.10.2022**, BT vendosi **subvencionim me 50% të tarifës** për të gjithë studentët që jetojnë në konvikte, duke marrë parasysh që në të ardhmen do të jenë kontribues në qytetin e Tiranës.

Bashkia Tiranë i ka mundësuar të gjithë të rinjve një sërë alternativash ku ata mund të shprehin angazhimin e tyre. Në vitin e Kryeqytetit European të Rinisë 2022, Tirana themelon një strukturë të re kushtuar artit, kulturës dhe teknologjisë. **Agjencia e Industrisë Kreative** është institucioni më i ri në varësi të Bashkisë së këtij qyteti, që ka si qëllim kryesor zhvillimin e industrisë, sipërmarrjes dhe ekonomisë krijuese. Programi i Agjencisë së Industrisë Kreative do të ndikojë në fushën e artit, të filmit, kinemasë, arkitekturës, dizajnit, modës, turizmit, prodhimeve audio vizuale, të rekreacionit dhe të teknologjisë. AIK synon rivitalizimin e kinemave të qytetit, si Kinema Agimi, si dhe ngritjen e zyrës së filmit në Tiranë.

### 3.5.1 Start-upet

Ekonomia shqiptare në përgjithësi përbëhet nga sipërmarrje të vogla dhe të mesme, ndërkohë që termi start-up është bërë popullor vetëm në dy dekadat e fundit. Në mjedisin lokal të biznesit, NVM-të (ndërmarrjet e vogla dhe të mesme) kanë një dominim prej 98,8% të totalit të të gjitha kompanive të biznesit në vend (INSTAT, 2021), por nuk ka një numër të saktë se sa prej tyre kanë qenë start-up, për shkak të mungesës së një përcaktimi të qartë. Nuk ka pasur një përcaktim të qartë për start-up-et dhe ekosistemin e start-up-eve sepse kuadri ligjor mungonte në Shqipëri para vitit 2022. Në një periudhë të tillë konfuzioni pothuajse çdo NVM e re me ndonjë element inovativ është konsideruar si një start-up. Në Shqipëri nuk ka asnjë provë për ndonjë rol ndikues në ekosistemin e Qeverisë së Shqipërisë, përveç rregulloreve të fundit nëpërmjet Ligjit për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Start-up-eve, nr. 25/2022 (Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, 2022).

Në drejtim të inovacionit, krijimi i një ekosistemi të favorshëm për start-up-et është bërë një prioritet për Shqipërinë. Në 2022 u miratua ligji për inovacionin e dedikuar për start-up, i cili parashikon një ndarje të buxhetit të shtetit në mbështetje të ekosistemit të inovacionit. Janë ngritur nisma të shumta të mbështetura nga sektori privat, ofrimi i programeve të përsheptimit për start-up me potencial të lartë, asistencë teknike, mentorim dhe trajnime për marrëdhëniet me investitorët. Më konkretisht ky ligj synon nxitjen e kërkimit, realizimit dhe përdorimit të ideve, modeleve, produkteve dhe proceseve të reja, të cilat sjellin risi në çdo fushë të ekonomisë. Në këtë ligj përcaktohen të gjitha organet shtetërore, rregullat dhe procedurat, si dhe masat mbështetëse që do të zbatohen për certifikimin dhe mbështetjen e Startup-eve Inovative si dhe krijimin e një eko-sistemi të favorshëm për to në Republikën e Shqipërisë.

Vetëm në 2022 u publikuan zyrtarisht rregulloret në legjislacionin për startup-et. Sipas legjislacionit aktual dhe më të fundit shqiptar për “Mbështetjen dhe zhvillimin e bizneseve të reja”, sipërmarrjet e reja konsiderohen “individët dhe personat fizikë ose juridikë të regjistruar në Regjistrin Tregtar të Republikës së Shqipërisë, të cilët, duke iu referuar objektit të veprimtarisë së tyre, janë konceptuar,

krijuar dhe operuar me qëllim të nisjes së realizimit dhe zhvillimit të një modeli të veçantë të rritjes teknologjike, produktive dhe teknologjike, në praktikë të posaçme, teknologjike dhe inovative, për përmirësimin e ndjeshëm të modeleve të biznesit, produkteve dhe shërbimeve ekzistuese. Ndërsa "Ekosistemi i Mbështetjes së Start-up-ve nënkupton ndërveprimin e individëve, start-up-ëve dhe organizatave të tjera që veprojnë si lehtësues, të cilët së bashku veprojnë si inkubatorë për krijimin dhe rritjen e bizneseve fillestare".

Skena e start-up-ëve në bashkinë e Tiranës, ka treguar rritje dhe zhvillime të konsiderueshme duke u bërë ekosistemi kryesor i start-up-ëve në Shqipëri vitet e fundit. Duke qenë kryeqyteti i Shqipërisë, Tirana është kthyer në një qendër kryesore për aktivitetet sipërmarrëse, duke përfutur nga vendndodhja e saj qendrore, urbanizimi dhe një ekonomi në rritje. Në Tiranë organizohen rregullisht një sërë eventesh që kanë në fokus mbështetjen e start-up-ëve si Tirana Tech Summit, Innovation Fest, Innvest Summit, etj.

Ekosistemi fillestar i Tiranës ishte në rritje, i nxitur nga disa faktorë të tillë si aksesin në financim, politikat mbështetëse të qeverisë, prania e hapësirave të bashkëpunimit dhe ngjarjet që nxitën një mjedis të favorshëm për sipërmarrjet fillestare. Start-upet e para në Tiranë ishin kryesisht të përqendruara tek teknologjia dhe të përqendruara rreth inovacionit. Sipërmarrësit po shfrytëzonin përparimet në teknologji për të zhvilluar zgjidhje për industri të ndryshme, duke përfshirë fintech, tregtinë elektronike, teknologjinë shëndetësore dhe arsimin.

Bashkia Tiranë ka ofruar prej vitesh një sërë shërbimesh lehtësuese për startup-et. Kështu, BT ka publikuar në faqen e internetit një seksion të veçantë mbi "Ekonominë dhe Biznesin" ku mund të aksesohen një numër i madh udhëzuesish për startup-et, ku mund të përmenden:

- Udhëzues për startup;
- Guide informuese mbi ekosistemin e startup-ëve në Tiranë;
- Si të fillosh një biznes;
- Si të prezantosh një ide biznesi;
- Si të hartosh një plan biznesi;
- Si të bësh një studim tregu;
- Si të llogarisësh taksat dhe tatimet e një biznesi të ri, etj.

Gjithashtu, prej vitit 2021, Bashkia Tiranë ka lançuar edhe platformën **digitaltirana.al**, e cila sjell së bashku një sërë elementesh të sektorëve privatë dhe publikë për të mbështetur start-up, sipërmarrës, aktorë të ekosistemit si dhe për të dhënë një informacion gjithëpërfshirës për nomadët digjitalë. Kjo platformë ofron informacion mbi të gjithë aktorët e ekosistemit si akseleratorë, inkubatorë, investitorë dhe startup. Faqja është kryesisht informative dhe synon mbledhjen e gjithnjë e më shumë aktorëve me një qëllim primar: afrimin e investitorëve tek start-up të Tiranës.

Zhvillimet e fundit që ka ndërmarrë qeveria në lidhje me nxitjen e inovacionit përmes startup-ëve, digjitalizimit të shërbimeve dhe zhvillimin e lëndëve të kodimit tregojnë për seriozitetin e masave për t'u përballuar me këto fenomene dhe rëndësinë që i kushtohet punësimit të të rejave dhe të rinjve. Ky proces duhet të shkojë krah për krah me një proces reformimi të shërbimit të këshillimit për karrierë që i ofrohet ose nuk i ofrohet të rinjve në shkolla apo institucionet e formimit profesional.

Një ndër Start-upet më të mëdha dhe më të suksesshme të zhvilluara në Bashkinë e Tiranës është TUMO Tirana. Tirana nis një erë të re në epokën digjitale pas Parisit, Berlinit dhe Yerevanit. Bashkia e Tiranës në bashkëpunim me Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF) çelën TUMO Tirana, qendrën më të madhe të teknologjisë që synon të aftësojë të rinjtë me njohuritë e shek. të 21 duke ofruar kurrikula në fushën e inovacionit dhe artit. TUMO Tirana është një qendër pas shkolle për fëmijë të grupmoshës 12-18 vjeç të cilët do të kenë mundësinë të zbulojnë pasionin e tyre në 8 disiplina të ndryshme si Animation, Graphic Design, Game Development, Film Making, Music, Programming, Robotics, 3D Modelling. Me përfundimin e projektit të transformimit më të rëndësishëm në kryeqytet, Piramida e Tiranës, do të jetë shtëpia e përhershme e TUMO Tirana.

Gjatë vitit 2023, BT hartoi Strategjinë e Digjitalizimit dhe Inovacionit, e cila përveç digjitalizimit të shërbimeve për qytetarët dhe digjitalizimit të proceseve të brendshme të punës, ka si shtyllën e saj të tretë promovimin e inovacionit tek të rinjtë dhe ofrimin e një mbështetjeje të rëndësishme për start-upet. Krahas shumë objektivave, BT parashikon edhe krijimin e një programi të posaçëm për identifikimin e start-upeve, këshillimin e tyre si edhe mbështetjen me grante apo forma të tjera për të bërë të mundur shndërrimin e tyre në biznese të mirëfillta.

### 3.5.2 Aktivitetet Rinore

Tirana, edhe në kuadër të shpalljes së “Kryeqytetit European të Rinisë” 2022 ka ndërmarrë një sërë aktivitete për të rinjtë të cilat përfshinin gjimnazet, shkollat 9 vjeçare dhe çdo të ri tjetër të qytetit, të cilat janë kthyer në traditë dhe mbahen çdo vit. Disa prej tyre janë të listuara më poshtë:

1. Ri-vitalizimi i kinemave të qytetit, si ajo Agimi dhe Maks Velo.
2. Zhvillimin e aktiviteteve pranë Microfolie, hapësirës tashmë aktive e cila nxit krijimitarinë përmes artit dhe teknologjisë
3. Youtube Space, ofrimi i infrastrukturës për prodhime audio vizuale për të rinjtë.
4. Ngritja e zyrës së filmit në Tiranë.
5. Ngritja e një laboratorit krijues, Creative Lab
6. Ngritja e panairit të industrisë kreative urbane, “PIKU”.
7. Edukimi përmes artit.
8. Krijimi i një platforme online për puntorët dhe sipërmarrësit e industrisë kreative.

Bashkia e Tiranës ofron një game të gjerë aktivitete për të rinjtë, ndër më të fundit mund të përmendim: “Festën e Verës”, “Tirana e Fëmijëve” Panairi i Produkteve dhe Shërbimeve për Fëmijë, Festën e Miqësisë etj.

Kalendari i eventeve për vitin 2023 përfshin:

- 11 Shkurt - Tirana 103 vjet Kryeqytet
- 14 Shkurt - Tirana Loves
- 14 Mars - Dita e Verës
- 22 Mars - Dita e Tokës
- 5 Maj - Dita e Dëshmorëve
- 1 Qershor - Dita e Fëmijëve
- 21 Qershor - Dita Ndërkombëtare e Muzikës

- 29 Shtator - Dita Kombëtare e Trashëgimisë Kulturore
- 23 Tetor - Maratona e Tiranës
- 28 Nëntor - Festa e Pavarësisë
- 29 Nëntor - Nata e Bardhë
- Dhjetor - Ndezja e Dritave të Pemës të Krishtlindjes
- 25 Dhjetor - Krishtlindje në Tiranë
- 31 Dhjetor - Nata e Vitit të Ri

### 3.5.3 Përfshirja në qeverisje

Kuvendi i Shqipërisë miratoi në vitin 2019 ligjin **Nr. 75/2019 “Për rininë”**, i cili u hartua me qëllim mbrojtjen, mbështetjen dhe garantimin e të rinjve nëpërmjet mekanizmave si Këshillat Vendorë Rinore, **Këshilli Kombëtar i Rinisë**, dhe të Organizatës Kombëtare Përfaqësuese Rinore. Ky ligj ka për qëllim përcaktimin e veprimtarive, të mekanizmave dhe të autoriteteve përgjegjëse për mbrojtjen dhe promovimin e të rinjve në Republikën e Shqipërisë. Ky ligj detyron çdo Bashki që të parashikojë në strukturat e saj ngritjen e drejtorisë së rinisë. Ky detyrim ligjor e bën pushtetin vendor të ketë një vëmendje të shtuar tek rinia dhe përkthehet në veprime konkrete duke mandatuar stafin që do të kenë në detyrë hartimin e strategjisë lokale për të rinjtë. Megjithatë, lidhur me pjesëmarrjen politike në Shqipëri, të dhënat tregojnë se ka një përqindje të ulët të të rinjve në pozicione ekzekutive si ministra, zëvendësministra në qeveri dhe në pushtetin vendor. Megjithatë, strategjitë dhe planet kryesore për përfshirjen sociale dhe ekonomike të të rinjve, vitet e fundit në Shqipëri janë ndikuar nga politikat dhe kuadri evropian.

Ligji për Rininë i vitit 2019, parashikonte edhe zhvillimin e një institucioni i cili do të ishte përgjegjës për zbatimin e politikave rinore. Ky institucion është **Agjencia Kombëtare Rinore**, aktiviteti i së cilës rregullohet si me ligjin për rininë ashtu edhe me një grup vendimesh qeveritare (VKM).

Në kuadër të plotësimit të qëllimeve dhe masave të Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029 për fuqizimin e zërit të të rinjve në procesin e vendimmarrjes lokale, janë ngritur strukturat e **Këshillave Vendorë Rinorë** në 59 bashki nga 61 në total, për t’ju ardhur në ndihmë të rinjve të çdo qyteti për të përcjellë kërkesat e tyre pranë bashkisë përkatëse, duke fuqizuar kështu zërin e tyre në proceset vendimmarrëse lokale.

Një formë tjetër e përfshirjes në qeverisje është edhe iniciativa e qeverisë përmes **praktikave të punësimit në administratë**. Forcimi i kapaciteteve brenda administratës për t’iu përgjigjur kërkesave të të rejave dhe të rinjve me zbatim politikash për ta duke siguruar edhe shërbime miqësore kundrejt tyre mbetet ende një sfidë edhe pse ekziston nisma që një e treta e vendeve të punës në administratën publike duhet të përmbushen nga të rinjtë. Edhe pse janë bërë hapa të mëdha përpara për angazhimin e të rejave dhe të rinjve pranë proceseve politikë-bërëse si me anë të stazheve profesionale apo kontratave të punësimit çështjet e marrjes dhe dhënies së informacioneve në lidhje me programet e punësimit apo nxitjes së punësimit mbeten problematike. Kjo në një kohë kur qeveria ka marrë një sërë masash dhe politikash për të nxitur punësimin dhe inovacionin mes të rejave dhe të rinjve, politika që nga të rinjtë dhe të rejtat që morën pjesë në konsultimet e bëra me ta në kuadër të kësaj strategjie nuk njiheshin.

Pjesëmarrja politike e të rinjve në Shqipëri ka qenë një temë e rëndësishme dhe me interes, veçanërisht pasi vendi po punon drejt konsolidimit të institucioneve dhe proceseve të tij demokratike. Ashtu si në shumë vende të tjera, angazhimi i të rinjve në politikë ka sfida dhe mundësi.

## 4. Vizioni dhe Objektivat

### 4.1. Deklarata e Vizionit

Tirana, një qytet i jetueshëm dhe i aksesueshëm falë përmirësimit të infrastrukturës publike në nivel kapilar; një qytet që zhvillohet në mënyrë të qëndrueshme duke ruajtur ekuilibrat mes zhvillimit ekonomik dhe zhvillimit social, mbrojtjes së mjedisit dhe adaptimit ndaj ndryshimeve klimatike; një qytet gjithëpërfshirës që priorizon ndërtimin e një mjedisi të sigurt për zhvillimin e pjesëmarrjen e të rinjve dhe që garanton mbrojtje dhe përkujdesje për grupet në nevojë.

### 4.2. Qëllimet Strategjike

**Qëllimi Strategjik 1:** Zgjerimi dhe përmirësimi i infrastrukturës publike në nivel kapilar dhe lagjet e reja për një Tiranë më të aksesueshme dhe gjithëpërfshirëse.

**Qëllimi Strategjik 2:** Zhvillim ekonomik i qëndrueshëm që siguron ekuilibër të njëkohshëm të veprimtarive ekonomike, sociale dhe mjedisore.

**Qëllimi Strategjik 3:** Zhvillimi i Tiranës në një bashki më standard europian të jetesës, të gjelbër dhe të përgatitur për të përballuar ndryshimet, përfshi ato klimaterike.

**Qëllimi Strategjik 4:** Përmirësim i sistemit të shërbimeve shoqërore që siguron mbrojtje, zhvillim, pavarësi dhe lehtësi pjesëmarrjeje në jetën e komunitetit.

**Qëllimi Strategjik 5:** Investim afatgjatë për rininë duke krijuar një mjedis të sigurt social dhe ekonomik, për një rini aktive dhe me akses të barabartë në të gjitha fushat e jetës dhe me status të konsoliduar për të ardhmen e tyre.

### 4.3. Objektivat Strategjike

**Qëllimi Strategjik 1:** Zgjerimi dhe përmirësimi i infrastrukturës publike në nivel kapilar dhe lagjet e reja për një Tiranë më të aksesueshme dhe gjithëpërfshirëse

**OS1M1:** Rehabilitim dhe Mobilim infrastrukturor në partneritet me komunitetin për të profilizuar fizionominë e Tiranës Policentrike në të paktën 7 qendra brenda vitit 2025;

**OS1M2:** Sigurimi i furnizimit të pandërprerë me ujë të pijshëm (24/7) për të përmbushur nevojat e qytetarëve dhe sistem i përmirësuar i grumbullimit, trajtimit dhe largimit të ujërave të ndotura për të paktën 30% të popullsisë të Tiranës brenda vitit 2027;

**OS1M3:** Përmirësimi i shërbimit të transportit publik duke rritur shpejtësinë e lëvizjes në 20 km/h duke rritur me 100% kapacitetin e transportit të udhëtarëve dhe duke rinovuar flotën me autobusë elektrikë për të paktën 3 linja deri në vitin 2027;

**OS1M4:** Përmirësimi i organizimit të transportit ndërurban dhe rrethqytetas duke bërë operacionale 2 Terminalet dhe Stacionin e Tiranës deri në fund të vitit 2027;

**OS1M5:** Përmirësimi i shërbimit të parkimit publik duke shtuar të paktën 1,500 vendparkime të në sheshe reja dhe duke favorizuar zgjidhjet inovative në informacion dhe kontrollin e territorit deri në fund të 2027;

**OS1M6:** Infrastrukturë arsimore dhe akomoduese e përmirësuar përmes ndërtimit të 13 shkollave dhe 22 kopshteve e çerdheve të reja si edhe ndërtimit të 3 godinave të konvikteve e rikonstruksionit të 19 godinave të tjera deri në fund të vitit 2027.

**Qëllimi Strategjik 2:** Zhvillim ekonomik i qëndrueshëm që siguron ekuilibër të njëkohshëm të veprimtarive ekonomike, sociale dhe mjedisore

**OS2M1:** Rritja e investimeve të huaja me të paktën 50% duke përmirësuar konkurrueshmërinë përmes përfundimit të punimeve në TEDA Tirana dhe Teknoparkut si edhe zhvillimit të rrjeteve lidhëse kombëtare dhe ndërkombëtare deri në fund të vitit 2027;

**OS2M2:** Mbështetja dhe orientimi i bizneseve vendore drejt artizanatit, inovacionit dhe teknologjive miqësore me mjedisin duke synuar mbështetjen e të paktën 100 bizneseve në vit deri në fund të vitit 2025;

**OS2M3:** Administrimi, formalizimi dhe mbrojtja e tokave bujqësore e fondit pyjor, përmes krijimit të Regjistrisë Digjital të Fermerëve, përditësimit të Regjistrisë të Pyjeve dhe përmirësimit të aksesit në treg deri në fund të vitit 2025;

**OS2M4:** Ngritja e sistemit vendor të informacionit dhe këshillimit bujqësor duke synuar këshillimin e të paktën 3 mijë fermerëve në vit, si dhe mbështetjen e fermerëve nëpërmjet skemave të granteve për zhvillimin rural duke synuar mbështetjen e të paktën 200 fermerëve në vit deri në fund të vitit 2025;

**OS2M5:** Nxitja e programeve të formimit dhe aftësisimit për punë në përputhje me kërkesat e tregut si për të rinjtë dhe për të rriturit me qëllim trajnimin e të paktën 500 individëve në vit deri në fund të vitit 2025

**OS2M6:** Forcimi i financave vendore duke rritur të ardhurat me 20% dhe investimet publike me 30% deri në fund të vitit 2027

**OS2M7:** Nxitjen e industrisë së turizmit urban dhe atij rural përmes përmirësimit të cilësisë dhe sasisë së shërbimeve dhe informacionit për ta, duke synuar rritjen me të paktën 50% të numrit të turistëve që vizitojnë Tiranën deri në fund të vitit 2027;

**OS2M8:** Zhvillimi i turizmit të biznesit (MICE), përmes hartimit të një strategjie sektoriale për orientimin e tij si edhe përmes ndërtimit të Qendrës së Konventave dhe Ekspozitave dhe Qendrës Ndërkombëtare të Panairëve deri në fund të vitit 2027.

**Qëllimi Strategjik 3:** Zhvillimi i Tiranës në një bashki më standard europian të jetesës, të gjelbër dhe të përgatitur për të përballuar ndryshimet, përfshi ato klimaterike

**OS3M1:** Rigjenerim dhe transformim urban më qëllim rritjen e cilësisë së jetesës, duke rehabilituar 100 blloqe banimi, asfaltuar 750,000 m<sup>2</sup> rrugë, shtruar 40,000 m<sup>2</sup> trotuare dhe pajisur me ndriçim LED 40,000 pika deri në fund të vitit 2027.

**OS3M2:** Përmirësimi i sistemit dhe instrumentave për mirëmenaxhimin e emergjencave natyrore, si edhe infrastrukturës kritike me qëllim rritjen e nivelit të qëndrueshmërisë së qytetit kundër ndikimeve dhe pasojave të ndryshimeve klimaterike dhe fatkeqësive natyrore;

**OS3M3:** Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të mbetjeve të ngurta urbane duke zëvendësuar të gjithë kontenierët me teknologjinë këmbanë e duke ngritur programe për nxitjen e ekonomisë qarkulluese duke synuar riciklimin e të paktën 20% të mbetjeve deri në fund të vitit 2027;

**OS3M4:** Shtimi me të paktën 20% i sipërfaqes së gjelbër dhe reduktimi i gjurmës së karbonit për të paktën 35 objekte publike duke vendosur panele diellore në tarracat e tyre deri në fund të vitit 2027;

**OS3M5:** Avancimi i qeverisjes së mirë e transparente, duke digjitalizuar 90% të shërbimeve administrative të ofruara për qytetarët dhe duke investuar në digjitalizimin e procesve të brendshme të punës deri në fund të vitit 2027;

**OS3M6:** Rigjallërimi i jetës artistike e kulturore duke synuar që deri në fund të vitit 2027 Tiranës t'i jenë shtuar të paktën 6 hapësira/objekte artistike-kulturore;

**OS3M7:** Shtimi i hapësirave sportive me 100 fusha të reja si edhe përfundimi i punimeve për rikonstruksionin e plotë të Stadiumit Selman Stërmasi dhe Pallatit të Sportit Asllan Rusi deri në fund të vitit 2027.

**Qëllimi Strategjik 4:** Përmirësim i sistemit të shërbimeve shoqërore që siguron mbrojtje, zhvillim, pavarësi dhe lehtësi pjesëmarrjeje në jetën e komunitetit

**OS4M1:** Krijimi i programeve favorizuese për familjet në nevojë duke ofruar një mbështetje shtesë përmes “bonusit social” për 2,800 familje dhe duke mbështetur e orientuar drejt punësimit të paktën 100 familje në vit deri në fund të vitit 2026;

**OS4M2:** Ngritja e të paktën 6 qendrave komunitare për fëmijet dhe familjen deri në fund të vitit 2027;

**OS4M3:** Diversifikim i programeve vendore me një qasje drejt strehimit social të përballueshëm duke synuar që deri në fund të vitit 2027 numri vjetor i familjeve përfituese të jetë rritur nga rreth 1,000 në mbi 1,500 familje;

**OS4M4:** Rritje e përgjegjshmërisë dhe transparencës për barazinë dhe integrimin gjinor në nivel vendor dhe mbështetje financiare për zhvillimin profesional të grave;

**OS4M5:** Fuqizimi dhe rritja e efikasitetit të mekanizmave veprues dhe qasjeve ndërsektoriale të koordinuara kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, duke synuar rritjen me 15% të rasteve të identifikuar dhe trajtuara deri në fund të vitit 2027;

**OS4M6:** Përfundimi i procesit të rindërtimit dhe strehimi i të paktën 7,000 banorëve deri në fund të vitit 2026.

**Qëllimi Strategjik 5:** Investim afatgjatë për rininë duke zhvilluar politika dhe infrastrukturë që sigurojnë një mjedis të sigurt social dhe ekonomik, për një rini aktive dhe me akses të barabartë

**OS5M1:** Ngritja dhe sigurimi i qëndrueshmërisë së shërbimeve të përkujdesit social që ofrojnë shërbimet vendore për të rinjtë dhe kategoritë në nevojë duke rritur me të paktën 25% kapacitetin ofrues të këtyre shërbimeve deri në vitin 2026;

**OS5M2:** Mbështetje financiare e nismave rinore për të nxitur punësimin dhe vëtpunësimin si dhe rritja e kapaciteteve për tu integruar sa më mirë në tregun e punës duke synuar punësimin e të paktën 1,000 të rinjve deri në vitin 2027;

**OS5M3:** Ngritja e një programi special për identifikimin, mbështetjen dhe promovimin e start-upeve duke synuar shndërrimin e 50 prej tyre në biznese të mirëfillta deri në fund të vitit 2027;

**OS5M4:** Rritja me të paktën 20% e shkollave pjesë e projektit “shkolla si qendër komunitare” dhe nxitja e zhvillimit edhe të aktiviteteve socio-kulturale të gjithë territorin e Bashkisë Tiranë deri në fund të vitit 2027;

**OS5M5:** Pjesëmarrja dhe aktivizimi i të paktën 1,000 të rinjve në proceset e vendimarrjes vendore dhe aktivitetet vullnetare deri në fund të vitit 2027.



## 5. Masat dhe Projektet

Objektivi i Pergjithshem	Objektivat Specifike	Programet	Projektet
<b>1. Zgjerimi dhe Përmirësimi i Infrastrukturës publike në nivel kapilar dhe lagjet e reja për një Tiranë më të aksesueshme dhe gjithpërfshirëse</b>			
<b>1.1</b> Rehabilitim dhe Mobilim infrastrukturor në partneritet me komunitetin për të profilizuar fizionominë e Tiranës Policentrike në të paktën 7 qendra brenda vitit 2025.	Tirana policentrike		<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Përfundimi i punimeve në KombinArt;</li> <li>2. Përfundimi i punimeve në Lagjen e Artistëve;</li> <li>3. Implementimi i projektit të kampusit të UT;</li> <li>4. Përfundimi i punimeve në Lagjen e re 5 Maji;</li> <li>5. Përfundimi i punimeve në Lagjen e re Autotraktori;</li> <li>6. Rikonstruksioni dhe rivitalizimi i Parkut Botanik.</li> </ol>
	Mobilim infrastrukturor në partneritet me komunitetin		<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Rritja e buxhetit me 40% dhe financimi i më shumë ndërhyrjeve përmes programit „Fondi i Komunitetit”;</li> <li>2. Identifikimi dhe implementimi i instrumentave të reja për ndërhyrjet në partneritet me komunitetin.</li> </ol>
<b>1.2</b> Sigurimi i furnizimit të pandërprerë me ujë të pijshëm (24/7) për të përmbushur nevojat e qytetarëve dhe sistem i përmirësuar i grumbullimit, trajtimit dhe largimit të ujërave të ndotura për të paktën 30% të popullsisë të Tiranës brenda vitit 2027.	Furnizimi me ujë të pijshëm		<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ndërtimi i unazës së presionit;</li> <li>2. Ndërtimi i zonave të konsumit;</li> <li>3. Implementimit i Sistemit SCADA;</li> <li>4. Ndërtim Tubacion Transmetimi Basen Presioni- Tunel- Partitar-DepoDaia;</li> <li>5. Shtesë në Impiantin e përpunimit të ujit të pijshëm;</li> <li>6. Furnizim me Ujë për zonën Autostradë-Tiranë.</li> </ol>
	Trajtimi i ujërave të ndotura		<ol style="list-style-type: none"> <li>1.</li> </ol>
<b>1.3</b> Përmirësimi i shërbimit të transportit publik duke rritur shpejtësinë e lëvizjes në 20 km/h, duke rritur me 100% kapacitetin e transportit të udhëtarëve dhe duke rinovuar flotën me autobusë elektrike për të paktën 3 linja deri në vitin 2027;	Përmirësimi i shërbimit të transportit publik		<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Implementimi i sistemit BRT në tre linjat kryesore të Tiranës;</li> <li>2. Përfundimi i punimeve në hekurudhën Tiranë-Rinas-Durrës;</li> <li>3. Flotë elektrike autobusash për tre linjat BRT;</li> <li>4. Studimi i mundësive për të rritur madhësinë e flotës dhe për të rritur kapacitetin total të transportit;</li> <li>5. Zgjerimi i hartës së korsive të dedikuara për transportin publik;</li> </ol>
<b>1.4</b> Përmirësimi i organizimit të transportit ndërurban dhe rrethqytetas duke bërë operacionale 2 Terminalet dhe Stacionin e Tiranës deri në fund të vitit 2027;	Përmirësimi i infrastrukturës së transportit publik		<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ndërtimi dhe funksionimi i terminaleve të transportit ndër-qytetas dhe lidhja me transportin urban;</li> <li>2. Ndërtimi i stacionit të trenit;</li> <li>3. Ndërtimi i një stacioni kryesor në zonën qendrore të Tiranës.</li> </ol>
	Përmirësimi i aksesit në transport		<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Vendosja e informacionit mbi udhëtimin dhe lidhjet me linjat e tjera në çdo stacion autobusi;</li> <li>2. Mbulimi më i mirë i territorit me shërbimin e transportit duke riorganizuar linjat ekzistuese ose duke shtuar linja të reja;</li> <li>3. Implementimi i biletës elektronike;</li> </ol>

1.5 Përmirësimi i shërbimit të parkimit publik duke shtuar të paktën 1,500 vendparkime të në sheshe reja dhe duke favorizuar zgjidhjet inovative në informacion dhe kontrollin e territorit deri në fund të 2027;	Zgjerimi i shërbimit të parkimit publik	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Shtrirja e shërbimit të parkimit publik me pagesë në 39 rrugë të reja;</li> <li>2. Shtrirja e shërbimit të parkimit për rezidentë në 47 blloqe banimi;</li> <li>3. Ndërtimi i 10 shesheve të reja të parkimit ne zona me nevojë të lartë;</li> <li>4. Ndërtimi i parkimeve të reja përgjatë unazës së mesme;</li> <li>5. Ndryshimi i hartës tarifore;</li> <li>6. Rikonceptimi i Zonave të Administrimit të Parkimit.</li> </ol>
	Modernizimi i shërbimeve të parkimit publik me pagesë	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ngritja e sistemit për informimin në kohë reale mbi vendet e lira të parkimit;</li> <li>2. Metoda inovative për monitorimin e parkimit me pagesë në rrugë;</li> <li>3. Zhvillimi i aplikacionit për parkimet.</li> <li>4. Mundësimi i disa metodave për pagesën e parkimit.</li> </ol>
1.6 Infrastrukturë arsimore dhe akomoduese e përmirësuar përmes ndërtimit të 13 shkollave dhe 22 kopshteve e çerdheve të reja si edhe ndërtimit të 3 godinave të konvikteve e rikonstruksionit të 19 godinave të tjera deri në fund të vitit 2027.	Modernizimi i infrastrukturës së arsimit parashkollor	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ndërtimi i 22 çerdheve dhe kopshteve të reja;</li> <li>2. Rikonstruksioni i plotë</li> </ol>
	Modernizimi i infrastrukturës së arsimit shkollor	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ndërtimi i 8 shkollave të reja, 6 shkolla 9-vjeçare dhe 2 shkolla të mesme, përmes skemës së Konkensionit/PPP;</li> <li>2. Ndërtimi i 7 shkollave të reja përmes fondeve të vetë bashkisë ose me ndihmën e donatorëve;</li> <li>3. Rikonstruksioni i plotë i x shkollave;</li> <li>4.</li> </ol>
	Modernizimi i infrastrukturës së arsimit universitar	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Implementimi i projektit të kampusit të UT.</li> <li>2. Rikonstruksioni i plotë i të gjitha rezidencave studentore në Qytetin Studenti</li> </ol>
<b>2. Zhvillim ekonomik i qëndrueshëm që siguron ekuilibër të njëkohshëm të të veprimtarive ekonomike, sociale dhe mjedisore.</b>		
2.1 Rritja e investimeve të huaja me të paktën 50% duke përmirësuar konkurueshmërinë përmes përfundimit të punimeve në TEDA Tirana dhe Teknoparkut si edhe zhvillimit të rrjeteve lidhëse kombëtare dhe ndërkombëtare deri në fund të vitit 2027;	Infrastruktura për tërheqjen e investimeve të huaja	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Përfundimi i infrastrukturës së TEDA Tirana dhe hapja e saj;</li> <li>2. Përgatitja e një Plani për Tërheqjen e Investitorëve në TEDA Tirana;</li> <li>3. Ndërtimi dhe funksioni i Teknoparkut;</li> <li>4. Hartimi dhe publikimi i nje pakete informuese për legjislacionin shqiptar në fushën e investimeve dhe mbi mundësinë e investimit në Tiranë;</li> </ol>
	Promovimi i Tiranës si një destinacion investimesh	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Prodhimi dhe shpërndarja e një pakete promovuese dhe informuese „Welcome to Tirana“ në 5 gjuhë me informacion mbi shërbimet dhe protokollin administrativ për të huajt;</li> <li>2. Ngritja e një programi këshillimi për investitorët e huaj;</li> <li>3. Pjesëmarrja në panairë ndërkombëtare të fokusuara tek investimet;</li> <li>4. Zhvillimi i një konference vjetore me investitorët potenciale të huaj;</li> </ol>

<p><b>2.2</b> Mbështetja dhe orientimi i bizneseve vendore drejt artizanatit, inovacionit dhe teknologjive miqësore me mjedisin duke synuar mbështetjen e të paktën 100 bizneseve në vit deri në fund të vitit 2025;</p>	<p>Mbështetje për artizanatin</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Mbështetje në përfshirjen dhe fuqizimin e grave në zhvillimin e zinxhirit të vlerës së artizanatit në Farkë;</li> <li>2. Skemë grantesh për artizanët;</li> <li>3. Lehtësim për daljen në treg të produkteve artizanale;</li> <li>4. Promovimi i artizanatit duke e përfshirë në guidat turistike;</li> </ol>
	<p>Mbështetje për biznesin miqësor me mjedisin</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Program mbështetjeje për industrinë e riciklimit;</li> <li>2. Ngritja e një skeme për subvencionimin e paketimeve miqësore me mjedisin për ushqimin e shpejtë dhe delivery;</li> <li>3. Ngritja e një skeme për identifikimin dhe mbështetjen e dizajneve ekologjike për produktet e konsumueshme;</li> </ol>
<p><b>2.3</b> Administrimi, formalizimi dhe mbrojtja e tokave bujqësore e fondit pyjor, përmes krijimit të Regjistrit Digjital të Fermerëve, përditësimit të Regjistrit të Pyjeve deri në fund të vitit 2025;</p>	<p>Mbrojtja e tokës bujqësore</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ngritja dhe përditësimi i përvitshëm i Regjistrit Digjital të Fermerëve të Tiranës;</li> <li>2.</li> </ol>
	<p>Mbrojtja e pyejeve</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Përditësimi i kadastrës së pyjeve dhe nxjerra nga fondi pyjor i sipërfaqeve të cilave u ka ndryshuar destinacioni;</li> <li>2. Hartimi dhe Miratimi i Planeve të Mbarëshimit për të gjitha ekonomitë pyjore të Bashkisë Tiranë;</li> <li>3. Iniciativa për ripyllëzimin e zonave të dëmtuara.</li> </ol>
<p><b>2.4</b> Ngritja e sistemit vendor të informacionit dhe këshillimit bujqësor duke synuar këshillimin e të paktën 3 mijë fermerëve në vit, si dhe mbështetje e fermerëve nëpërmjet skemave të granteve për zhvillimin rural duke synuar mbështetjen e të paktën 200 fermerëve në vit deri në fund të vitit 2025;</p>	<p>Këshillimi bujqësor</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ngritja dhe formalizimi i skemës së këshillimit bujqësor, duke përfshirë programin, kurrikulat dhe kalendarin;</li> <li>2. Ngritja e një program special që do të mundësonte kontakt periodik mes fermerëve dhe grumbulluesve;</li> </ol>
	<p>Mbështetje për fermerët</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ngritja e një skeme grantesh të administruar nga BT për mbështetjen e zhvillimit bujqësor;</li> <li>2. Identifikimi dhe implementimi i një “Pakti Territorial i Punësimit” në një fshat apo NJA rurale çdo vit;</li> <li>3. Përfundimi i punimeve në Agregatorin Bujqësor të Tiranës;</li> <li>4. Fuqizimi i Tirana Agrikulturë duke synuar jo vetëm tregtimin por edhe grumbullimin e produkteve bujqësore e blegtorale;</li> </ol>
<p><b>2.5</b> Nxitja e programeve të formimit dhe aftësisimit për punë në përputhje me kërkesat e tregut si për të rinjtë dhe për të rriturit me qëllim trajnimin e të paktën 500 individëve në vit deri në fund të vitit 2025;</p>	<p>Programi i nxitjes së punësimit</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Sistemi Informatik i nxitjes së Punësimit;</li> <li>2. Programi i Nxitjes së Punësimit “Fuqizimi i të rinjve dhe të reja”;;</li> <li>3. Programi i Nxitjes së punësimit “Fuqizimi i Grave Sipërmarrëse”;</li> <li>4. Pakti Territorial i Punësimit;</li> <li>5. Fushatë ndërgjegjësuese për të nxitur studentët drejt punësimit sezonal në verë.</li> </ol>
	<p>Programi i aftësisimit për në punë</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ngritja e një programi për trajnimin e të rinjve që nuk janë as në punë e as në edukim mbi aftësitë që kërkon tregu;</li> <li>2. Implementimi i përvitshëm i programit “fillo me një ide, fito një internship”;</li> </ol>

		<ol style="list-style-type: none"> <li>Identifikimi i të gjitha mundësive për internship në Tiranë, të ofruara si nga sektori publik ashtu dhe nga ai privat dhe përfshirja e tyre në një portal unik;</li> <li>Ngritja e një programi për subvencionimin e „trajnitimit në punë” për të rinjtë që dëshirojnë të marrin një zanat;</li> </ol>
2.6 Forcimi i financave vendore duke rritur të ardhurat me 20% dhe investimet publike me 30% deri në fund të vitit 2027;	Rritja e të ardhurave	<ol style="list-style-type: none"> <li>Rritja e të ardhurave me 20% përmes mire-administrimit dhe kontrollit më të mirë të territorit;</li> <li>Rritja e investimeve me të paktën 30%;</li> </ol>
	Konsolidimi i shpenzimeve	<ol style="list-style-type: none"> <li>Konsolidimi i shpenzimeve operationale përmes standartizimit dhe miratimit të protokolleve të mirëmbajtjes.</li> </ol>
2.7 Nxitjen e industrisë së turizmit urban dhe atij rural përmes përmirësimit të cilësisë dhe sasisë e shërbimeve dhe informacionit për ta, duke synuar rritjen me të paktën 50% të numrit të turistëve që vizitojnë Tiranën deri në fund të vitit 2027;	Nxitja e zhvillimit të industrisë së turizmit	<ol style="list-style-type: none"> <li>Hartimi dhe Miratimi i Strategjise Vendore të Turizmit;</li> <li>Ngritja dhe funksionimi i DMO Tirana (destination management organization);</li> <li>Riformatimi i aplikacionit TIO (Tirana Ime Outdoor);</li> <li>Prodhimi dhe brandimi i produkteve artizanale në zona të ndryshme të Tiranës;</li> <li>Hapja e pikave zyrtare të shitjes së suvenireve në zonat qendrore të Tiranës;</li> <li>Hartimi dhe miratimi Strategjise dhe Planit të Veprimit për Tirana Urban Food.</li> </ol>
	Promovimi i Tiranës si një destinacion turistik	<ol style="list-style-type: none"> <li>Hartimi dhe prodhimi i materialeve informuese për turistët e huaj;</li> <li>Hartimi dhe prodhimi i të paktën 5 guidave turistike të reja;</li> <li>Hartimi, digitalizimi dhe prodhimi i guidave për transportin publik;</li> <li>Botimi i artikujve promovues në media me impakt botëror;</li> <li>Pjesëmarrja në panaiet tematike të turizmit</li> </ol>
2.8 Zhvillimi i turizmit të biznesit (MICE), përmes hartimit të një strategjie sektoriale për orientimin e tij si edhe përmes ndërtimit të Qendrës së Konventave dhe Ekspozitave dhe Qendrës Ndërkombëtare të Panaiereve deri në fund të vitit 2027.	Politikat për zhvillimin e turizmit të biznesit	<ol style="list-style-type: none"> <li>Hartimi dhe miratimi i Planit të Veprimit për zhvillimin e industrisë MICE (takimet, konferencat, panaiet), në bashkërendim me sektorët e turizmit, transportit dhe industrinë e shërbimeve;</li> <li>Promovimi i Tiranës si një destinacion për turizmin e biznesit;</li> </ol>
	Zhvillimi i infrastrukturës për nxitjen e turizmit të biznesit	<ol style="list-style-type: none"> <li>Ndërtimi i Qendrës së Panaiereve;</li> <li>Ndërtimi i Qendrës së Eventeve dhe Konferencave.</li> </ol>
<b>3. Zhvillimi i Tiranës në një bashki me standard europian të jetesës, të gjelbër dhe të përgatitur për të përballuar ndryshimet, përfshi ato klimaterike.</b>		
3.1 Rigjenerim dhe transformim urban më qëllim rritjen e cilësisë së jetesës, duke rehabilituar 100 blloqe banimi, asfaltuar 750,000 m <sup>2</sup> rrugë, shtruar 40,000 m <sup>2</sup> trotuare dhe pajisur me ndriçim LED 40,000 pika deri në fund të vitit 2027.	Rehabilitimi i blloqeve të banimit	<ol style="list-style-type: none"> <li>Rehabilitimi dhe rikualifikimi, çdo vit, i 25 blloqeve të banimit me infrastrukturën përkatëse nëntokësore, si dhe me rehabilitimin e shesheve e hapësirave të lira në to;</li> <li>50 ndërhyrje të reja në zonat rurale në rrugë, sheshe, qendrave të njësisë administrative rurale.</li> </ol>

	Rikonstruksioni i rrugëve dhe trotuareve	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Shtrimi i 600,000 m<sup>2</sup> rrugë me asfalt në vit në zonat urbane dhe 150,000 m<sup>2</sup> në zonat rurale.</li> <li>2. Shtrimi i 40,000 m<sup>2</sup> trotuare në vit.</li> <li>3. Rehabilitimi i Lanës;</li> </ol>
	Zgjerimi dhe modernizimi i ndriçimit publik	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kalimi i ndriçimit të qytetit në LED dhe SMART për 40,000 pika;</li> <li>2. Zgjerimi i sipërfaqes së mbuluar me ndriçim publik me 10%.</li> </ol>
<b>3.2</b> Përmirësimi i sistemit dhe instrumentave për mirëmenaxhimin e emergjencave natyrore, si edhe infrastrukturës kritike me qëllim rritjen e nivelit të qendrueshmërisë së qytetit kundër ndikimeve dhe pasojave të ndryshimeve klimaterike dhe fatkeqësive natyrore;	Mirëmenaxhimi i emergjencave natyrore	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Hartimi dhe miratimi i një plani veprimi për emergjencat civile;</li> <li>2. Hartimi dhe miratimi i një plani veprimi për fatkeqësitë natyrore;</li> </ol>
	Adaptimi ndaj ndryshimeve klimaterike	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Hartimi dhe miratimi i një plani veprimi për ndryshimet klimaterike;</li> <li>2.</li> </ol>
<b>3.3</b> Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të mbetjeve të ngurta urbane duke zëvendësuar të gjithë kontenierët me teknologjinë këmbanë e duke ngritur programe për nxitjen e ekonomisë qarkulluese duke synuar ricikilimin e të paktën 20% të mbetjeve deri në fund të vitit 2027;	Nxitja e ekonomisë qarkulluese	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ngritja e një skeme mbështetëse për ekonominë qarkulluese.</li> </ol>
	Përmirësimi i infrastrukturës së menaxhimit të mbetjeve	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Zëvendësimi i të gjithë kontenierëve të mbetjeve me teknologjinë këmbanë;</li> <li>2. Shtimi i kontejnerëve nëntokësorë në zonat qendrore të Tiranës;</li> </ol>
<b>3.4</b> Shtimi me të paktën 20% i sipërfaqes së gjelbër dhe reduktimi i gjurmës së karbonit për të paktën 35 objekte publike duke vendosur panele diellore në tarracat e tyre deri në fund të vitit 2027;	Reduktimi i gjurmës së karbonit në objektet publike	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Vendosja e impianteve fotovoltaike në 35 objekte publike;</li> <li>2. Vendosja e impiantit lundruar në Liqenin e Bovillës;</li> <li>3. Vendosja e një impianti fotovoltaike në digën e Liqenit të Farkës</li> </ol>
	Shtimi i hapësirave të gjelbra	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Mbjellja e 1 milion pemëve;</li> <li>2. Identifikimi dhe rehabilitimi i 10 “pocket parks” çdo vit;</li> <li>3.</li> </ol>
<b>3.5</b> Avancimi i qeverisjes së mirë e transparente, duke digjitalizuar 90% të shërbimeve administrative të ofruara për qytetarët dhe duke investuar në digjitalizimin e procesve të brendshme të punës deri në fund të vitit 2027	Digjitalizimi i shërbimeve	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Studim Fizibiliteti për riinxhinierizimin e shërbimeve;</li> <li>2. Digjitalizimi i proceseve të ofrimit të shërbimeve administrative;</li> <li>3. Platforma për digjitalizimin e procesit të regjistrimit të fëmijëve në kopshte dhe çerdhe.</li> <li>4. Ndërtimi i aplikacionit të ri ‘eTirana’;</li> <li>5. Hartimi i planit të veprimi për sigurinë kibernetike.</li> </ol>
	Digjitalizimi i proceseve të brendshme të punës	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. DMS për BT dhe digjitalizimi i plotë i arkivës;</li> <li>2. Sistem digjital për agjencitë inspektuese;</li> <li>3. Sistem i ri për DPTTV;</li> <li>4. Sistem digjital për organizimin dhe mbikqyrjen e punës në terren;</li> <li>5. Sistemi elektronik për të ruajtur, menaxhuar dhe ndjekur në formë elektronike informacionin e bazuar në dokumenta zyrtare;</li> <li>6. Sistem digjital për ndjekjen dhe akrimin e çështjeve drejtuar PB, IMT dhe AMK.</li> </ol>

3.6 Rigjallërimi i jetës artistike e kulturore duke synuar që deri në fund të vitit 2027 Tiranës t'i jenë shtuar të paktën 6 hapësira/objekte artistike-kulturore;	Ndërtimi i muzeumeve të reja	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ndërtimi i Muzeut të Artit Modern;</li> <li>2. Ndërtimi i Muzeut të Tiranës;</li> <li>3. Ndërtimi i Shtëpisë Muze Dritëro Agolli;</li> <li>4. Ndërtimi i fabrikës së artit;</li> </ol>
	Modernizimi i infrastrukturës së teatrove	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ndërtimi i Teatrit të Ri Kombëtar;</li> <li>2. Ndërtimi i Teatrit të ri të Kukullave;</li> <li>3. Ndërtimi i Qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijë;</li> </ol>
3.7 Shtimi i hapësirave sportive me 100 fusha të reja si edhe përfundimi i punimeve për rikonstruksionin e plotë të Stadiumit Selman Stërmasi dhe Pallatit të Sportit Asllan Rusi deri në fund të vitit 2027.	Modernizimi i infastrukturës së sportit	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Rikonstruksioni i plotë i Stadiumit Selman Stërmasi;</li> <li>2. Rikonstruksioni i plotë i Pallatit të Sportit Asllan Rusi;</li> </ol>
	Rritja e aksesit në terrenet sportive	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ndërtimi i 100 fushave sportive në lagjet e Tiranës;</li> <li>2. Zgjerimi i rrjetit të shkollave pjesë e projektit Shkola si Qender Komunitare.</li> </ol>
<b>4. Përmirësim i sistemit të shërbimeve shoqërore që siguron mbrojtje, zhvillim, pavarësi dhe lehtësi pjesëmarrjeje në jetën e komunitetit.</b>		
4.1 Krijimi i programeve favorizuese për familjet në nevojë duke ofruar një mbështetje shtesë përmes “bonusit social” për 2,800 familje dhe duke mbështetur e orientuar drejt punësimit të paktën 100 familje në vit deri në fund të vitit 2026;	Mbështetje shtesë për familjet në nevojë	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ngritja e skemës së Bonusit Social për të ofruar mbështetje shtesë për familjet në nevojë;</li> </ol>
	Mbështetje për punësimin e familjeve në nevojë	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ngritja e një program special për orientimin drejt punësimit të familjeve në nevojë;</li> <li>2.</li> </ol>
4.2 Ngritja e të paktën 6 qendrave komunitare për fëmijet dhe familjen deri në fund të vitit 2027;	Ngritja e përmirësimi qendrave komunitare	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ngritja e një qendre multifunksionale për fëmijët dhe familjen;</li> <li>2. Ngritja e 5 qendrave komunitare në 5 NJA-të me numrin më të lartë të popullsisë;</li> <li>3. Përmirësimi i mjediseve të qendrave komunitare dhe zgjerimi i stafit me fokus aftësinë e kufizuar;</li> </ol>
	Diversifikimi i shërbimeve të ofruara	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ngritja e dy ekipeve lëvizëse multidisiplinore për ofrimin e shërbimeve në shtëpi;</li> <li>2. Ofrimi i shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara në mjediset e shkollave nga një ekip lëvizës i krijuar nga qendrat ekzistuese komunitare;</li> <li>3. Fuqizimi dhe zgjerimi i shërbimit të jetesës së pavarur për personat me aftësi të kufizuara;</li> </ol>
	Qasje në strehim për grupe të pafavorizuara	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Hartëzimi i grupeve në nevojë;</li> <li>2. Ngritja e një sistemi të arritshëm informacioni për aplikim në programet e strehimit social;</li> <li>3. Ofrim i mundësive të dedikuara për grupe të ndryshme vulnerabël;</li> <li>4. Zbatimi i programit për përmirësimin e kushteve të banimit;</li> <li>5. Zhvillimi i zonës për qëllime strehimi;</li> </ol>

<p><b>4.3</b> Diversifikim i programeve vendore me një qasje drejt strehimit social të përballueshëm duke synuar që deri në fund të vitit 2027 numri vjetor i familjeve përfituese të jetë rritur nga rreth 1,000 në mbi 1,500 familje</p>		<ol style="list-style-type: none"> <li>6. Krijimi i një strehe të përkohëshme</li> <li>7. Rehabilitimi i godinave për trajtim me strehim të përshtatshëm të grupit të jetimëve;</li> <li>8. Hartimi i një akti ligjor për strehimin 100% të familjeve të dëbuara me forcë sa herë paraqiten raste të tilla;</li> <li>9. Krijimi i një fondi banesash për t'u ndarë për familjet në nevojë;</li> </ol>
	Forcimi i programeve ekzistuese të strehimit	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Rikonceptimi i skemës së kredisë së butë për çiftet e reja;</li> <li>2. Forcimi dhe zgjerimi i programit Banesa Sociale me Qera;</li> <li>3. Forcimi dhe zgjerimi i programit për Përmirësimin e Kushteve të Banimit;</li> <li>4. Rikonceptimi i Programit Banesa me Kosto të Ulët;</li> <li>5. Zbatimi i programit për Bonusin e Strehimit.</li> </ol>
	Forcimi i kapaciteteve dhe bashkëpunimit vertikal	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ngritja e kapaciteteve lokale për përdorimin e sistemit online të aplikimeve;</li> <li>2. Lehtësim i procedurave për aplikuesit e programeve sociale sipas ndryshimeve ligjore;</li> <li>3. Harmonizimi i politikave me sektorë të tjerë në funksion të strehimit social;</li> <li>4. Rishikimi i PPV me fokus sigurimin e orientimeve më favorizuese për strehimin social;</li> </ol>
<p><b>4.4</b> Rritje e përgjegjshmërisë dhe transparencës për barazinë dhe integrimin gjinor në nivel vendor dhe mbështetje financiare për zhvillimin profesional të grave</p>	Nxjtja e barazisë gjinore	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Rritja e përgjegjshmërisë dhe transparencës në përmbushjen e angazhimeve publike për barazinë gjinore, duke krijuar Komisionin e Barazisë Gjinore në Bashki;</li> <li>2. Zbatimi i detyrimeve për integrimin gjinor dhe buxhetimin e përgjithshëm gjinor në nivel vendor, sipas përcaktimeve të PVVBGJ;</li> <li>3. Edukimi i shoqërisë me parimet e barazisë gjinore, sipas përcaktimeve të PVVBGJ;</li> <li>4. Investimi në prindërtimin pozitiv, sipas përcaktimeve të PVVBGJ;</li> </ol>
	Mbështetje për zhvillimin profesional të grave	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Përshkallëzimi i veprimeve për të sfiduar stereotipet gjinore në punësim dhe për të balancuar sipas mundësive jetën profesionale me atë personale, sipas përcaktimeve të PVVBGJ;</li> <li>2. Nxjtja e sipërmarrjes dhe punësimit të grave e të reja si dhe rritja e aksesit të tyre në shërbimet e produktet financiare dhe burimet produktive, sipas përcaktimeve të PVVBGJ;</li> </ol>



<p><b>4.5</b> Fuqizimi dhe rritja e efikasitetit të mekanizmave veprues dhe qasjeve ndërsektoriale të koordinuara kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, duke synuar rritjen me 15% të rasteve të identifikuar dhe trajtuara deri në fund të vitit 2027</p>	<p>Fuqizimi i mekanizmave kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Përmirësimi i elementeve të sigurisë dhe mbrojtjes në hapësirat publike, të cilat janë miqësore dhe të përshtatura me çdo grupmoshe dhe për gjithë banorët, sipas përcaktimeve të PVVBGJ;</li> <li>2. Fuqizimi i Njësisë kundër Dhunës në Familje në bashki, duke parashikuar shtim të personelit (nr. të koordinatorëve vendorë) në përputhje me VKM 327/2021;</li> <li>3. Shtimi i punonjësve/punonjësve përgjegjës në NJA për të mbuluar detyrimet lidhur me trajtimin e rasteve të dhunës;</li> <li>4. Fuqizimi i kapacitetetëve të punonjësve/punonjësve të shtuar në NJA dhe lagje, për të trajtuar siç duhet rastet e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore;</li> <li>5. Ofrimi i shërbimeve mbështetëse dhe koordinuese për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje, dhunës ndaj fëmijëve dhe viktimave të mundshme apo viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore;</li> <li>6. Mbledhja në mënyrë sistematike dhe rregjistrimi i të dhënave për rastet e dhunës në familje në sistemin REVALB;</li> <li>7. Trajnimi i edukatoreve në çerdhe e kopshte për identifikimin dhe referimin e rasteve të fëmijëve që mund të jetojnë në familje ku ushtrohet dhunë;</li> <li>8. Mbështetja e funksionimit të shërbimeve lokale për rastet e dhunës në familje (shërbime për gratë dhe burrat e dhunuar);</li> <li>9. Mbështetja e funksionimit të shërbimeve lokale për rastet e fëmijëve të abuzuar;</li> <li>10. Mbështetja e shërbimit të riintegrit të viktimave të dhunës në familje dhe trafikimit të qenieve njerëzore.</li> </ol>
<p><b>4.6</b> Përfundimi i procesit të rindërtimit dhe strehimi i të paktën 7,000 banorëve deri në fund të vitit 2026</p>	<p>Programi i rindërtimit</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ndërtimi i 11 godinave dhe 784 apartamenteve në zonën e 5 Majit;</li> <li>2. Ndërtimi i 7 godinave dhe 1,067 apartamenteve në Zonën e Kombinatit;</li> <li>3. Përfundimi i procedurave për strehimin e 3,500 banorëve në zonën e 5 Majit dhe 3,800 banorëve në zonën e Kombinatit.</li> </ol>
<p><b>5. Investim afatgjatë për rininë duke zhvilluar politika dhe infrastrukturë që sigurojnë një mjedis të sigurt social dhe ekonomik për një rini aktive dhe me akses të barabartë</b></p>		
<p><b>5.1</b> Ngritja dhe sigurimi i qëndrueshmërisë së shërbimeve të përkujdesit social që ofrojnë shërbimet vendore për të rinjtë dhe kategoritë në nevojë duke rritur me të paktën 25% kapacitetin ofrues të këtyre shërbimeve deri në vitin 2026</p>	<p>Modernizimi i rrjetit të qendrave rinore</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ndërtimi i 3 qendrave rinore të reja;</li> <li>2. Krijimi i modeleve të menaxhimit të qendrave rinore ekzistuese dhe atyre të reja, duke përfshirë programin vjetor;</li> <li>3. Krijimi i një qendre rinore lëvizëse me fokus të rinjtë e zonave rurale.</li> </ol>
	<p>Shërbimet vendore për të rinjtë</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Hartëzimi i shërbimeve aktuale me fokus të rinjtë;</li> <li>2. Fuqizimi i programit të jetesës së pavarur për të rinjtë me aftësi të kufizuar;</li> </ol>

5.2 Mbështetje financiare e nismave rinore për të nxitur punësimin dhe vëtpunësimin si dhe rritja e kapaciteteve për t'u integruar sa më mirë në tregun e punës duke synuar punësimin e të paktën 1,000 të rinjve deri në vitin 2027	Mbështetje financiare për nismat rinore	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Skemë mbështetëse me grante për organizatat rinore sipas fushës së angazhimit;</li> <li>2. Skemë mbështetëse me grante për sipërmarrjet rinore;</li> </ol>
	Rritja e kapaciteteve të të rinjve për t'u punësuar	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Projekti i këshillimit të karrierës;</li> <li>2. Ndërmjetësimi në punësim;</li> </ol>
5.3 Ngritja e një programi special për identifikimin, mbështetjen dhe promovimin e start-upeve duke synuar shndërrimin e 50 prej tyre në biznese të mirëfillta deri në fund të vitit 2027	Skemë mbështetëse për start-up	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ngritja e një skeme mbështetëse për start-upet;</li> <li>2. Organizimi i një eventi vjetor për promovimin e start-upeve;</li> <li>3. Mbështetje me grante për startup-et;</li> <li>4. Ngritja e një program akselerimi për trajnimin dhe mentorimin e vazhdueshëm për start-upet.</li> </ol>
	Infrastrukturë ndihmëse për inovacionin dhe sipërmarrjen	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ngritja e Teknohubit;</li> <li>2. Funksionalizimi i Piramidës;</li> </ol>
5.4 Rritja me të paktën 20% e shkollave pjesë e projektit “shkolla si qendër komunitare” dhe nxitja e zhvillimit edhe të aktiviteteve socio-kulturale të gjithë territorin e Bashkisë Tiranë deri në fund të vitit 2027	Nxitja e aktiviteteve rinore	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Implementimi i përvitshëm i Tiranë Art Fest;</li> <li>2. Implementimi i Programit të Sipërmarrjes dhe Inovacionit për Gjimnazet e Tiranës;</li> <li>3. Organizimi i konkurseve me tematikë mjedisin mes të rinjve të Tiranës</li> </ol>
	Zgjerimi i programit “Shkolla si qendër komunitare”	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Implementimi i projektit “Shkolla si Qendër Komunitare” në 25 shkolla të reja</li> </ol>
5.5 Pjesëmarrja dhe aktivizimi i të paktën 1,000 të rinjve në proceset e vendimarrjes vendore dhe aktivitetet vullnetare deri në fund të vitit 2027	Përmirësimi i kuadrit ligjor për vullnetarizmin	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ngritja e programit të vullnetarizmit në BT;</li> <li>2. Hartimi i një kalendari vjetor për nismat e vullnetarizmit;</li> </ol>
	Nxitja e pjesëmarrjes vullnetare	<ol style="list-style-type: none"> <li>1.</li> </ol>